16.	Zeitlich- historische Erfahrung <ul style="list-style-type: none"> • Uhrzeiten / Tageszeiten/ Jahreszeiten • Tagesablauf • Persönliche Vergangenheit – Gegenwart und Zukunft • Sitten und Gebräuche • Traditionelle Feste

UDHËZIME METODOLOGJIKE

1. Forma komunikative e mësimdhënies

Në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme, kjo do të thotë: Cilat mjete gjuhësore u duhen nxënësve që në situata të caktuara gjuhësore të shprehen dhe të sillen në mënyrë të duhur?

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja për një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregullë gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo e kundërta.

2. Rradhitje e qartë e rrafsheve gjuhësore

Është e nevojshme, posaçërisht në nivelin fillestar të mësimdhënies, që t'u jepet një theks i veçantë rrafsheve të ndryshme gjuhësore, si

- Përpunimit të vokabularit (fjalësit)
- Përpunimit të teksteve
- Strukturat gjuhësore

e kjo do të thotë: të caktohen prioritetet brenda një njësie mësimore.

Nuk mundet p.sh. që të zhvillohet edhe vokabulari i ri edhe struktura të reja gjuhësore.

Mënyra më e drejtë do të ishte që së pari të përpunohet dhe trajnohet vokabulari, i cili paraqitet në leksionet e caktuara.

Pastaj vokabulari i përpunuar do të futet në struktura të reja sintaktike.

Mësuesi, brenda mësimdhënies komunikative, zgjedhë situata të tilla gjuhësore, të cilat janë të afërta me përditshmërinë, ashtu që strukturat e ushtruara të jenë natyrale e jo artificiale.

3. Radhitja: të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit

Posaçërisht në mësimin fillestar do të duhej të ruhet radha e katër shkathtësive, që d.m.th.:

- Nxënëset/sit nuk do të duhej të flasin asgjë që nuk e kanë dëgjuar më parë,

- Ata nuk do të duhej të lexojnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar dhe folur më parë,
- Ata nuk do të duhej të shkruajnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar, folur dhe lexuar më parë.

Për t'iu përmbajtur kësaj radhitjeje posaçërisht te fillestarët, flasin këto arsye:

- Nëse flitet një fjalë e re, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishte më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.
- Grafemat e gjermanishtes dhe të shqipes nuk përputhen në çdo rast. Pasi që nxënëset/sit janë mësuar me alfabetin e gjuhës shqipe, mund të paraqitet “përgjithësimi” ose interferenca, nëse fillohet herët me shkrimin në gjuhën gjermane. E kjo mund të shmanget nëse mësimi fillon me të dëgjuar dhe pastaj lëvizë mbi stacionet e të folurit dhe të lexuarit në drejtim të të shkruarit.

4. Puna aktive dhe konkrete

Dallimi në mes të mësimin të gjuhës gjermane në Gjermani - pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj- dhe në Kosovë është ndër tjera se mjedisi-kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për RFGJ-në dhe përveç orës së mësimin pothuajse nuk ekziston ndonjë mundësi për t'u zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mësimin si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televizionin.

Prodhimi (krijimi) i pllakatave, mozaqeve dhe posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla, janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

5. Kohë e mjaftueshme për ushtrime dhe zbatim

Për nxënien dhe zotërimin e sigurtë të një gjuhe nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

Tipat akustik (ata e nxënë - mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit - veshit);

Tipat vizuel - (pamor) (e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit);

Tipat motorik (e nxënë gjuhën më se shpejti përmes të shkruarit).

Për këtë arsye është e rëndësishme, që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu përmes këtij këndvështrimi; që gjuha të mësohet njëkohësisht përmes kanaleve të shumta, pasi që të shumica e atyre që mësojnë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

6. Llojllojshmëria në fazat e ushtrimeve

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës, të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ka më shumë ndikim negativ sesa që e arrinë atë është synuar.

Nxënësit do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe) është shumë më frytëdhënëse, por edhe lojrat në mësim, këngët, poezitë si dhe tregimet duhet të bëhen pjesë përbërëse të mësimin.

7. Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërtënëse në rrethin e mësimeve se sa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përvihen.

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsyshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

- Në fazën e kontaktit të parë me temën e re, si për shembull përmes një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësaj faze të mësimin, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtnin plotësisht.

Në këtë fazë është e drejtë që korrigjimet ndër të tjera të parashtrohen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë.

- Situata në fazën e zbatimit dhe të ushtrimit është tjetër. Këtu bëhet fjalë për trajnimin e vokabularit dhe të strukturave dhe këtu korrigjimi natyrisht është i pakushtëzueshëm.

S'ka diskutim se, nxënësit nuk bënë t'i turpërojmë para klasës, por të tregojmë takt pedagogjik.

8. Diferencimi

Ndodhë shpeshë që rezultatet e ndryshme gjuhësore të nxënësve në mësim të paraqesin pjesërisht vështirësi të mëdha.

Derisa një nxënës ta ketë kryer tanimë detyrën e tij, të mërzhitet në mësim apo të pengojë të tjerët duke kryer detyrat, tjetri nuk është ende gati edhe pse ka mjaft kohë në dispozicion.

Për mësueset dhe mësuesit ekzistojnë këtu dy mundësi: të bëjnë kinse nuk ka dallime në rezultate, por atëherë do të duhej që të merrej parasysh edhe ajo që herët apo vonë do të paraqiten vështirësitë nga ngarkesat (kërkesat tona) e vogla gjegjësisht të mëdha.

Mundësia tjetër mbështetet në praktikimin e masave të diferencimit të brendshëm e kjo pa dyshim për nxënësen/sin do të thotë të punojë.

Dallohen forma të ndryshme të diferencimit, të cilat nuk do të diskutohen këtu sepse ato tanimë janë të njohura.

Vetëm dy forma duhet të shikohen më për së afërmi:

Diferencimi kuantitativ dhe kualitativ

- *Diferencimi kuantitativ* do të thotë, se detyrat dallohen në kuantitetin e tyre, pra në sasinë e tyre. Kjo s'do të thotë asgjë tjetër, veçse nxënësit " e shpejtë" marrin detyra plotësuese. Masa zbatohet lehtë, sepse mësueset dhe mësuesit duhet vetëm që të mendojnë detyra shtesë, të cilat pastaj në se është nevoja ia japin disa nxënësve. Ky lloj i diferencimit megjithatë i ka edhe të metat e tij, sepse me anë të detyrave shtesë prej nxënësve kërkohet edhe më shumë e në këtë mënyrë bëhen gjithnjë e më të mirë. Me fjalë tjera: dallimi në mes të të mirëve dhe më pak të mirëve bëhet gjithnjë më i madh. Gjithashtu shtrohet pyetja, mos ndoshta nxënësit më të vjetër i shohin këto detyra shtesë si një lloj dënimi për atë që kanë punuar më shpejtë.

- *Diferencimi kualitativ* shtron më shumë kërkesa. Me këtë rast jipen detyra me shkallë të ndryshme vështirësie, pa e lënë ansh temën e përbashkët. Të nisemi prej asaj, që brenda një klase kemi të bëjmë me tri grupe të ndryshme të rezultateve A, B, dhe C, ku me grupin A nënkuptojmë grupin me arritje më të larta, me grupin B grupin me arritje të mesme dhe me grupin C grupin me arritje më të dobëta. Skema e rrjedhës së një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Sprachbegegnung - Kontakti i parë me temën e re (Evokimi)		
e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Spracherarbeitung - Përpunimi i temës (Realizimi)		
e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Sprachübung - Ushtrimet rreth temës (Reflektimi)		
diferencimi i grupeve sipas shkallës së arritshmërisë, p.sh.		
Grupi A Përpunimi i tërë tekstit. Detyra kreative shtesë	Grupi B Përpunimi i tërë tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe	Grupi C Përpunimi i një pjese të tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe.

Shpesh dëgjohet edhe një argument që flet kundër kësaj forme të diferencimit e që është:

Te kjo mënyrë e zhvillimit të mësimimit nuk mësojnë të gjithë nxënësit të njëjtën gjë, sepse profili i kërkesave është i ndryshëm, në këtë rast treshkallësh.

- Një analizë e këtij argumenti tregon megjithatë shumë shpejtë, se kjo nuk mund të vlej gjithmonë, sepse: nxënësit nuk e arrijnë parimisht kurrë njësoj shpejtë dhe mirë objektivin e orës mësimore.
- Ajo çka arrihet me anë të këtij procesi, është shmangia nga kërkesa e tepërt apo e paktë, sepse aftësitë e nxënësve për të nxënë janë të ndryshme pavarësisht nga ajo se a praktikohen masat e diferencimit apo jo.

9. Ndarja e një ore mësimore

Rrjedha e një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Artikulationsstufen	Methodische Absichten
1. Sprachbegegnung	Begegnung mit der neuen Sprachsituation, z.B. durch Bild, Tonaufnahme, Filmausschnitt, Lehrer - oder Schülervortrag.
2. Spracherarbeitung	Bereitstellen und Erarbeiten von neuem Wortschatz oder neuen Strukturen.
3. Sprachübung	Übungsbeispiele, möglichst in Form von realen Sprech-handlungen. Aufgreifen und Wiederholen von bekanntem Wortschatz mit neuen Strukturen und umgekehrt. Differenzierungsmaßnahmen Sprachlernspiele
4. Sprachanwendung	Übertragen des Gelernten auf neue Situationen: Im Klassenzimmer Im außerschulischen Bereich

GRADUALITETI (SHKALLËZIMI) NDËRPROGRAMORË

Para se t'i hyjmë punës për planin e detajizuar për klasë, ne kemi punuar një lloj plani të përafërt "global" për katër vite, në mënyrë që të kemi sadopak të qartë se ku duam të arrijmë pas përfundimit të katër klasëve (një niveli) d.m.th. klasët gjashtë - nëntë ose dhjetë – dymbëdhjetë (trembëdhjetë).

Arsyeja tjetër është që planet e punuara për klasë të kenë një ndër- lidhje programore dhe të vazhdojnë përafërsisht aty ku janë ndërprerë vitin paraprak, të mos ketë përsëritje të objektivave të përgjithshëm ose kthim drastik prapa.

Ky plan është punuar sipas taksonomisë së Blumit dhe është i konceptuar ashtu që të mund të lexohet vertikalisht (përparimi sipas taksonomisë për një vit shkollor) dhe horizontalisht që dmth. përcjellja e një objektivi prej vitit në vit në një shkallë më të lartë.

Për të pasur më të qartë ja në vijim paraqitja tabelare e shkallëzuar e niveleve dhe përmbajtjeve:

	1. Lernjahr	2. Lernjahr	3. Lernjahr	4. Lernjahr
Lernziel 1	Einfache sprachliche Kontakte herstellen	Miteinander sprechen	In mündlichen und schriftlichen Kontakten persönliche Mitteilungen machen	Über Ereignisse berichten
Lernziel 2	Gegenstände und Tätigkeiten benennen und beschreiben, nach Gegenständen fragen	Über Gegenstände und Tätigkeiten Aussagen machen	Sachinformationen einholen und weitergeben	Gegenstände und Vorgänge beschreiben
Lernziel 3	Anweisungen verstehen und Fragen beantworten	Anweisungen verstehen und erteilen	Anweisungen geben und Aufforderungen äußern	Tätigkeiten und Vorgänge beschreiben
Lernziel 4	Sich orientieren und verständigen	Angaben zur örtlichen Umgebung machen	Angaben zu Zeit, Lage und Raum machen	Mitteilungen sachlichen Inhalts machen
Lernziel 5	Sprachliche Kontakte knüpfen	Wünsche und Gefühle äußern	Erlebtes und Gehörtes wiedergeben	Vorgegebene Geschichten und Erlebnisse mündlich und schriftlich darstellen
Lernziel 6	Einfache Auskünfte einholen und erteilen	Persönliche Daten erfragen und Angaben machen	Die eigene Meinung darstellen	Über Zukünftiges und Erdachtes berichten

NDËRLIDHJA NDËRLËNDORE

Në anën tjetër gjuha që pikësëpari shërben si mjet komunikimi nuk mësohet ekskluzivisht në orët e gjuhës por në një formë a në një tjetër të të gjitha lëndet mësimore përdërisa në to aftësitë, pikëpamjet e ndryshme e njohuritë zhvillohen përmes rrugëve gjuhësore.

Për aq sa gjuha ndihmon tek lëndet e tjera, aq mund të ndihmojnë lëndet tjera për arritjen e objektivave brenda mësimin të gjuhës gjermane. Para së gjithash edhe temat e zgjedhura kanë të bëjnë me shumë fusha të jetës e me këtë edhe me shumë lëndë mësimore, njohuritë e të cilave na ndihmojnë në mësimin e gjuhës gjermane.

Natyrisht se gjuha para së gjithash është e ndërlidhur me artet sepse çdo fjalë a nocion i ri mund (duhet) të shpjegohet përmes këngës, vizatimit, fotografisë a lojës (qoftë te fëmijët (niveli II) apo te të rinjët (niveli III)).

Edhe njohuritë nga shkencat, qoftë natyrore apo shoqërore duhet t'i shfrytëzojmë gjatë trajtimit të temave të ndryshme të parapara për klasën e shtatë.

Këto njohuri shfrytëzohen sidomos në pjesën e parë të orës (EVO-KIMI), ku varësisht nga temat që do të trajtojmë, përdorim njohuritë nga lëndët tjera (nxënësit i parapërgadisim për temën).

Të ndërlidhura më shkencat shoqërore e që vetëdijësojnë nxënësit për qështje të shumta jetësore si dhe u ndihmojnë të arrijnë shkathhtësitë e duhura jetësore e komunikative, janë temat e shumta në klasën e shtatë (e sidomos me edukatën qytetare).

Ndërlidhja ekziston edhe me shkencat natyrore sidomos të potencuara janë ato njohuri që kanë të bëjnë me ambientin, ruajtjen e tij, shëndetin (ruajtjen e shëndetit të vet e të të tjerëve), ushqimin, etj.

TEKSTET MËSIMORE

Grupi i ekspertëve për gjuhë gjermane propozon këto tekste mësimore:

Klasa 6: Wer? Wie? Was? Band 1, VUB-Gilde Verlag, Köln

Klasa 7: Wer? Wie? Was? Band 2, VUB-Gilde Verlag, Köln

alternativ:

Klasa 6: Ping Pong 1 - Neu, Hueber Verlag, Ismaning

Klasa 7: Ping Pong 2 - Neu, Hueber Verlag, Ismaning

HYRJE

Matematika është shkencë mbi madhësitë, numrat, figurat, hapësirën dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Ajo, gjithashtu, konsiderohet gjuhë universale që bazohet në simbole e diagrame.

Lënda e matematikës në klasën e shtatë synon jo vetëm përforsimin, zgjerimin dhe thellimin e njohurive, por edhe edukimin e shprehive për punë të pavarur e sistematike dhe zhvillimin e proceseve euristike të nxënësit. Të mësuarit dhe nxënia e matematikës kultivon zhvillimin e aftësive më të larta të kulturës matematike: zgjidhjen e problemeve, arsyetimin dhe komunikimin matematik.

Zbatimi përherë e më shumë i matematikës në fusha të tjera të ekonomisë dhe të teknologjisë, si dhe integrimi i saj me të gjitha shkencat e tjera, muzikën, artin dhe gjuhën, e rrit rëndësinë e saj për zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.

QËLLIMET

- Zhvillimin e aftësive dhe të shkathtësive të nxënësit për të njohur dhe për të kuptuar konceptet bazë matematik, marrëdhëniet ndërmjet tyre, faktet, modelet, përkufizimet dhe formulat;
- Zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të nxënësit për të komunikuar në gjuhën e matematikës dhe për të zbatuar njohuritë konceptuale dhe proceset për zgjidhjen e detyrave standarde dhe problemeve nga jeta e përditshme.
- Zhvillimin intelektual e shpirtëror të nxënësit, formimin e cilësive të menduarit për qasje kritike të informacioneve dhe aftësitë për të përdorë literaturë dhe burime të tjera për nxënie;

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- Të njohin
 - numrat dhe veprimet numerike, format ekuivalente për shprehjet e thjeshta algebrike dhe proceset e zgjidhjes së ekuacioneve lineare;
 - figurat gjeometrike dy dhe tridimensionale, njësitë dhe madhësitë matëse;
 - proceset për hulumtimin, grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave.
- Të kuptojnë
 - mënyrën e prezantimit të numrave dhe veprimet numerike, ndryshoret në formula të thjeshta dhe ekuacione, modelet , algoritmet dhe funksionet;
 - vetitë e elementeve të figurave gjeometrike dhe të trupave gjeometrikë, njësitë matëse dhe proceset matëse të madhësive;
 - mënyrat e grumbullimit të të dhënave statistikore dhe format e ndryshme të paraqitjes së tyre .
- Të zbatojnë
 - veprimet numerike, formulat matematike dhe algoritmet në zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
 - vetitë e figurave dhe të trupave gjeometrikë për konstruktimin dhe modelimin e tyre;
 - madhësitë dhe matjet për të njehsuar gjatësitë, syprinën dhe vëllimin në situatat reale;
 - modelet statistikore për hulumtime dhe paraqitje të dukurive reale.
- Të analizojnë
 - modele, procese dhe marrëdhënie të ndryshme të koncepteve të marra për të arsyetuar dhe për të vërtetuar zgjidhjet e problemeve;
 - karakteristikat dhe vetitë e figurave dy dhe tridimensionale për argumentimet matematike të relacioneve gjeometrike;
 - të dhënat statistikore për nxjerrjen e përfundimeve.
- Të sintetizojnë
 - konceptet matematike për formulimin e problemeve algebrike dhe gjeometrike;

- planet për mbledhjen, organizimin, klasifikimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore;
- Të vlerësojnë
 - proceset matematike dhe përdorimin e strukturave algjebrike në situata reale;
 - objektet gjeometrike në mjedisin që na rrethon;
 - komunikimin matematik dhe zgjedhjen e metodave e të strategjive për argumentimin e pohimeve dhe të zgjidhjeve të problemeve.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	Nr. i orëve	%
I. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA	1. NUMRAT	70	47.30
	2. PËRQINDJA		
	3. FUQIA		
	4. SHPREHJET ME SHKRONJA (NDRYSHORE)		
	5. FUNKSIONI		
II. GJEOMETRIA DHE MATJET	1. KËNDET	65	43.90
	2. FIGURAT GJEOMETRIKE – SHUMËKËNDËSHAT		
	3. RRETHI		
	4. SIMETRIA		
	5. TRUPAT GJEOMETRIKË - PRIZMI DHE PIRAMIDA		
III. STATISTIKA DHE PROBABILITETI	1. DISA NJOHURI NGA STATISTIKA	13	8.80

I. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA

Aritmetika mundëson zhvillimin e aftësive për formimin e konceptit numër dhe të veprimeve me numra. Shkathtësitë në llogaritjet numerike, nxjerrjen e algoritmave dhe procedurave që shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve dhe arsyetimin e rezultateve.

Algjebra zhvillon të kuptuarit e ndryshoreve, shprehjeve shkronjore, ekuacioneve dhe inekuacioneve. Përdorimi i simboleve, i rregullave dhe i procedurave mundësojnë lidhjen e gjuhës së zakonshme me atë algjebrike për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.

Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
I.1. NUMRAT	I.1.1. Numrat me shenjë. Drejtëza numerike I.1.2. Numrat e plotë. Vlera absolute I.1.3. Rrënja katrore e numrit natyror I.1.4. Përdorimi i kalkulatorit për gjetjen e rrënjës katrore I.1.5. Krahasimi i numrave të plotë I.1.6. Mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave të plotë; I.1.7. Numrat përpjesëtimorë; I.1.8. Gjetja e të katërtës përpjesëtimore; I.1.9. Madhësitë e drejta përpjesëtimore;	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: – të dallojë numërorët që tregojnë të njëjtën sasi; – të njehësojë rrënjën katrore me tentativë dhe duke përdorur kalkulatorin; – të paraqesë numrat racionalë dhe të plotë në boshtin numerik. – të krahasojë numrat e plotë; – të njehsojë shumë, ndryshimin, prodhimin dhe herësin e numrave të plotë; – të njehsojë vlerën e shprehjeve me mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim të numrave racionalë; – të zbatojë radhën e veprimeve aritmetike në shprehje numerike; – të zgjidhë probleme nga jeta e përditshme, duke përdorur numra përpjesëtimorë.	Gjeometri, fizikë, kimi, gjeografi, kulturë fizike etj. (Gjatë matjeve dhe llogaritjeve të ndryshme, përpilim të hartave etj.)

I.2. PËRQINDJA	I.2. 1. Kuptimi i përqindjes I.2.2. Gjetja e përqindjes së një numri I.2.3. Zbatimi i përqindjes në zgjidhjen e problemeve	<ul style="list-style-type: none"> – të përdorë përqindjen në situata konkrete; – të vlerësojë dhe të kalkulojë përqindjen përmendësh dhe me metoda llogaritëse; – të zbatojë përqindjen në zgjidhje të problemeve nga jeta e përditshme. 	Gjeografi, kimi, etj. (p.sh. përqindja e sipërfaqeve ujore në rruzullin tokësor etj.)
I. 3. FUQIA	I. 3.1. Kuptimi i fuqisë. Fuqia me tregues numër natyrorë I. 3.2. Vlerat e fuqisë I. 3.2. Shkrimi i numrit natyror si shumë e fuqive me bazën 10	<ul style="list-style-type: none"> – të lexojë dhe të shkruajë fuqitë me eksponent numër natyror; – të njehsojë vlerën e fuqisë; – të shprehë numrin e plotë në trajtë të një numri shkencor $a \cdot 10^n$, ku n është numër i plotë; – të përdorë kalkulatorin për gjetjen e fuqisë. 	Gjeometri, fizikë, kimi etj. (p.sh. shumëfishat dhe nënfishat e njësive matëse të madhësive të ndryshme fizike dhe kimike etj.)
I. 4. SHPREHJET ME SHKRONJA (NDRYSHORE)	I. 4.1. Shprehjet që përmbajnë shkronja I. 4.2. Njehsimi i vlerës së shprehjes për vlera të caktuara të shkronjave I.4.3. Veprimet elementare me shprehje shkronjore (mbledhja dhe zbritja) I. 4.4. Ekuacionet lineare me një të panjohur I. 4.5. Inekuacionet lineare me një të panjohur	<ul style="list-style-type: none"> – të modelojë marrëdhëniet numerike, duke përdorur shkronjat; – të bëjë përkthime të thjeshta nga shkrimi i zakonshëm në shkrim me simbole matematike; – të zbatojë radhën e veprimeve aritmetike dhe kllapave në shprehjet me shkronja; – të zgjidhë ekuacionet lineare me një të panjohur; – të zgjidhë inekuacione lineare me një të panjohur; – të paraqesë zgjidhjet e inekuacioneve në boshtin numerik dhe të formojë bashkësinë numerike të zgjidhjes; – të zbatojë ekuacionet për zgjidhjen e problemeve të ndryshme matematike. 	Fizikë etj. (p.sh. varësia e një madhësie nga tjetra etj.)

I.5. FUNKSIONI	I. 5.1. Funkzioni si rregull e lidhjes së dy bashkësive I. 5.2. Paraqitja e pikave të funksionit në rrjetën koordinative (katër kuadrante)	<ul style="list-style-type: none"> – të caktoj vlerën e funksionit $y=f(x)$ për vlera të ndryshme të argumentit x; – të paraqesë pikat e funksionit me anë tabelës, palës së renditur dhe në rrjetin koordinativ; – të ndërtojë grafikun e funksionit duke bashkuar pikat në rrjetin koordinativ. 	Fizikë, K. fizike, etj. (p.sh. paraqitja grafike e rritjes apo e zvogëlimit të shpejtësisë në varësi me kohën etj.)
-------------------	---	--	---

II. GJEOMETRIA DHE MATJET

Përfytyrimi hapësinor është një vetëdije intuitive për mjedisin që na rrethon dhe për objektet në të. Gjeometria na ndihmon t'i paraqesim dhe t'i përshkruajmë, në mënyrë sistematike, objektet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre në hapësirë. Të kuptuarit e marrëdhënieve hapësinore dhe zotësia për të shfrytëzuar konceptet dhe gjuhën e gjeometrisë ndikon në përmirësimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve për numrat dhe matjet. Konceptet e aftësitë për matje janë të lidhura drejtpërdrejt me botën reale. Përvoja konkrete dhe shfrytëzimi i veglave dhe i formulave janë bazë për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e shkathtësive të nxënësve.

Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
II.1. KËNDET	II.1.1. Llojet e këndeve në drejtëzat paralele II.1.2. Këndet suplementare dhe komplementare II.1.3. Konstruktimi i këndeve 60° , 30° , 15° , 90° , 45° , 120° , etj.	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të përshkruajë vetitë e këndeve në drejtëzat paralele që priten nga tranzverzalja, duke matur drejtpërdrejt: këndet përgjegjëse, shndërruese dhe të kundërta; – të gjejë këndin suplementar (komplementar) të këndit të dhënë, me përpikëri, me njehsim dhe me konstruktim; 	Zgjidhja e problemeve në gjeometri, fizikë, arsim teknik etj.

		<ul style="list-style-type: none"> – të konstruktojë këndet 60°, 30°, 15°, 90°, 45° dhe 120°, duke shfrytëzuar metoda të ndryshme (p.sh. fletët palosëse, vizoren dhe kompasin). 	
II. 2. FIGURAT GJEOMETRIKE	<p>II.2.1. Trekëndëshi dhe sipërfaqja trekëndëshe</p> <p>II.2.2. Perimetri dhe syprina e sipërfaqes trekëndëshe</p> <p>II.2.3. Shuma e këndeve të trekëndëshit</p> <p>II.2.4. Klasifikimi i trekëndëshave sipas brinjëve dhe këndeve</p> <p>II.2.5. Marrëdhëniet ndërmjet këndeve dhe brinjëve të trekëndëshit</p> <p>II.2.4. Teorema e Pitagorës – kuptimi</p> <p>II.2.5. Rrethi i brendashkruar dhe jashtëshkruar i trekëndëshit</p> <p>II.2.6. Shumëkëndëshat dhe sipërfaqja shumëkëndëshe</p> <p>II.2.7. Shumëkëndëshat e rregullt. Konstruktimi</p> <p>II.2.8. Shuma e këndeve të shumëkëndëshit</p> <p>II.2.9. Perimetri dhe syprina e sipërfaqes shumëkëndëshe (paralelogrami, trapezi, deltoidi),</p>	<ul style="list-style-type: none"> – të konstruktoj figurat dydimensionale me madhësi të caktuara të këndeve dhe të brinjëve, duke shfrytëzuar metoda të ndryshme; – të përdorë saktë gjuhën matematike për të përshkruar konceptet gjeometrike (perimetër, syprinë, deltoid etj); – të zbulojë marrëdhëniet e këndeve të brendshme të trekëndëshit (shuma e tyre është 180°) me metoda të ndryshme (duke i renditur qoshet e letrës, duke përdorur këndmatësin); – të shpjegojë pse shuma e këndeve të brendshme të trekëndëshit është 180°; – të njehësojë madhësitë e këndeve të trekëndëshit (të jashtme e të brendshme) kur dihen madhësitë e dy këndeve të tij; – të gjejë perimetrin e të gjitha figurave dydimensionale me formula dhe me matje; – të njehsojë syprinën e sipërfaqes shumëkëndëshe (paralelogrami , trekëndëshi, trapezi, deltoidi) me anë të formulave; – të zbërthejë figurat jo të rregullta në figura të thjeshta dydimensionale për të gjetur perimetrin dhe syprinën e tyre; – të zgjedhë njësitë standarde për matje dhe të shpjegojë marrëdhëniet ndërmjet njësive të ndryshme të matjeve gjatë zgjidhjes së 	<p>Art figurativ, arsim teknik, gjimnastikë, e në shumë lënd të tjera. (p.sh. identifikimi i figurave në mjedisin që na rrethon, shenjave të komunikacionit etj.)</p>

		problemeve; – të hulumtojë dhe të raportojë për shfrytëzimin e instrumenteve matëse në projekte të ndryshme, në shtëpi, vendpunime dhe komunitet.	
II.3. RRETHI	II.3.1. Rrethi-kuptimi dhe elementet e tij II.3.2. Perimetri dhe syprina e sipërfaqes rrethore-numri π	– të bëjë matjen e rrezës, të diametrit dhe të perimetrit duke përdorur mjete konkrete; – të vlerësojë se raporti ndërmjet rrezes, diametrit dhe perimetrit është numër konstant (π), dhe të gjejë vlerën e përafërt të tij; – të përdorë formulat për njehsimin e perimetrit dhe të syprinës së sipërfaqes rrethore në detyra nga jeta e përditshme.	Fizikë, arsim teknik, art figurativ, etj. (p.sh. Lëvizjet rrethore në fizikë, shenjat e komunikacionit, etj.)
II. 4. SIMETRIA	II.4.1. Simetria boshtore II.4.2. Rotacioni i figurave II.4.3. Simetria qëndrore II.4.4. Simetria rrotulluese II.4.5. Figurat me drejtëz simetrie II.4.6. Figurat me qendër simetrie	- të përshkruajë rrotullimin e figurave; - të identifikojë figurat simetrike-boshtore dhe simetrike-qendrore; - të konstruktojë figurat me drejtëz simetrie dhe me qendër simetrie; - të identifikojë figurat simetrike në objektet e mjedisit që na rrethon.	Arkitektura e objekteve të banimit, të urave, objekteve fetare etj. (art figurativ etj.)
II. 4. TRUPAT GJEOMETRIKË - PRIZMI DHE PIRAMIDA	II.4.1. Kubi dhe kuboidi II.4.2. Prizmi II.4.3. Piramida	– të skicojë objektet tridimensionale nga modelet dhe vizatimet; – të identifikojë figurat dydimensionale në rrjetin e prizmit dhe të piramidës; – të hetojë formulat për gjetjen e sipërfaqes së prizmit dhe të piramidës, duke shfrytëzuar rrjetet përkatëse;	Modelimi i trupave në arsim teknik etj.

		<ul style="list-style-type: none"> – të përshkruajë marrëdhëniet ndërmjet njësive kubike dhe të përdorë saktë ato gjatë matjeve; – të hulumtojë dhe të raportojë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në shtëpi; – vendpunime dhe komunitet që kanë të bëjnë me trupat gjeometrikë. 	
--	--	--	--

III. STATISTIKA DHE PROBABILITETI

Sistemi i grumbullimit, i paraqitjes tabelare dhe grafike të të dhënave, përdorimi i metodologjisë dhe i mjeteve bashkëkohore në hulumtimin dhe grumbullimin e informatave për dukuritë shoqërore, ekonomike dhe natyrore është objekt studimi i statistikës.

Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
III. DISA NJOHURI NGA STATISTIKA	III.1.1. Paraqitja e të dhënave statistikore III. 1.2. Ndërtimi i diagrameve III. 1.3. Vlerat mesatare III. 1.4. Moda dhe mediana III. 1.5. Frekuenca absolute dhe relative	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të grumbullojë të dhënat statistikore për dukuritë që na rrethojnë; – të paraqesë të dhënat e grumbulluara në tabela; – të ndërtojë diagrame në bazë të të dhënave të grumbulluara; – të gjejë vlerat mesatare: mesataren aritmetike, modën dhe medianën; – të gjejë frekuencat absolute dhe relative. 	Projekte të ndryshme hulumtuese nga : edukata fizike, biologjia, edukata qytetare, gjeografia etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Gjatë procesit mësimor, mësimdhënësi duhet të veçojë konceptet dhe shkathtësitë e domosdoshme që duhet t'i mësojë nxënësi me qëllim të arritjes së rezultateve të të nxënësve që parashikohen në objektiva.

Praktikat mësimore kanë treguar se jo të gjithë nxënësit, mësojnë në të njëjtën mënyrë, në të njëjtën kohë dhe me ritëm të njëjtë. Për këtë arsye, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies duhet të jene të larmishme dhe t'u përshtaten nevojave dhe interesit të nxënësve. Ato duhet të nxisin bashkëpunimin mes nxënësve me qëllim të përforsimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënësve.

Shpjegimi është një prej metodave që në raste të veçanta është i domosdoshëm, por, megjithatë, mësimdhënësia ndërvepruese ka përparësi në nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve.

Mësimdhënësia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për ndërtimin e të kuptuarit të koncepteve, zgjerimin e njohurive, zhvillimin e strategjive matematike për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme.

Zgjidhja e problemeve është tipar i të menduarit, që në matematikë zë një vend të rëndësishëm. Ajo është pjesë e integruar në të gjitha kategoritë e përmbajtjeve mësimore. Në vitet e para të mësimin të matematikës nxënësit shfrytëzojnë teknika të thjeshta, kurse në klasën e shtatë mbi bazën e njohurive të fituara ata vlerësojnë cilësinë dhe rrjedhimet e metoda komplekse të zgjidhjes së problemeve.

Zgjidhja e problemeve është një procesë "provues" që përmban fillime e mbarime, suksese e dështime dhe verifikime e mospranime të disa përfundimeve. Është e rëndësishme që mësimdhënësit të provojnë këtë proces në klasat e tyre dhe të bashkëpunojnë me nxënësit për kërkime të përgjigjeve. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit inkurajojnë nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë dhe u ndihmojnë atyre të fitojnë përvoja të reja e të vlerësojnë sukseset dhe dështimet e strategjive të ndryshme të zgjidhjes së problemeve. Veprimtaritë që organizohen në klasë gjatë zgjidhjes së problemeve duhet të gërshetojnë punën individuale, në çifte dhe në grupe me qëllim të rritjes së përgjegjësisë së nxënësit për të ndërtuar të kuptuarit.

Pyetjet dhe teknika e pyetjeve zë një vend parësor në planifikimin e mësimdhënies. Nëse dëshirojmë të nxisim të menduarit e nxënësve, si pjesëmarrës aktivë në procesin e të nxënësve, është e domosdoshme të planifikohen pyetje të të gjitha niveleve. Kur të gjitha pyetjet janë të nivelit riprodhues, atëherë ndodh pak ose aspak të menduarit. Pyetjet e nivelit të lartë që zakonisht fillojnë me "Si...?", "Pse...?" dhe "Çfarë...?" janë pyetje nxitëse që kërkojnë nga nxënësi të mendojë dhe të reflektojë për atë që ka mësuar.

Komunikimi si një nga qëllimet më të rëndësishme të programit të matematikës u mundëson nxënësve të përdorin saktë gjuhën e matematikës. Është me rëndësi që gjatë procesit të të nxënësve, nxënësit të dëgjojnë, të pyesin, të diskutojnë, të lexojnë dhe të shkruajnë. Shprehja e ideve matematikore dhe diskutimi i tyre luan rol të rëndësishëm në të kuptuarit e koncepteve. Simbolet dhe diagramet e pasurojnë gjuhën e zakonshme të nxënësve, e zgjerojnë fjalorin shprehës dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë në të gjitha fushat.

Lidhja ndërlëndore paraqet një aspekt të rëndësishëm në edukimin matematik. Përvojat që sjellin në klasa mësimdhënësit, u mundësojnë nxënësve të shohin si konceptet dhe shkathtësitë nga një kategori e matematikës janë të lidhura me ato të kategorive të tjera. Në rastet e tilla, nxënësit ndihmohen të zotërojnë parimet e përgjithshme matematike. Po ashtu, lidhja e matematikës me lëndët e tjera dhe me situatat e jetës së përditshme paraqet një tjetër fakt, që e bën matematikën më shumë se shkencë të izoluar.

Edukata fizike ofron raste të panumërta të matjeve si pjesë të natyrshme të aktiviteteve, për shembull kohëmatjet ose matjet e gjatësive gjatë kërcimeve. Krijimi i figurave simetrike dhe asimetrike në mësimet e gjimnastikës, paraqesin shfrytëzimin real të koncepteve matematike. Gjuha matematike haset në të gjitha fushat, për shembull leximi i notave muzikore apo përshkrimi i figurave në aktivitetet e artit pamorë. Kështu, lidhjet dhe zbatimi i njohurive matematike në fusha të ndryshme e rrit interesimin e nxënësve për mësimin e matematikës.

VLERËSIMI

Procesi i vlerësimit është pjesë e integruar e mësimdhënies dhe e të nxënësve. Përmes vlerësimit të vazhdueshëm gjykohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve, por edhe vlefshmëria e programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi. Mësimdhënësi duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësve dhe në shqyrtimin e aftësive dhe të shkathtësive të ndryshme të tyre. Në klasën e shtatë, nxënësve pësojnë ndryshime të mëdha në arritjet matematike, ndryshime të shpejta në rritjen e tyre intelektuale dhe në zhvillimin emocional. Prandaj, gjatë vlerësimit përcaktohet jo vetëm çfarë dinë nxënësve dhe çfarë mund të bëjë ai, por edhe çfarë ndjen dhe çfarë beson ai. Këto informata i mundësojnë mësimdhënësit të organizojë orët mësimore në mbështetje të nevojave dhe të interesave të ndryshme të nxënësve. Të dhënat dhe mbledhja e informatave, ndihmojnë gjithashtu në marrjen e vendimeve të vlefshme për motivimin dhe inkurajimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve.

Ndonëse aftësitë në llogaritje janë qenësore, vlerësimi duhet të përfshijë edhe verifikimin e aftësive të nxënësve për përdorimin e saktë të gjuhës e

të simboleve matematike gjatë komunikimit matematik, dhe vlerësimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve. Për këto arsye në orët e matematikës shfrytëzohen teknika të ndryshme vlerësimi si:

Vrojtimi dhe regjistrimet në klasë vlerësojnë shkathtësitë e manifestimit dhe sjelljet e ndryshme të nxënësve.

Detyrat kontrolluese shërbejnë për kontrollimin e përparimit të nxënësve dhe identifikimin e vështirësive në të mësuar.

Dosja dhe projektet paraqesin koleksione të punimeve të përzgjedhura të mbajtura në një folder, të cilat sigurojnë një model të punës së nxënësit, të kryer gjatë një periudhe të caktuar kohore. Vlerësimi i dosjes bëhet nga mësimitdhënësi, prindi dhe nga vetë nxënësi.

Rubrikat janë shumë efikase për klasifikimin e rezultateve të nxënësit.

Testimi është një procedurë që i shërben vlerësimit për qëllime të shumëfishta. Testet e ndërtuara nga mësimitdhënësi janë instrumentet më të përdorshme për vlerësimin e nxënësve. Llojet e ndryshme të testeve mundësojnë sigurimin e informacioneve për çdo nxënës në përmbushje të rezultateve të pritshme dhe objektivave të lëndës së matematikës, identifikimin e vështirësive në të mësuar dhe tejkalimin e tyre dhe vlerësimin e gatishmërisë së nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Për shënimin e përparimit të nxënësve dhe vënien e notave, mësimitdhënësi mund të përdorë modele të ndryshme, që janë më të përshtatshme dhe që japin informacione të pasura. Këto shënime dhe informacione kanë rëndësi të madhe për të kontribuar në motivimin dhe përparimin e mëtejshëm dhe për të komunikuar me prindërit dhe të gjitha institucionet e interesuara.

BURIMET DHE LITERATURA

Për realizimin e përmbajtjes së lëndës, matematikës për klasën e shtatë, derisa të dalë teksti i përshtatshëm, varësisht nga përmbajtja programore, mund të përdoren edhe këto tekste që ishin në përdorim më parë:

R. Zejnullahu, E. Hamiti, E. Gashi, S. Bilalli: MATEMATIKA 6, Prizren, 2000.

S. Bilalli, R. Lekaj, M. Kadriu: Përmbledhje detyrash nga matematika 6, Prizren, 2000.

R. Zejnullahu, R. Gjergji, S. Bilalli, R. Lekaj: MATEMATIKA 7, Prishtinë 2002.

R. Zejnullahu, M. Kadriu, S. Bilalli, R. Lekaj: Përmbledhje detyrash nga matematika 7, Prishtinë, 2002.

HYRJE

Kërkesë imediate e mileniumit të ri është integrimi në shumë nivele, duke përfshirë edhe atë shkencor. Prandaj, biologjia bashkëkohore synon të gjejë rrugë të reja të parashtrimit të integruar të njohurive nga fushat specifike të biologjisë me shkencat e tjera natyrore e shoqërore.

Në këtë kontekst përmbajtja e programit mësimor të biologjisë (si qeniet e gjalla dhe mjedisi - zoodiversiteti, ndërtimi i qenieve të gjalla – indet, organet dhe sistemet e organeve, proceset jetësore – metabolizmi, cikli jetësor) i kontribuon zhvillimit të mendimit kritik, aftësive kognitive dhe shkathtësive psikomotore të nxënësve.

Aplikimi i qasjeve dhe i strategjive të reja të mësimdhënies zhvillojnë te nxënësi prirje për aplikim dhe ndërlidhje të njohurive me botën reale, hapin dyert për orientim të ardhshëm profesional në lëmin e mjekësisë, të veterinarisë, të bujqësisë etj.

Në këtë kontekst edhe zhvillimi i programit mësimor të lëndës së biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënësve, metodave dhe instrumenteve të vlerësimit.

Përmbajtja programore e lëndës së biologjisë e nxit kërkuesin e nxënësve për botën e gjallë me njeriun në të, zhvillon ndjenjën e përgjegjësisë për natyrën, qeniet e gjalla, ndërgjegjëson ata se njeriu duhet të ketë qëndrim tjetër ndaj natyrës dhe mjedisit. Të gjitha këto me synim që nxënësi si qytetar i ardhshëm të ballafaqohet me sukses me sfidat e mileniumit të ri.

QËLLIMET

- ❖ Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të njohur dhe për të kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve jetësore, organizimin, ndërtimin dhe zhvillimin e botës së gjallë.

- ❖ Zhvillimin e njohurive për biodiversitetin e gjallesave dhe aftësive për të vlerësuar rolin e tij në ruajtjen e baraspeshës ekologjike në natyrë.
- ❖ Zhvillimin e shkathtësive, përpunimin e të dhënave relevante shkencore dhe zbatimin e shkathtësive të fituara konkrete për të mirën e njeriut dhe të mjedisit.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

- **Të zhvilloj qëndrimet dhe vlerat**
 - Në kontest të ndërgjegjësimit dhe të ngritjes së përgjegjësimit etik ndaj botës së gjallë dhe mjedisit jetësor me qëllim të ruajtjes së baraspeshës ekologjike në natyrë.
 - Në kuptim të kultivimit të sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik).
- **Të njohë:**
 - Fjalorin (terminologjinë biologjike)
 - Faktet, konceptet dhe parimet biologjike
 - Procedurat dhe metodat në biologji
- **Të kuptojë**
 - Faktet dhe parimet biologjike dhe të bëjë ndërlidhjen logjike të tyre
 - Relacionin shkak – efekt
 - Arsyetimin e metodave dhe të procedurave
- **Të zbatojë në situata të reja**
 - Faktet dhe parimet biologjike
 - Procedurat dhe metodat nga biologjia
 - Zgjedhjen e problemeve të natyrës biologjike
- **Të komunikojë informatat në kontekste të ndryshme**
 - Të shkruajë raportet nga një punë praktike ose hulumtim
 - Të prezantojë rezultatet e hulumtimit, duke konsultuar shumë burime të informacionit
 - Të kontribuojë në debate dhe diskutime për çështje biologjike
- **Të zhvillojë të menduarit kritik nga biologjia**
 - Të njohë informatën relevante nga ajo jorelevante
 - Të dallojë faktin nga gjykimi
 - Të zbatojë parimet biologjike në zgjedhjen e problemeve
 - Të interpretojë materialin ilustrues

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Organizimi i përmbajtjes përfshin: ndërtimin, balancimin dhe mbarështrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin tri kategori kryesore me të cilat përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara të përmbajtjes sipas rëndësisë së tërësive mësimore.

Mbarështrimi i përmbajtjes së lëndës në klasë bëhet për 74 orë mësimi, sipas trajtës.

- Kategoria
- Nënkatëgoria
- Përmbajtja programore
- Rezultatet e pritura
- Lidhja ndërlëndore

PËRMBAJTJA PROGRAMORE		Orët	%
KATEGORIA	NËNKATEGORIA		
I. QENIET E GJALLA DHE MJEDISI	I 1.ZOODIVERSITETI	26	35.14
II. NDËRTIMI I QENIEVE TË GJALLA	II. 1. INDET, ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE	24	32.43
III. PROCESET JETËSORE	III.1 METABOLIZMI	5	6.76
	III. 2. CIKLI JETËSOR	6	8.11
	Punë praktike në laborator dhe në terren	10	13.51
	Orë në dispozicion	3	4.05
	Gjithsej	74	100

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
I.Qeniet e gjalla dhe mjedisi	I. 1. Zooidiversiteti	<p>Numrin më të madh të organizmave e përbëjnë gjallesat të cilat nuk kanë shtyllë rruazore- parruazorët;</p> <ul style="list-style-type: none"> • biologjia e parasztazorëve, • organizmat shtazorë pa inde të diferencuara-sfungjerët, • shtazët me trup dyshtresor-knidariet, • shtazë me trup treshtresor dhe pa zgavër trupore-krimbat e shtypur, • shtazët me zgavër trupore të rreme krimbat cilindrikë, • shtazët me trup të butë-butakët, • organizma shtazorë me segmentim homonom të trupit-krimbat unazorë, • shtazët me tri palë këmbë-insektet • këmbënyjetuarit që marrin frymë me branshi-gaforret, • shtazët tipike të detit me trup të mbuluar me gjemba-lëkurgjemborët. <p>Në mbretërinë e shtazëve</p>	<p>Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje programore duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të njohin dhe të zbatojnë përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me zooidiversitetin. • Të analizojnë dhe të përshkruajnë faktorët e ndryshëm evolutivë që ndikuan në zhvillimin dhe në përsosjen e qenieve të gjalla. • Të analizojnë dhe të vlerësojnë rolin e njeriut në zooidiversitet. • Të përshkruajë historikun e zhvillimit të shumëllojshmërisë së jokurrizorëve dhe të kurrizorëve. • Të krahasojnë dhe të dallojë përfaqësuesit e klasave të ndryshme të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve • Të emërtojë jokurrizorë dhe kurrizorë të ndryshëm të mjedisit ku jeton • Të observojë modele ose të përdorë organizma të ndryshëm-përfaqësues të grupeve të ndryshme të jokurrizorëve 	<p>Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeografinë, në kuptimin e njohjes së përbërjes së shtresave të ndryshme të dheut; • Ekologjinë, në kuptimin e njohjes së faktorëve të ndryshëm të mjedisit jetësor në procesin e zhvillimit evolutiv dhe diversitetit; • Gjenetikën, në aspektin e njohjes së ligjshmërive të trashëgimit në procesin e krijimit të llojeve.

		<p>ekzistojnë organizma shtazorë që kanë bosht primitiv skeletor-chorda dorsalis, i cili te format adulte të kurrizorëve shndërrohet në shtyllë rruazore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shtazët me skelet boshtor primitiv-kordatet, • shtazët me shtyllë kurrizore të vërtetë-kurrizorët, • kurrizorët pa nofulla-gojërrumbullakët, • kurrizorët tipikë ujqorë-pesqit, • kurrizorët e parë tokësorë-ujëtokësorët, • kurrizorët e mbuluar me pllakëza të brirëzuara-zvarranikët, • kurrizorët me trup të mbuluar me pupla-shpendët, • kurrizorët me qime dhe me gjëndra qumështore-gjitarët 	dhe të kurrizorëve për të krijuar pasqyrë të rritjes së ndërlíkueshmërisë së ndërtimit të organizmave	
Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
		<p>II. 1.1. Qeniet e gjalla që të kryejnë funksionet e ndryshme jetësore janë të ndërtuara nga indet, organet dhe sistemet e organeve.</p>	<p>Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje programore duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore që kanë të 	<p>Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:</p>

<p>II. Ndërtimi i qenieve të gjalla</p>	<p>II. 1. Indet, organet dhe sistemet e organeve</p>	<p>II. 1.2. Shtazët sikur edhe bimët kanë nevoja të ndryshme jetësore, të cilat i plotësojnë në rrugë të ndryshme nëpërmjet funksionit të indeve, të organeve dhe të sistemeve të organeve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbulesa trupore-lëkura • Sistemi i lëvizjes • Sistemi skeletor • Sistemi muskolor • Sistemi nervor • Shqisat • Sistemi i frymëmarrjes • Sistemi i qarkullimit të gjakut • Sistemi urogenital 	<p>bëjnë me ndërtimin dhe me funksionin e indeve, të organeve dhe të sistemeve të organeve të kafshëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të hulumtojnë dhe të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionin e indeve, të organeve dhe të sistemeve të organeve të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve . - Të përshkruajnë ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme. - Të kuptojnë se organizmat janë në gjendje të mirëmbajnë mjedisin e brendshëm të tyre nga infeksionet, ndotësit etj. - Të parashikojnë ç’do të ndodh nëse një organ nuk funksionon, çrregullohet puna e tij ose e humb funksionin. -Të analizojnë, të sintetizojnë dhe të shfrytëzojnë parimet themelore të ndërtimit dhe të funksionit të sistemeve të gjalla në jetën e përditshme të tij. - Zbaton terminologjinë korrekte anatomike, kur shqipton topografinë e pjesëve të trupit të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve dhe të regjioneve të tyre 	<ul style="list-style-type: none"> • Kiminë, në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve te organeve. • Fizikën, në aspektin e njohjes së ligjshmërive fizike, si qarkullimi i materieve.
--	---	---	--	--

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
<p>III. Proceset jetësore</p>	<p>III. 1. Metabolizmi</p>	<p>III.1. 1. Qeniet e gjalla kryejnë funksione të ndryshme jetësore si fotosinteza, frymëmarrja etj. III.1. 2. Qeniet e gjalla kanë nevojë për ujë, oksigjen, dioksid karboni dhe materie të ndryshme organike dhe joorganike.</p>	<p>Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje mësimore duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me fotosintezën dhe frymëmarrjen qelizore. - Të shpjegojnë rolin e proceseve thelbësore jetësore – fotosintezës dhe frymëmarrjes, për qarkullimin e materies dhe rrjedhjen e energjisë. - Të përshkruajnë ndërlidhjen e procesit të fotosintezës dhe të frymëmarrjes qelizore. - Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e procesit të frymëmarrjes dhe të fotosintezës për funksionimin e organizmave. - Të vlerësojnë rolin e fermentimit në jetën e përditshme 	<p>Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Biokiminë, në aspektin e strukturës, aktivitetit dhe rolit të komponimeve kimike në metabolizëm në përgjithësi. • Kiminë, në aspektin e madhësisë së molekulave, gjendjes agregate të përbërësve qelizorë etj.

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
III. Proceset jetësore	III. 2. Cikli jetësor	<p>III. 2.1. Cikli jetësor – mitoza, mejoza;</p> <p>III. 2.2. Shtazët i kanë të zhvilluara organet për shumim, në të cilat prodhohen qelizat seksuale. Me bashkimin e qelizave seksuale krijohet zigota, pastaj vijon zhvillimi embrional, lindja, rritja, lënia e pasardhësve dhe vdekja. Disa organizma karakterizohen me zhvillim indirekt-metamorfazë.</p>	<p>Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje mësimore duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor. - Të kuptojnë dhe të përshkruajnë procesin e formimit të qelizave seksuale. - Të përshkruajë ndarjen qelizore-ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mitozës dhe mejozës - Të hulumtojnë dhe të përshkruajnë ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të zhvillimit embrional tek organizmat e ndryshëm. - Të hulumtojnë dhe të demonstrojnë fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës). - Të vlerësojnë rolin e shumimit në zhvillimin e botës së gjallë. 	<p>Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kiminë, në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të materialit trashëgues. • Anatominë, fiziologjinë, biokiminë.

PUNËT PRAKTIKE

Me fjalën punë praktike kuptojmë aktivitetet që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim të konkretizimi të pjesës teorike të lëndës.

Në mungesë të laboreve, punët praktike mund të kryhen edhe në klasë, me kusht që materiali dhe mjetet e punës praktike paraprakisht të sillen në klasë.

Punët laboratorike nuk janë ndonjë metodë e veçantë e mësimi, por janë formë e organizimit të punës mësimore, gjatë së cilës nxënësi në bashkëpunim me arsimtarin vrojtojnë strukturat, proceset dhe fenomenet e ndryshme jetësore gjatë eksperimentit, diseksionit dhe teknikës së mikroskopimit.

Punët praktike, të cilat do të duhej të realizoheshin në mësimin e biologjisë për klasën e shtatë, janë:

- Nxënësit gjatë vizitës në ndonjë kopsht zoologjik, gjatë ekskursionit mësimor ose në natyrë, të emërtojnë shtazë të ndryshme.
- Të demonstrojnë fermentimin nëpërmjet mufatjes së brumit të bukës pas shtimit të kërpudhës së tharmit.
- Të vrojtojnë me lupë ose me mikroskop parashtazorët: parameciumin, amebën ose kërbësorin e gjelbër në ujë të gjelbër të ndonjë moçali ose të materialit të përgatitur nga ju me ndihmën e arsimtarit.
- Të vrojtojnë me mikroskop qelizën shtazore.
- Të demonstrojnë ndikimin e dritës në procesin e fotosintezës
- Të eksperimentojnë ndërprerjen e dritës dhe të ujit te një bimë si dhe të përcillet reagimi i dritës.
- Të përcjellë zhvillimin embrional të bretkosa ose të pula.
- Të vrojtojnë dhe të analizojnë etapat e ciklit jetësor të bretkosa dhe të pula.
- Të vrojtojnë dhe të krahasojnë ndërtimin e jashtëm të gaforres dhe të bletës.
- Të determinojnë përfaqësues të caktuar të ujëtokësorëve, zvarranikëve ose të gupeve të tjera të shtazëve që jetojnë në mjedisin ku jeton.

METODOLOGJIA

Mësimi në biologji si dhe në çdo lëmë tjetër mund të kryhet në disa mënyra, d.m.th mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim i cili realizohet me metoda të ndryshme, ku secila sosh ka rol dhe rëndësi të veçantë metodike.

Çdo lëndë përpos metodave të përgjithshme mësimore, ka edhe metodat e veçanta. Prej metodave të shumta që mund të përdoren në mësimet e biologjisë po përmendim:

- Metodën e të shprehurit me gojë (monologu);
- Metodën e bashkëbisedimit (dialogu);
- Metodën e leximit dhe të punës me tekst;
- Metodën e punës praktike në laboratorin biologjik apo në terren (ekskursionet);
- Metodën e të mësuarit dhe të nxënit ndërveprues (p.sh. programe simuluese kompjuterike).

Çdo metodë mësimore ka anët pozitive dhe negative. Kjo do të thotë se me zbatimin e një metode të vetme mësimore nuk mund të realizohen të gjitha qëllimet dhe detyrat e mësimit të lëndës së biologjisë. Prandaj, ajo patjetër duhet të kombinohet në varësi nga përmbajtja, qëllimet dhe objektivat të cilat synohen të realizohen.

Prandaj, është kompetencë e arsimtarit, duke zbatuar strukturën ERR të orës, të zgjedhë materiale të shumëllojshme didaktike, metoda dhe strategji më të përshtashme të mësimdhënies dhe nxënies, me synim të realizimit të qëllimeve dhe të objektivave specifike, me nxënësin në qendër. (p.sh. **Kllaster, Kubimi, Insert, Tabela e koncepteve, Diagrami i Venit, Brainstorming, Xhigsou I dhe II etj.**)

Për hollësi të këtyre formave të punës me nxënës dhe të teknikave të mësimdhënies shih tekstat:

B. Musai; Modele të mësimdhënies së suksesshme, Tiranë, e-mail:rwct_ara@aedp-soros.al.

M. Mula. Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR të orës, Prishtinë, 2003. Email: office @ kec-ks.org,http://www. kec-ks. org

Plani dhe programi mësimor për kl. 9 dhe 10, Prishtinë, 2002 dhe 2003, f. 11 –14 dhe f.167-169.

Në praktikë thuaj nuk ekziston orë e biologjisë në të cilën aplikohet vetëm një metodë mësimore. Me zbatimin e disa metodave mësimore në të njëjtën orë të mësimit, ora bëhet më dinamike, thyhet monotonia dhe ngritet interesimi i nxënësve për mësim.

Çdo ndryshim në punë, pra edhe zbatimi i metodave të ndryshme mësimore, e freskon mësimin, e bën shumë më interesant, me çka arrihet që rezultatet në nxënie të jenë më të mira.

Për realizimin sa më të mirë të qëllimeve të parashtruara në orën mësimore duhet të punojmë në frymën e parimeve didaktike: prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja, prej makronivelit kah mikroniveli. (p.sh. organi, indi, qeliza, infrastrukturat qelizore).

Me fjalë të tjera, arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, në shkollë, në laborator, në natyrë etj., jo vetëm të memorizojë, por të mund të njohë, të vrojtojë, të radhisë, të masë, të shënojë, të mbledhë të dhënat, të eksperimentojë, të mbikqyrë. Pra, të kuptojë përmbajtjet programore duke vërtetuar e punuar. Ajo që dëgjon harrohet, ajo që sheh mbahet mend, ajo që sheh dhe punon kuptohet. Për të realizuar këtë synim, arsimtarit i ndihmojnë vivariumet, akuariumet, terrariumet, puna në terren-ekskursionet shkencore dhe puna në laborator. Për klasifikim të bimëve dhe të shtazëve të mjedisit ku jeton nxënësi, arsimtari e udhëzon atë si duhet të përdoren çelësat për determinim.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vërtetimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shikallë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në objektivat e dijes (rezultatet e prituara) të programit të lëndës së biologjisë për klasën VII.

Ky proces mbështet në disa parime themelore, siç janë:

- Përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- Zbatimi i instrumenteve përkatëse të matjes në përputhje me qëllimin, në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- Sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- Matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- Vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- Zbatimi i teknikave të vlerësimit me të cilat bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

Instrumentet e vlerësimit

Është me rëndësi që për veçoritë që duam t'i vlerësojmë duhet të përdorim mjetin apo instrumentin përkatës të matjes. Me çfarëdo mjeti që përdoret nuk mund të maten të gjitha veçoritë e arritshmërisë së nxënësit, andaj duhet përdorur sa më shumë që të jetë e mundshme mjete dhe teknika të ndryshme, në mënyrë që të mbledhim informacione të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- Vrojtimi;
- Pyetëtori (vetëvlerësimi);
- Raporti me shkrim i një pune praktike apo i një hulumtimi;
- Të shprehurit me gojë;
- Të shprehurit me shkrim;
- Fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- Dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- Testi i bazuar në kritere dhe në objektiva;
- Testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetjet) me
 - përgjigje alternative të shumta;
 - përgjigje të hapura të shkurta;
 - përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit, mësimor, çdo nxënës duhet të arrijë njërin prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumëmirë (arritje e lartë)
- mirë (arritje mesatare)
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin e përmbajtjes programore të biologjisë për klasën VII rekomandohet përdorimi i:

- Atlasi i përgjithshëm i zoologjisë, I. Zeneli Prishtinë 2000, Atlasi i anatomisë D. Rexhepi, H. Qerimi 2002 Prishtinë, Atlas i Biologjisë, A. Gashi, K. Abdullahu.

Fjalor me shpjegime terminologjike dhe përkufizime të zgjeruara

- Fjalor i biologjisë, E. Ruka, Zyri Bajrami, Toena, Tiranë, 1999.
- Fjalor i emrave të bimëve, F. Krasniqi et.al. 2004, Tiranë-Prishtinë.
- Çelësi i ilustruar me fotografi për determinimin e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve

Koleksione të literaturës së rëndësishme lidhur me temat e veçanta

- Gazeta, revista profesionale dhe shkencore, pastaj fotografi, posterë, skema, diagrame, harta, tabela, preparate, CD, videokaseta, burime nga interneti etj.

Burime nga interneti

<http://www.life.uiuc.edu/cgi-bin/plantbio/cell.cgi>

virtual plant cell from a University of Illinois project. qeliza bimore, struktura

<http://www.libfind.unl.edu/wglider/tutorial/animcell.html>

animal cell from a course at the university of Nebraska., qeliza shtazore, struktura

http://www.biology.arizona.edu/cell_bio/tutorials/pev/page2.html,

për baktere

<http://biology.edu/sciconn/lessons/mccandles/pev/page2.html>,

osmoza, difuzioni

<http://photoscience.la.asu.edu/photosyn/default.html>, frymëmarrja,

fotosinteza

<http://vector.cshl.org/dnaftb/DNA>, **acidet nukleike**

http://www.biology.arizona.edu/cell_bio.html cell cycle tutorial,

reprodukimi

<http://www.stg.broen.edu/ëebs/Mendelëeb/links> to mendels,

trashigimi

<http://www.massinteraction.org/html/genome/sickle> cell information-
trashëgimi

http://www.naturalia.org/ZOO/in_dexing.html. This is a virtual zoo site, **biodiversiteti**

<http://commetechlab.msu.edu/sites/dlc-me/zoo/-biodiversiteti>,
avertebrorët

<http://curry.edschool.virginia.edu/go/frog/home.html>, This site has a virtual frog dissection, **sistemet e organeve**

<http://arbl.cvmb.colostate.edu/hbooks/pathphys/endocrine/basics/control.html>,

endokrinologji, feed-back,

<http://www.psych.umn.edu/psylabs/mtfs/special.htm>.

Zhvillimi i bimëve, shtazëve, zigota, embrioni, fetusi, fara

Është kompetencë e arsimtarit që në vartësi prej kushteve në të cilat punon shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

PUNA PRAKTIKE NË LABORATOR DHE NË TERREN

Punët praktike dhe në terren janë pjesë e obligueshme e programit. Përmes punëve praktike në laborator dhe në terren nxënësi integron njohuritë teorike me praktikën.

Ekskursioni mësimor

Është një nga metodat me të efektshme për përvetësimin aktiv të njohurive teorike. Organizimi i mirë i ekskursionit zhvillon te nxënësi aftësinë e përvetësimit, vëzhgimit, analizës, sintezës, kujtesës logjike, intuitës, të menduarit të pavarur dhe krijues, që ndikojnë drejtpërdrejt në përvetësimin e vetëdijshëm dhe të qëndrueshëm të njohurive shkencore biologjike.

Që të mos merret nga nxënësit ekskursioni si ” një shëtitje thjeshtë në natyrë”, ai duhet të përgatitet mirë nga arsimtari. Kjo nënkupton se edhe arsimtari paraprakisht duhet të përgatitet për ekskursion, duhet të ketë përgatitje komplete profesionale biologjike dhe orientime të qarta didaktike. Puna përgatitore e arsimtarit për ekskursion:

Masat organizative dhe metodike

- Arsimtari duhet të njihet paraprakisht me terrenin e ekskursionit dhe në përputhje me qëllimet e temës së ekskursionit, cakton lokacionin (p.sh. lumi, livadhi, pylli, agrokultura, parku nacional etj).
- Të njohë mirë terrenin ku zhvillohet ekskursioni; botën bimore dhe shtazore të tij, konfiguracionin e terrenit etj. Për shkaqe didaktike, është mirë që rruga e kthimit të mos jetë e njëjtë me atë të shkuarjes.
- Nëpërmjet ekskursionit arsimtari i udhëzon nxënësit si të zotërojnë dhe të përvetësojnë vetë një vëllim njohurish sipas temës së ekskursionit.
- Përmes ekskursioneve në terren arsimtari këmbëngul që nxënësit të dallojnë thelbësoren nga jo thelbësorja në dukuritë e botës bimore dhe shtazore, të zbulojnë marrëdhëniet e brendshme dhe lidhjet e varësisë së ndërsjelltë midis gjallesave ku jetojnë, të mbajnë qëndrim vëzhgues, deduktues ndaj natyrës, me një fjalë të orientohen drejt në temën e ekskursionit.
- Pas kthimit nga ekskursioni mësimor, arsimtari jep këshilla si duhet të veprohet me materialin e mbledhur bimor apo shtazor.

Punët praktike

Në lëndën e biologjisë shumë me rëndësi është realizimi i vepritarisë vëzhguese eksperimentale, gjatë së cilës nxënësit stimulohen të mbledhin të interpretojnë të dhënat dhe të nxjerrin përfundime.

Kabineti i biologjisë (laboratori) dhe laboranti

Ato shkolla që kanë mundësi, mund të shfrytëzojnë internetin. Për punë praktike duhet të angazhohet **laboranti** i cili mirëmban pajisjet dhe mjetet mësimore, furnizon me material të nevojshëm (**bimë, shtazë, kultivon infuzorë** etj.). Bashkëpunon me arsimtarin dhe me nxënësit gjatë punës në laborator (kabinet) dhe terren. Punët në laborator dhe në terren i udhëheq arsimtari.

Është kompetencë e arsimtarit që në vartësi prej kushteve në të cilat punon shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

HYRJE

Lënda e kimisë për herë të parë në planet dhe programet mësimore, si lëndë e veçantë fillon nga klasa VII. Nxënësit tani kanë njohuri paraprake nga lëndët njeriu dhe natyra, biologjia, fizika etj., për disa veti të materialeve të ndryshme, për dukuri dhe ndryshime që ndodhin në natyrë. Kimia është shkencë natyrore, eksperimentale e cila objekt studimi ka strukturën, vetitë dhe ndryshimet e materies (substancave), si dhe ligjet në bazë të të cilave kryhen këto ndryshime. Kimia ka rolin kryesor në prodhimin e ushqimit, barërave, tekstilit, metaleve, masave plastike, materialeve ndërtimore, karburantëve, plehërave kimike, pesticideve dhe shumë lëndëve të tjera me rëndësi jetësore e industriale. Zhvillimi i kimisë ka ndikuar në përparimin e shkencave tjera. Kimia shfrytëzon edhe të arriturat e shkencave të tjera, si fizikës, matematikës, biologjisë, informatikës etj. Kimia nxit dhe zhvillon të menduarit kritik për të kuptuar, shpjeguar, sqaruar e analizuar përbërjen e materies dhe proceset që zhvillohen në natyrë dhe në laboratorin e kimisë.

QËLLIMET

Nxënësit të:

- Zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit e nocioneve kimike përmes aktiviteteve të ndryshme të cilat përfshihen në diskutime, punë eksperimentale dhe qasje të ndryshme të hulumtimit të problemeve.
- Frymëzojnë dhe të vlerësojnë se kimia si shkencë eksperimentale është pjesë e jetës sonë e cila e ndihmon dhe e përcjell njeriun gjatë tërë jetës.

- Zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehinë dhe shkathhtësinë për përdorimin e substancave kimike, mjeteve laboratorike, për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe të krijojnë kulturën për mbrojtjen e mjedisit.
- Formohen si personalitet me qëndrim autonom, kritik dhe me kulturë për bashkëpunim të ndërsjellë, me arsimtarë, prindër dhe komunitet shkollor dhe jashtëshkollor për avancimin e të menduarit kritik dhe të pavarur.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet:

Të njohin:

- Përbërjen dhe vetitë e materies: (elementet, komponimet, përzierjet, acidet, bazat, kripërat, lëngjet, gazrat, substancat e ngurta);
- Vetitë fizike: (forma, densiteti, tretshmëria, pika e vlimit, pika e shkrirjes, era, ngjyra);
- Vetitë kimike: (aciditetin, bazicitetin, reaktivitetin, përcjellshmërinë elektrike);
- Fenomenet që zhvillohen gjatë ndryshimeve kimike (transformimin e energjisë);
- Strukturën e materies (atomet, molekulat, jonet).

Të kuptojnë:

- Ligjet, rregullat, parimet në bazë të të cilave zhvillohen reaksionet kimike;
- Formulatat e komponimeve të thjeshta dhe të përbëra.

Të zbatojnë:

- Sistemin periodik të elementeve për grumbullimin e informatave: (simbolet, numrin atomik, masat atomike, grupet dhe periodat, numrin e e valencës elektronike, metalet, gjysmëmetalet dhe jometalet);
- Rregullat e Unionit Ndërkombëtar për Kimi të Pastër dhe të Zbatuar (IUPAC) për emërtimin e komponimeve kimike;

- Shprehjet matematike të formulave për përgatitjen e tretësirave me përqendrime të ndryshme.

Të analizojnë:

- Vetitë fizike dhe kimike (reaktivitetin e substancave elementare dhe të komponimeve);
- Shdërrimet fizike dhe kimike (llojet e reaksioneve, reaktantet dhe produktet dhe barazimin e reaksioneve kimike).

Të sintetizojnë:

- Elementet (hidrogjenin, oksigjenin, azotin etj.);
- Komponimet e thjeshta kimike (oksidet, kripërat, bazat, acidet).

Të vlerësojnë:

- Rëndësinë e substancave kimike për jetën;
- Efektet eventuale negative të disa substancave për mjedisin dhe ruajtjen e tij.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE			
Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve	%
I. Bazat e kimisë	1. Kimia shkencë natyrore	4	5.26
	2. Materia, format dhe struktura e saj	52	68,42
	3. Reaksionet kimike	10	13.16
	4. Komponimet inorganike dhe klasifikimi	10	13.16

Kategoria:	Nënkategoria:	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhjet ndërlëndore
I. Bazat e kimisë	I. 1. Kimia shkencë natyrore	<p>I. 1. 1. Kimia, objekti i studimit dhe rëndësia e saj (Roli i kimisë në jetën e përditshme dhe në industri)</p> <p>I. 1. 2. Laboratori i kimisë. (Mjetet që përdoren në laborator, rregullat dhe masat mbrojtëse)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të definojnë objektin e studimit të lëndës së kimisë 2. Të emërtojnë mjetet laboratorike sipas përbërjes dhe funksionit të tyre. 3. Të demonstrojnë shembuj të reaksioneve kimike që zhvillohen në natyrë dhe në laborator. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (përcaktimi i vetive të substancave, përdorimi i njësive matëse) ▪ Matematikë (të bëjnë njehsime) ▪ Biologji (vlerësimi i rëndësisë së kimisë për proceset jetësore) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti)
Kategoria:	Nënkategoria:	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhjet ndërlëndore
I. Bazat e kimisë	I. 2. Materia, format dhe struktura e saj	<p>I. 2. 1 Materia dhe vetitë e saj (Definimi i materies, korelacioni i materies dhe energjisë)</p> <p>I. 2. 2. Llojet e burimeve të energjisë në natyrë (Energjia solare, gjeotermale, hidroelektrike, e erës, e djegieve të</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë materien si përbërës i çdo gjëje në natyrë. 2. Të identifikojnë burimet e energjisë në natyrë (solare, gjeotermale, hidroelektrike të erës, djegieve të karburantëve fosile). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (njësitë matëse, përcaktimi i vetive të substancave, vetitë e ajrit, ujit llojet e energjisë) ▪ Matematikë (përdorimi i numrave

		<p>karburantëve fosile etj.)</p> <p>I. 2. 3. Shndërrimet fizike dhe kimike të materies (Dallimi midis shndërrimeve fizike dhe atyre kimike)</p> <p>I. 2. 4. Substancat kimike dhe klasifikimi i tyre (Vetitë fizike e kimike të substancave, gjendjet agregate)</p> <p>I. 2. 5. Substancat e pastra (elementet dhe komponimet) (Klasifikimi i substancave, vetitë e elementeve dhe komponimeve)</p> <p>I. 2. 6. Përzierjet dhe klasifikimi i tyre (Përbërja e përzierjeve, llojet, përzierjet homogjene dhe heterogjene)</p> <p>I. 2. 7. Ndarja e substancave të pastra nga përzierjet (Metodat për ndarje: filtrimi, dekantimi, distilimi, ndarja me magnet, sublimimi, ndarja me tretës etj.)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 3. Të përshkruajnë gjendjet agregate të substancave. 4. Të tregojnë shndërrimet kimike dhe ato fizike. 5. Të dallojnë substancat e pastra nga përzierjet dhe elementet nga komponimet. 6. Të klasifikojnë llojet e përzierjeve në bazë të përbërjes dhe gjendjes agregate (fizike) të tyre. 7. Të ndajnë substancat e pastra nga përzierjet me metoda laboratorike (filtrim, distilim, kristalizim, dekantim, sublimim etj.) 8. Të përdorin simbolet dhe formulat kimike për paraqitjen e elementeve dhe komponimeve kimike. 9. Të dallojnë përbërësit e ajrit (oksigjeni, azoti dhe dyoksidi i karbonit) dhe vetitë e tyre. 10. Të analizojnë ciklin e oksigjenit, azotit dhe të dyoksidit të karbonit në natyrë. 11. Të vlerësojnë rëndësinë e përbërësve të ajrit për proceset jetësore, si lëndë të para industriale dhe nevoja të tjera. 12. Të tregojnë vetitë karakteristike të ujit. 	<p>eksponencialë, llogaritja e valencave, e përqendrimeve të tretësirave)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (funksioni i energjisë në proceset jetësore, fotosinteza dhe frymëmarrja) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti.) ▪ Teknologji kimike (metodat e përfitimit të përbërësve të ajrit) ▪ Mbrojtja e mjedisit (klasifikimi dhe përshkrimi i ndotësve të ajrit dhe të ujit) ▪ Gjeografi (përhapja e ujërave në natyrë) ▪ Bujqësi (shfrytëzimi i ujit për ujtitje)
--	--	--	---	---

	<p>I. 2. 8. Simbolet dhe formulat kimike (Përdorimi i simboleve dhe i formulave molekulare)</p> <p>I. 3. 1. Ajri (Klasifikimi i përbërësve të ajrit)</p> <p>I. 3. 2. Oksigjeni (Përhapja në natyrë, vetitë, përfitimi, përdorimi, komponimet)</p> <p>I. 3. 3. Azoti (Përhapja në natyrë, vetitë, përfitimi, përdorimi, komponimet)</p> <p>I. 3. 4. Dyoksidi i karbonit (Përhapja, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 4. 1. Uji (Llojet e ujërave në natyrë, përhapja dhe cikli hidrologjik i ujit)</p> <p>I. 4. 2. Përbërja dhe vetitë e ujit (Përbërja kimike e ujit, përdorimi, vetitë fizike dhe kimike të ujit)</p> <p>I. 4. 3. Hidrogjeni (Përhapja në natyrë, vetitë, përfitimi, përdorimi, komponimet)</p>	<p>13. Të klasifikojnë llojet e ujërave në bazë të përhapjes së tyre në natyrë (atmosferike, sipërfaqësore dhe nëntokësore).</p> <p>14. Të analizojnë përbërësit e ujit me metodën e elektrolizës.</p> <p>15. Të vlerësojnë rëndësinë e ujit për zhvillimin e jetës, për nevoja të higjienës, amvisërisë, të industrisë, bujqësisë etj.</p> <p>16. Të tregojnë përhapjen, vetitë, përftimin, komponimet e hidrogjenit dhe përdorimin e tyre.</p> <p>17. Të definojnë atomin si mikrogrimcë dhe madhësinë e tij.</p> <p>18. Të dallojnë grimcat elementare të atomit sipas masës së tyre dhe ngarkesave elektrike të tyre.</p> <p>19. Të përdorin numrin atomik dhe numrin e masës për përcaktimin e llojit të atomit.</p> <p>20. Të dallojnë izotopet e elementeve në bazë të numrit të neutroneve në bërthamë.</p> <p>21. Të përcaktojnë nivelet energjetike të elektroneve në atom.</p> <p>22. Të identifikojnë grupet dhe periodat në tabelën e Sistemit periodik të elementeve</p> <p>23. Të tregojnë vetitë e elementeve</p>	<p>▪ Mjekësi (përdorimi i tretësirave fiziologjike)</p> <p>▪ Farmaci (përgatitja e barërave)</p>
--	---	---	--

	<p>I. 5. 1. Atomi, përbërja dhe madhësia e tij (Atomi si grimcë elementare, përbërësit e atomit)</p> <p>I. 5. 2. Mbështjellësi elektronik i atomit (Elektronet, masa dhe ngarkesa e elektronit, shpërndarja e tyre nëpër nivele energjetike)</p> <p>I. 5. 3. Bërthama e atomit përbërësit e saj dhe izotopet (Protonet, neutronet, masa dhe ngarkesa elektrike e tyre, izotopet e hidrogjenit)</p> <p>I. 5. 4. Ndërtimi i Sistemit periodik të elementeve (Historiku, periodat, grupet, klasifikimi i elementeve në metale, jometale dhe metaloide)</p> <p>I. 5. 5. Masat atomike relative dhe masat molekulare relative (Definimi, njehsimi i masave molekulare)</p> <p>I. 6. 1. Molekulat dhe përbërja e tyre</p>	<p>dhe pozitën e tyre në tabelën e Sistemit periodik.</p> <p>24. Të analizojnë vetitë periodike të elementeve në funksion të numrit atomik të tyre.</p> <p>25. Të përdorin tabelën e Sistemit periodik për klasifikimin e metaleve, jometaleve dhe metaloideve.</p> <p>26. Të përcaktojnë masën molekulare relative të molekulave të elementeve dhe komponimeve duke shfrytëzuar të dhënat e masave atomike relative nga tabela e sistemit periodik të elementeve.</p> <p>27. Të tregojnë se molekulat përbëhen prej dy ose më shumë atomeve.</p> <p>28. Të ilustrojnë formimin e joneve duke u arritur konfiguracioni elektronik i gazit inert.</p> <p>29. Të dallojnë atomet, kationet dhe anionet në bazë të ngarkesës elektrike të tyre.</p> <p>30. Të arsyetojnë formimin e lidhjes jonike si tërheqje të joneve me ngarkesa të kundërta.</p> <p>31. Të përshkruajnë vetitë fizike dhe kimike të komponimeve jonike.</p> <p>32. Të analizojnë elementet të cilat</p>	
--	---	---	--

	<p>(Molekulat e elementeve dhe të komponimeve)</p> <p>I. 6. 2. Lidhja jonike (Formimi i joneve dhe i lidhjes jonike)</p> <p>I. 6. 3. Lidhja kovalente (Formimi i lidhjes kovalente, lidhjet njëfishe, dyfishe dhe trefishe)</p> <p>I. 6. 4. Lidhja kovalente polare (Polarizimi i lidhjes të shembujt e thjeshtë)</p> <p>I. 6. 5. Valenca e elementeve kimike (Definimi i valences dhe përcaktimi i saj në shembuj të thjeshtë)</p> <p>I. 6. 6. Ndërtimi i formulave në bazë të valencës (Paraqitja e formulave strukturore në shembuj të thjeshtë)</p> <p>I. 9. 1. Tretja dhe tretshmëria (Nocionet, tretje, tretësirë, tretës, substancë e tretur)</p> <p>I. 9. 2. Llojet e tretësirave (Tretësirat e pangopura, të ngopura</p>	<p>formojnë lidhje jonike.</p> <p>33. Të përcaktojnë llojet e atomeve të cilat mund të formojnë lidhje kovalente midis vete.</p> <p>34. Të dallojnë lidhjen kovalente dhe kovalente polare nga ajo jonike në bazë të mënyrës së formimit të tyre.</p> <p>35. Të identifikojnë lidhjet kovalente njëfishe, dyfishe dhe trefishe në shembuj të thjeshtë.</p> <p>36. Të analizojnë strukturën e molekulave të hidrogjenit, ujit, klorit, oksigjenit, klorhidrikut, azotit dhe amoniakut.</p> <p>37. Të ndërtojnë modele molekulare për paraqitjen e ndërtimit të molekulave për shembuj të thjeshtë.</p> <p>38. Të zbatojnë valencën e elementeve për paraqitjen e formulave strukturore për shembuj të thjeshtë.</p> <p>39. Të demonstrojnë tretjen e substancave në ujë për shembuj të thjeshtë.</p> <p>40. Të dallojnë tretësirat sipas gjendjes agregate të komponenteve përbërëse.</p> <p>41. Të klasifikojnë tretësirat në bazë</p>	
--	--	--	--

		dhe të tejngopura) I. 9. 3. Pjesëmarrja e masës në përqindje e tretësirave (Definimi i pjesëmarrjes së masës dhe i përqindjes) I. 9. 4. Përgatitja e tretësirave me përqindje të caktuara (Llogaritja e pjesëmarrjes së masës dhe e përqindjes dhe përgatitja e tretësirave në shembuj të thjeshtë)	të sasisë së substancës së tretur (të pangopura, të ngopura dhe të tejngopura). 42. Të llogarisin pjesëmarrjen e masës në përqindje të tretësirave për shembuj të thjeshtë. 43. Të vlerësojnë rëndësinë e tretësirave për zhvillimin e proceseve jetësore. 44. Të përgatisin tretësira me përqendrime (në përqindje) të caktuara.	
Kategoria:	Nënkategoria:	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhjet ndërlëndore
I. Bazat e kimisë	I. 3. Reaksionet kimike	I.3. 1. LLojet e reaksioneve kimike (Reaksionet e analizës, sintezës, zëvendësimit dhe neutralizimit) I. 3. 2. Ekuacionet e reaksioneve kimike (Shkruarja dhe barazimi i reaksioneve kimike) I. 3. 3. Reaksionet termokimike (Reaksionet egzotermike dhe endotermike) I. 3. 4. Ligji i ruajtjes së masës	Nxënësit do të jenë në gjendje: 1. Të dallojnë reaksionet e analizës, sintezës, zëvendësimit dhe neutralizimit. 2. Të caktojnë koeficientët, gjendjet agregate të substancave reaguese dhe produkteve të reaksionit dhe të barazojë reaksionet kimike. 3. Të dallojnë reaksionet endoterme dhe ekzoterme. 4. Të zbatojnë ligjin e ruajtjes së masës gjatë barazimit të reaksioneve kimike në shembuj të thjeshtë. 5. Të arsyetojnë ligjin e raporteve të	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (reaksionet kimike në organizmat e gjallë) ▪ Fizikë (përcaktimi i vetive dhe i gjendjes agregate të substancave, përdorimi i njësive matëse sipas sistemit SI) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për reaksionet kimike)

		(Përshkrimi dhe zbatimi i ligjit të ruajtjes së masës) I. 3. 5. Ligji i raporteve të caktuara të masës (Përshkrimi dhe zbatimi i ligjit të raporteve të caktuara të masës) I. 3. 6. Llogaritjet në kimi (Llogaritja e masës së reaktantëve dhe të produkteve)	caktuara të masave për shembuj të thjeshtë. 6. Të llogarisin masën e reaktantëve dhe produkteve të reaksionit për reaksionet e thjeshta. 7. Të përdorin masat atomike relative dhe masat molekulare relative për përcaktimin e raportit të masave të elementeve në komponim.	
Kategoria:	Nënkategoria:	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhjet ndërlëndore
I. Bazat e kimisë	I. 4. Komponimet inorganike dhe klasifikimi	I. 4. 1. Oksidet (Lojet e oksideve, përbërja, vetitë e tyre, reaksionet e tyre me ujë) I. 4. 2. Acidet (Acidet sipas Arrheniusit, vetitë e tyre, reaksionet e tyre me baza) I. 4. 3. Bazat (Bazat sipas Arrheniusit, vetitë e tyre, reaksionet e tyre me acide) I. 4. 4. Kripërat (Formimi i kripërave nga acidet dhe bazat, përbërja, klasifikimi i	<i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i> 1. Të dallojnë komponimet inorganike sipas përbërjes dhe vetive të tyre. 2. Të klasifikojnë llojet e oksideve në bazë të reaksionit të tyre me ujë dhe produkteve që formojnë. 3. Të identifikojnë acidet, bazat dhe kripërat në bazë të teorisë së Arrheniusit . 4. Të demonstrojnë reaksionet e acideve dhe bazave me indikatorë (letër lakmushi, metiloranzh, fenolftaleinë). 5. Të klasifikojnë acidet në bazë të numrit të joneve H^+ (H_3O^+) që mund	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (komponimet e rëndësishme për botën e gjallë) ▪ Fizikë (përcaktimi i vetive të komponimeve inorganike) ▪ Bujqësi (përdorimi i komponimeve inorganike në bujqësi) ▪ Mjekësi (përdorimi i tretësirave fiziologjike) ▪ Mbrojtja e

		<p>kripërave)</p> <p>I. 4. 5. Elektrolitët (Klasifikimi dhe vetitë e elektrolitëve)</p> <p>I. 4. 6. Nomenklatura e komponimeve inorganike (Rregullat për emërtimin e oksideve, acideve, bazave dhe kripërave)</p>	<p>të zëvendësohen me metal.</p> <p>6. Të dallojnë bazat sipas numrit të joneve OH- që zëvendësohen me mbetje acidike.</p> <p>7. Të tregojnë shembuj për formimin e kripërave acidike, bazike dhe neutrale.</p> <p>8. Të vlerësojnë cilat tretësira janë përçues të elektricitetit.</p> <p>9. Të emërtojnë komponimet inorganike sipas rregullave IUPAC.</p>	<p>mjedisit (klasifikimi dhe përshkrimi i ndotësve të mjedisit)</p> <p>▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponimet inorganike)</p>
--	--	---	--	--

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe programit të kimisë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe tërë një kompleks procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike, siç janë: vizatime, diagrame, modele, grafikone, kimikate, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkore, kompjuter etj.)

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, nga se nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehjeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të kimisë, veçanërisht të atyre që u nevojiten për zgjidhjen e problemeve të përditshme.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma të punës dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (përmes shpjegimit, sqarimit, ushtrimeve praktike dhe shembujve);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejtë (përmes shqyrtimit, zbulimit, zgjidhjes së problemeve);
- Konstruktivizmi dhe mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (përmes grupeve të vogla, grupeve më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti kompjuterit;
- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe objektet industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi. Vlerësimi si një sistem i gjërë që mbështetet në procesin e të nxënimit të nxënësve përfshinë kategoritë e vlerësimit:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ, i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e pëgjithshëm të të nxënimit e nxënësit (përgjigjet me gojë, projektet, punimet seminarike, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe provimeve etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta të vlerësimit dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një semestër ose gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimit i shërbejnë mësimdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojnë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;

6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhshmen;
7. Të reflektojnë për përmirësimin e mësimdhënies bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimdhënia dhe mësimnxënia e planit dhe e programit të kimisë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme të informimit:

- 1) Laboratori (kabineti) i kimisë ose laborator mobil.
- 2) Teksti i kimisë, doracak për mësimdhënë, praktikume, fletore pune.
- 3) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 4) Sistemi periodik i elementeve, fotografi, modele, skema, diagrame, makete, koleksionar të mineraleve.
- 5) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 6) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 7) Nexhat Daci, Rexhep Mehmeti, Muhamet Bicaj, Xhavit Ahmeti, KIMIA për klasën VII, Libri Shkollor, Prishtinë.
- 8) Muhamet Bicaj, Mandushe Berisha, Ismet Hashani, KIMIA 9, Libri Shkollor, Prishtinë.
- 9) Dr. I. Filipoviq, Dr. S. Lipanoviq (shqipëruar nga Dr. Xhavit Ahmeti), KIMIA E PËRGJITHSHME DHE INORGANIKE, Prishtinë.
- 10) FJALORI I KIMISË, SH.B. ‘8 Nëntori’ Tiranë.
- 11) Bardhyl Musai, METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, Tiranë, 2003.
- 12) Grup autorësh, METODAT E MËSIMDHËNIES, (Manual për mësuesit e rinj).
- 13) Literatura tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimdhënësit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t’i takojë edhe nxënësit.

HYRJE

Në këtë vit, niveli shkencor i fizikës ngritet më lart, por gjithnjë duke pasur parasysh moshën dhe aftësitë psiko-fizike të nxënësve. Nxënësit do t'i marrin njohuritë elementare të dukurive dhe të ligjeve fizike. Me disa prej tyre ata do të njihen për të parën herë (gazet dhe lëngjet në qetësi, ndërtimi grimcor i lëndës, valët dhe zëri), kurse disa prej tyre janë thellim i njohurive mësimore të klasës VI (puna dhe energjia, rryma elektrike). Për shkak të rëndësisë së tyre, këto njësi mësimore duhet të përsëriten në mënyrë që njohuritë e fituara më parë të kuptohen më mirë, si dhe të ngritet niveli i tyre shkencor, duke futur konceptin e forcës dhe lëvizjen e orientuar të elektroneve.

Nëpërmjet lëndës së fizikës, nxënësit do të njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e ligjeve të natyrës. Në këtë mënyrë ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë dhe fitojnë shkathtësi jetësore e shprehi të punës.

Fizika si shkencë e natyrës së bashku me shkencat e tjera ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së fizikës për klasën e shtatë ka për qëllim :

- Zvillimin e aftësive të nxënësit për vrojtimin e dukurive fizike, përgjithësimin dhe zbatimin e tyre në zgjidhjen e detyrave praktike dhe problemeve të jetës së përditshme.
- Zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të përhershme për të matur madhësitë e ndryshme fizike, përpunimin e të dhënave eks-

perimentale dhe zbatimin e tyre në situata konkrete për të ruajtur mjedisin jetësor.

- Zhvillimin e shprehive për kursimin e energjisë dhe shfrytëzimin racional të saj.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- 1. Të përshkruajë dukuritë fizike, përbërjen e lëndës, vetitë karakteristike të lëndës, madhësitë që i ndërlidhin ato dhe njësitë matëse të madhësive**
 - Të tregojë se lënda është e ndërtuar prej grimcave (*molekulave, atomeve, joneve, elektroneve etj.*) dhe se ka **disa** veti karakteristike, të cilat lidhen me përbërjen dhe strukturën e saj;
 - Të tregojë vetitë e vrojuara të lëndës në modele të thjeshta (p.sh. duke përdorur modelin e grimcave të sqarohet tretshmëria, difuzioni, përqendrimi dhe dendësia e lëndës);
 - Të tregojë se forcat mund të shkaktojnë ndryshime në trupa dhe në sisteme fizike por, ashtu që vetitë e përgjithshme të lëndës dhe të energjia mbeten të pandryshuara;
 - Të përshkruajë se energjia paraqitet në lloje të ndryshme e cila mund të bartet dhe të shndërrohet në lloje të tjera.
- 2. Të shpjegojë se shumë dukuri fizike (termike, periodike, elektrike) mund të sqarohen duke u bazuar në ndërtimin grimcor të lëndës**
 - të ilustronjë dhe të sqarojë me shembuj nga jeta e përditshme se gjendjet agregate, dukuritë sipërfaqësore dhe kapilare janë pasojë e veprimit të forcave molekulare;
 - të shpjegojë se energjia paraqitet në lloje të ndryshme, e cila mund të bartet dhe të shndërrohet në lloje të tjera;
 - të japë shembuj nga jeta e përditshme për lëvizjet periodike, lëkundjet dhe valët;
 - të shkruajë në mënyrë simbolike shprehjen e punës ($A = F \cdot s$); të fuqisë ($P = \frac{A}{t}$); të ligjit të Ohmit ($U = IR$); të shpejtësisë së valëve ($c = \lambda f$); të energjisë së rrymës elektrike ($E = Q = U \cdot I \cdot t$) etj., dhe t'i përdorë këto shprehje për zgjidhjen e detyrave praktike;

- të shpjegohen lidhjet kualitative dhe kuantitative duke u shërbyer me vrojtimit dhe të dhënat për bartjen dhe shndërrimet e energjisë (p.sh. *varësia e shpejtësisë së trupave dhe e valëve nga dendësia e mjedisit ose varësia e shpejtësisë së trupave nga lartësia e pengesës, gjatësia e sustës elastike në krahasim me intensitetin e zërit*).
- 3. Të zbatojë njohuritë e fituara për matjen e madhësive të ndryshme fizike dhe zgjidhjen e detyrave praktike nga jeta e përditshme**
- të përdorë njësitë dhe veglat për matjen e shtypjes (*manometrat dhe barometrat*) instrumentet për matjen e tensionit, intensitetit, rezistencës dhe fuqisë së rrymës dhe ta ilustrojë degëzimin e rrymës në një qark elektrik;
 - të matë (p.sh. *kohën, largësinë, forcën, punën dhe fuqinë*) dhe të llogaritë madhësitë që e karakterizojnë lëvizjen e trupave dhe bashkëveprimin e tyre brenda sistemit fizik (p.sh. *forcën, shpejtësinë, energjinë potenciale dhe kinetike*).
 - të demonstrojë punën mekanike dhe fuqinë që zhvillon një forcë, prodhimin e zërit në shembuj praktikë etj.
 - të matë madhësitë që kanë të bëjnë me llojet e energjisë (p.sh. *temperaturën, masën, shpejtësinë, largësinë, sasinë e elektricitetit, intensitetin e rrymës elektrike, të tensionit dhe të rezistencës elektrike*).
- 4. Të kombinojë njohuritë teorike, demonstrimet dhe matjet eksperimentale për shpjegimin e drejtë të dukurive fizike**
- të vërë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gazët, duke marrë parasysh ndërtimin molekular të lëndës.
 - të identifikojë dhe të klasifikojë faktorët që shkaktojnë ndryshime brenda një sistemi fizik (p.sh. *forca, shtypja dhe nxehtësia*).
 - të identifikojë dhe të parashikojë se ç' do të ndërrohet dhe ç' do të mbetet e pandryshuar kur lënda i nënshtrohet veprimit të forcave të jashtme ose ndërrimit të energjisë (p.sh. *krahasimi i forcave, i largësive dhe i punës të makinat e thjeshta*).
- 5. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**
- të kuptojë përparësitë dhe kufizimet që i ofron lënda;
 - në ndikimin e sjelljeve personale (*të jetë i ndershëm, tolerant, i hapur të ketë*
 - *vullnet, të jetë kooperativ, kritik, krenar etj.*)

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE
(2 orë në javë , 74 orë në vit)

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja %
I. Pozita dhe lëvizja e trupave	I.1.Dukuritë periodike në mjedisë të vazhduara	16	21,22
	I.2 Gazet dhe lëngjet	18	24,35
	I.3.Trupat dhe vetitë e tyre	10	13,55
II. Lëvizja kaotike dhe dukuritë termike	II.1.Struktura molekulare-kinetike e lëndës	12	17,22
III. Dukuritë elektrike dhe magnetike të lëndës	III.1. Vetitë elektrike dhe magnetike të lëndës	18	24,35
	Gjithsej	74	100

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRLËNDORE
I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE	I.1 DUKURITË PERIODIKE NË MJEDISE TË VAZHDUARA	Lëkundjet dhe valët <ul style="list-style-type: none"> • Lëvizjet periodike. • Formimi i valëve, llojet dhe karakteristikat e tyre. • Shpejtësia e valëve. • Interferenca e valëve • Reflektimi dhe thyerja e valëve. Zëri <ul style="list-style-type: none"> • Zëri. Burimet dhe karakteristikat e zërit. • Jehona. 	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptojë mënyrën e krijimit të lëkundjeve dhe valëve në mjediset lëndore, llojet e valëve dhe karakteristikat e tyre (frekuencën, shpjetësinë, periodën dhe gjatësinë valore). 2. Të shpjegojë se valët mund të thyhen dhe të reflektohen. 3. Të shpjegojë se përhapja e zërit bëhet në formë të valëve ngjashëm me valët në sipërfaqen e ujit. 	Këto njësi mësimore lidhen me të gjitha shkencat natyrore dhe teknike, sidomos me informatikën dhe me jetën e përditshme. Komunikimi ndërmjet njerëzëve dhe gjallesave të ndryshme vendoset pikërisht me anë të valëve. Po ashtu me anë të valëve bëhen edhe studimet tekniko - shkencore të materialeve që përdoren në ndërtimtari, në industri dhe në bujqësi.
KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRLËNDORE
I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE	I.2. GAZET DHE LËNGJET	Gazet dhe lëngjet në qetësi <ul style="list-style-type: none"> • Shtypja. • Shtypja atmosferike. • Shtypja në lëngje dhe gaze. Ligji i Paskalit. • Shtypja hidrostatike 	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përkufizojë forcën e shtypjes dhe ta identifikojë atë në disa shembuj që i jepen. 2. Të përshkruajë një eksperiment që demonstroi varësinë e shtypjes nga sipërfaqja dhe forca pingule. 	Koncepti i shtypjes është me rëndësi të posaçme për teknikën, astronominë dhe në shkencat natyrore, si në biologji e kimi. Po ashtu, është me rëndësi edhe në

		<ul style="list-style-type: none"> • Enët komunikuese • Parimi i lundrimit. Ligji i Arkimit • Shtypja e gazeve në enë të mbyllura. • Manometrat. 	<p>3. Të shpjegojë varësinë e shtypjes hidrostatike nga thellësia e trupit të zhytur dhe nga dendësia e lëngut.</p> <p>4. T'i përdorë veglat për matjen e shtypjes (barometrat dhe manometrat) dhe t'i lexojë drejt vlerat që tregojnë ato.</p> <p>5. Të dallojë kuptimin e zhytjes, notimit dhe lundrimit në jetën e përditshme.</p>	gjeologji dhe në agronomi. Në biologji, me anë të shtypjes osmotike sqarohet si ngriten lart në bimë materiet ushqyese bashkë me ujin.
KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRLËNDORE
I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE	I.3. TRUPAT DHE VETITË E TYRE	Puna dhe energjia <ul style="list-style-type: none"> • Forca. • Puna, nxehtësia dhe energjia. • Fuqia. 	Nxënësi duhet të jetë në gjendje <p>1. Të demonstrojë me shembuj të ndryshëm se kur kryhet punë mekanike.</p> <p>2. Të ilustrojë mënyrat e shndërrimit të energjisë në lloje të tjera.</p> <p>3. Të tregojë me shembuj konkretë lidhjen e punës me energjinë.</p>	Këto koncepte janë aq shumë të rëndësishme saqë i hasim në të gjitha shkencat natyrore dhe teknike dhe kudo në jetën e përditshme.
KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRLËNDORE
II. LËVIZJA KAOTIKE	II.1. STRUKTURA MOLEKULARE-	Ndërtimi i lëndës Përbërja e lëndës (molekulat dhe atomet)	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: <p>1. Të përshkruajë se lënda është e ndërtuar prej molekulave,</p>	Koncepti i ndërtimit molekular dhe atomik i lëndës përdoret me të

DHE DUKURITË TERMIKE	KINETIKE E LËNDËS	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëveprimi ndërmjet molekulave. • Energjia termike. • Përqendrimi i lëndës. • Dendësia e lëndës. • Dukuria e difuzionit. • Disa dukuri sipërfaqësore në lëngje: <ul style="list-style-type: none"> a) dukuria e lagies; b) dukuritë kapilare. 	<p>atomeve dhe grimcave të tjera përbërëse.</p> <p>2. Të përshkruajë një dukuri që tregon se molekulat lëvizin dhe se ndërmjet tyre ka hapësira të lira.</p> <p>3. Të përshkruajë dukuritë sipërfaqësore, kapilare dhe difuzionin si pasojë e veprimit të forcave molekulare.</p> <p>4. Të identifikojë energjinë termike me energjinë e nxehtësisë dhe ta shpjegojë atë si pasojë e lëvizjes kaotike të molekulave të një lënde.</p>	<p>madhe në sqarimin e shumë dukurive në kimi, biologji, mjekësi, astronomi etj. Po ashtu, edhe koncepti i difuzionit aplikohet në mjekësi, kimi , biologji etj.</p>
KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRLËNDORE
III. DUKURITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS	III.1. VETITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS	<p>Rryma elektrike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rryma elektrike njëkahore. • Intensiteti i rrymës elektrike. • Ampermetri. • Tensioni i rrymës elektrike. • Voltmetri. • Rezistenca elektrike. Reostatet. • Ligji i Omit për një pjesë të qarkut elektrik. • Intensiteti i rrymës në qarkun 	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <p>1. Të shpjegojë rrymën elektrike si lëvizje e orientuar e elektroneve të lira nëpër një përçues.</p> <p>2. Të vizatojë dhe të ndërtojë qarkun elektrik sipas skemës së dhënë dhe të identifikojë pjesët kryesore të tij.</p> <p>3. Të demonstrojë shndërrimin e energjisë elektrike në nxehtësi nëpërmjet rezistencës elektrike.</p> <p>4. Të matë madhësitë elektrike me</p>	<p>Këto njësi mësimore janë të lidhura me shkencat natyrore, teknike dhe lidhën me jetën e përditshme aq shumë sa që sot nuk mund të mendohet jeta pa to.</p>

		<p>e degëzuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lidhja e rezistencave: a) lidhja në seri e rezistencave; b) lidhja paralele e rezistencave. • Puna dhe fuqia e rrymës elektrike. 	<p>ndihmën e instrumenteve matëse (voltmetri, ampermetri, ommetri dhe vatmetri) dhe të shprehë me gojë dhe me shkrim lidhjen ndërmjet tensionit, rezistencës dhe intensitetit të rrymës. ($U = I \cdot R$).</p> <p>5. Të demonstrojë lidhjen serike dhe paralele të rezistorëve në mënyrë skematike dhe praktike dhe të përdorë formulën për energji të rrymës elektrike</p> $E = Q = U \cdot I \cdot t.$	
--	--	--	--	--

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përvoja ka treguar se realizimi i procesit të mësimdhënies me metoda të ndryshme, është shumë më efektiv dhe i suksesshëm. Prandaj, edhe mësimi i fizikës duhet të bëhet duke i shfrytëzuar dhe duke kombinuar metodat e ndryshme të mësimimit. Këtu do t'i numërojmë vetëm ato metoda të cilat më shpesh dhe më shumë përdoren, e këto janë:

- Metoda e të shprehurit me gojë
- Metoda e bashkëbisedimit (këtu hyn edhe metoda aktive e mësimdhënies)
- Metoda e demonstrimit
- Metoda e punës eksperimentale

Përveç këtyre metodave, përdoren edhe metoda dhe teknika të tjera të mësimdhënies, p.sh., **metoda interaktive**, e cila është mjaft produktive me punën në grupe dhe në ekipe të nxënësve. Arsimitari i fizikës duhet t'i përdorë të dy këto metoda, **aktive** edhe **interaktive**.

Mirëpo, kombinimi i këtyre metodave mësimore është më i suksesshëm, sepse zgjon kureshtjen dhe nxit interesimin e nxënësve. Mandej, pason zbatimi konkret dhe praktik i njohurive në zgjidhjen e detyrave, që te nxënësi krijon kujtesë të pashlyeshme.

VLERËSIMI I DITURIVE TË NXËNËSVE

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike dhe të vazhdueshme, analizimit dhe interpretimit të të dhënave me qëllim të përcaktimit se në ç'shikullë nxënësi i ka zotëruar objektivat e përgjithshëm dhe specifike të lëndës së fizikës.

Qëllimi i vlerësimit tregon cakun përfundimtar të një lloji vlerësimi, rezultatin përfundimtar që shtrohet për t'u arritur me një metodë të caktuar të vlerësimit.

Në mënyrë që arsimtarit t'i lehtësohet puna e tij me nxënësin, i sugjerohet të punojë me këto teknika dhe lloje të vlerësimit:

- **Vlerësimi sipas aktivitetit**

Arsimitari duhet ta pranojë nxënësin partner të bashkëbisedimit. Prandaj, duke provuar që nxënësin ta kyçë në bashkëbisedim gjatë procesit të mësimimit, njëkohësisht do ta vlerësojë sa është në gjendje të përvetësojë njehsinë mësimore. Në këtë mënyrë, nxënësi do të jetë vazhdimisht aktiv

në marrjen e përfundimeve për ligjshmëritë që zotërojnë një dukuri fizike. Nxënësit e ndryshëm, për të njëjtën problematikë, mund të arrijnë në përfundime të ndryshme.

- **Vlerësimi me gojë (intervista)**

Ka nxënës që janë mjaft të përgatitur, por janë të tërhequr, jo aq aktivë dhe nuk marrin pjesë në bashkëbisedim. Për këtë arsye arsimtari duhet këta nxënës t'i thërrasë dhe t'i pyetë me gojë në mënyrë klasike, në mënyrë që arsimtari të kuptojë nivelin e arritshmërisë së tyre. Edhe kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi me tërë nxënësit e klasës.

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste të pyetjeve arsimtarit i ofron pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që arsimtari do t'i kushtojë mënyrës së drejtë të përpilimit të testeve, duke pasur parasysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksonomisë së Blumit, të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza dhe sinteza. Në çdo njërin gjysmëvjetor përpilohet nga një test me qëllim që arsimtari të krijojë një përfytyrim për dituritë e përvetësuar.

- **Vlerësimi nga zgjidhja e detyrave në klasë dhe në shtëpi**

Në programin e fizikës për klasën VII janë paraparë zgjidhje detyrash, detyra për përsëritje dhe detyra kontrolli. Në këtë rast nxënësit duhet vazhdimisht të kyçen në zgjidhjen e këtyre detyrave në tabelë apo në fletore. Ky aktivitet i nxënësve duhet të merret si parametër për vlerësimin e diturisë.

- **Vlerësimi me anë të testeve**

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste arsimtarit i ofron pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që arsimtari do t'i kushtojë mënyrës së drejtë të përpilimit të testeve, duke pasur parasysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksonomisë së Blumit të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza dhe sinteza. Në çdo gjysmëvjetor përpilohet nga një test vlerësues dhe nga një test i pëparimit dhe në fund të vitit një test përfundimtar (përmbledhës).

- **Vlerësimi sipas aktivitetit në laboratorin e shkollës**

Në ato shkolla ku ekziston kabineti i fizikës, arsimtari sipas programit do të demonstrojë ose do të kryejë ndonjë matje të ndonjë madhësie ose dukurie fizike. Pikërisht gjatë këtij angazhimi të arsimtarit, disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktivë se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë arsimtarit në procesin e demonstrimit apo të matjes apo do ta kryejnë në mënyrë të pavarur ashtu që ky aktivitet merret si një nga parametrat për vlerësimin e diturive të tyre.

- **Vlerësimi i punës së pavarur praktike të nxënësve në shkollë dhe në shtëpi**

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga përcjellja e aktivitetit të tyre në punën praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimtari detyra konkrete të cilat do t'i realizojnë në mënyrë praktike.

HYRJE

Me lëndën e historisë në klasën VII pretendohet të bëhet njohja e nxënësve për rrjedhojat e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore nga shekulli XI e deri në fillim të shekullit XIX (1814).

Përmes lëndës së historisë mundësohet zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të nxënësve si nga aspekti human, ekonomik, shoqëror, kulturor, politik etj.

Lënda e historisë në klasën VII synon të zhvillojë të menduarit kritik dhe hulumtimin dhe përdorimin e burimeve historike, duke veçuar rëndësinë e tyre.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së historisë për klasën VII ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të njohur dhe për të kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore prej shekullit XI deri më 1814.
- Zhvillimin e aftësive për të njohur dhe për të kuptuar mënyrat e jetesës, të menduarit, personalitetet historike, vendet dhe institucionet shoqërore e shtetërore, besimet, të arriturat ekonomike, shkencore, kulturore etj.
- Zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të nevojshme për njohjen, kuptimin, përpunimin dhe zbatimin e të dhënave të ndryshme historike në situata të caktuara.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të njohin

- Domethëniet e termave historike nga mesjeta dhe të kapitalizmit
- Ngjarjet më kryesore nga periudhat e përmendura
- Personalitetet kryesore shqiptare, rajonale dhe botërore të këtyre periudhave

Të kuptojnë

- Karakteristikat e feudalizmit të zhvilluar dhe karakteristikat e kapitalizmit.
- Konceptet dhe parimet e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, arsimore, shkencore, religjioze etj., nga shekulli XI e deri më 1814.
- Ligjshmërit e zhvillimeve demokratike dhe avancimin e lirive dhe të drejtave të njeriut

Të zbatojnë

- Informacionet historike për zgjidhjen e situatave të ndryshme që paraqiten në shoqëri
- Format e mundshme për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në shoqëri

Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera

- Vlerësimin e të arriturave të shoqërisë njerëzore gjatë këtyre periudhave.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri
- Për ruajtjen dhe kujdesin për trashëgiminë arkeologjike, monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj.

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhjet programore
III. MESJETA	1. Jeta ekonomike, politike dhe institucionet shtetërore në Evropën Perëndimore	<p><i>Nxënësit duhet të mësojnë për:</i></p> <p>Shoqëria në mesjetën e zhvilluar Shoqërinë gjatë feudalizmit të zhvilluar. Zhvillimin e qyteteve mesjetare. Luftërat kryqtare. Zhvillimin e kulturës etj.</p> <p>(4 orë)</p>	<p><i>Nxënësit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Dinë karakteristikat e feudalizmit të zhvilluar. - Janë aftësuar të shpjegojnë mënyrën e organizimit të vendbanimeve dhe të jetesës në qytete dhe në fshatra. - Kuptojnë shkaqet dhe pasojat e luftërave kryqtare, zhvillimin kulturor etj. - Duhet t'i kuptojnë konceptet: feudal, bujkrob, qytet mesjetar, feude, kryqëzatë etj. 	<p><i>Me:</i></p> <p>Gjeografinë, edu katën qytetare, artin, letërsinë etj.</p>
III. MESJETA	1. Jeta ekonomike, politike dhe institucionet shtetërore në Evropën Perëndimore	<p>Evropa në Shekujt XI - XV Shtetet kryesore të Evropës Perëndimore: Franca, Anglia, Italia, Spanja dhe Portugalia. Gjermania e Italia gjatë kësaj periudhe.</p> <p>(5 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dinë për shtetet kryesore të Evropës, zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror, marrëdhëniet e ndërsjella midis tyre dhe specifikat e tjera. - Identifikojnë personalitetet më të njohura të kohës, të arriturat ekonomike, kulturore, shkencore etj. 	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë etj.</p>

III. MESJETA	4. Lindja e Largët gjatë mesjetës	Perandoritë e Mëdha të Lindjes Lindja dhe zhvillimi i shtetit mongol, shtetit kinez dhe të shtetit osman gjatë kësaj faze të feudalizmit. (2 orë)	- Kuptojnë veçoritë shoqërore, ekonomike dhe kulturore të perandorive të Mëdha të Lindjes.	Letërsinë, artin, gjeografinë etj.
	3. Ballkani gjatë mesjetës	Arbëria në shekujt XI - XV Fuqizimi i princërve arbër dhe krijimi i Shtetit të Arbërit. Pushtimet e Rashës. Kultura dhe monumentet kulturoro-historike të periudhës bizantine në Arbëri. Principatat shqiptare në shekujt XII-XIV, Betejën e Kosovës (1389). Pushtimet osmane. Pengmarrjen dhe rekrutimin e fëmijë ve nga osmanët. Luftën e Skënderbeut kundër osmanëve. Marrëdhëniet e Skënderbeut me Evropën si dhe për Skënderbeun si personalitet historik. (13 orë)	- Dinë për zhvillimet në Arbëri, Shtetin e Arbërit, Principatat shqiptare, pushtimet e Rashës. - Kuptojnë rrethanat në të cilat u zhvillua dhe ndryshimet që solli në Ballkan Beteja e Kosovës (1389) - Dallojnë monumentet kryesore kulturoro-historike të periudhës bizantine në trojet shqiptare - Njohin sistemin e pengmarrjes së fëmijëve dhe rekrutimin e tyre nga ushtria osmane. - Dinë për qëndresën e popullit shqiptar, shtetin e Skënderbeut, figurën dhe rolin e tij në historinë kombëtare dhe botërore.	Letërsinë, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare etj.

IV. KOHA E RE	1. Rilindja, reforma dhe kundërreforma	Humanizmi dhe Rilindja Humanizmi dhe Rilindja evropiane, humanistët kryesorë evropianë e shqiptarë të kësaj periudhe. (2 orë)	- Dinë raportet dhe faktorët që ndikuan në lindjen dhe zhvillimin e ideve humaniste dhe të Rilindjes. -Dinë për përfaqësuesit kryesorë të kësaj lëvizje në Evropë dhe te shqiptarët.	Letërsinë, artin, edukatën qytetare etj.
		Reforma dhe kundërreforma katolike Reformat kishtare në disa shtete të Evropës dhe kundërreformat e ndërmarra nga kisha katolike (2 orë)	-Dinë shkaqet që ndikuan në fillimin e reformave kishtare. -Dinë karakteristikat themelore të procesit të reformave dhe të kundërreformave. -Dinë pasojat e fushatës së kundërreformacionit.	Gjeografinë, letërsinë, artin, edukatën qytetare etj

IV. KOHA E RE	2. Zbulimet e mëdha gjeografike	Zbulimet e mëdha gjeografike Zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe zbulimet e mëdha gjeografike. (2 orë)	-Dinë për rrethanat që ndikuan në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare. -Dinë për zbulimet e mëdha dhe shumë të rëndësishme në tërë botën. -Identifikojnë ndikimet pozitive që sollën zbulimet gjeografike në rrjedhat e mëvonshme të zhvillimit shoqëror.	Gjeografinë, artin, teknologjinë, fizikën, matematikën etj.
IV. KOHA E RE	3. Evropa gjatë kohës së Re	Mbretëritë e mëdha evropiane Ekonomia evropiane në shekujt XV-XVII. Francën gjatë shekujve XVI – XVII dhe Anglinë në kohën e Elizabetës I. (3 orë)	-Dinë për zhvillimet ekonomike të shteteve evropiane në shekujt XV-XVII. -Dinë esencën e marrëdhënieve shoqërore, duke pasur për bazë shoqërinë angleze dhe atë franceze.	Gjeografinë, edukatën qytetare etj
		Evropa në kohën e absolutizmit Franca në kohën e Luigjit XV dhe XVI. Anglia në kohën e Oliver Kromvellit. Revolucionin e vitit 1688 në Angli. Rusia në kohën e Petrit të Madh. (4 orë)	-Dinë karakteristikat themelore të shteteve evropiane në kohën e absolutizmit. -Identifikojnë personalitetet kryesore dhe të arriturat në fushën e marrëdhënieve shoqërore dhe ekonomike.	Edukatën qytetare, gjeografinë etj.

IV. KOHA E RE	6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika	<p>Idetë e reja përparimtare - iluminizmi Iluminizmin si rrymë e re mendore e kulturore - përfaqësuesit kryesorë, Zhvillimin e kulturës dhe të artit gjatë asaj periudhe.</p> <p>(2 orë)</p>	<p>-Dinë për kushtet dhe rrethanat në të cilat u shfaq iluminizmi.</p> <p>-Dinë për ndikimin e kësaj filozofie në rrjedhat shoqërore posaçërisht në ato kulturore.</p>	Letersinë, artin, edukatën qytetare etj.
	4. Perandoria Osmane dhe Ballkani	<p>Shqiptarët në shekujt XVI-XVIII Qëndresën e shqiptarëve gjatë shekujve XVI-XVII, artin dhe kulturën, përhapjen e islamizmit në trojet shqiptare, pashallëqet shqiptare, personalitetet e njohura shqiptare në historinë e Perandorisë Osmane dhe monumentet kulturo-historike të periudhës osmane në trojet shqiptare.</p> <p>(8 orë)</p>	<p>-Dinë për pozitën e shqiptarëve nën sundimin osman, kulturën, përhapjen e islamizmit dhe qëndresën e shqiptarëve.</p> <p>-Dinë për formimin, rolin e rëndësishëm e pashallëqeve shqiptare.</p> <p>-Dinë për marrëdhëniet e pashallëqeve shqiptare me popujt fqinjë dhe me shtetet e Evropës.</p> <p>- Dallojnë personalitetet kryesore shqiptare që lanë gjurmë në historinë e Perandorisë Osmane.</p> <p>- Njohin disa nga monumente kryesore kulturoro-historike të periudhës osmane në trojet shqiptare.</p>	Gjeografinë, artin, letërsinë etj.

IV. KOHA E RE	5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë kohës së re	Revolucioni në Amerikën Veriore Revolucioni amerikan – krijimi i SHBA-ve. (1 orë)	-Dinë kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të revolucionit në Amerikë - Kanë kuptuar raportet shoqërore që lindën pas përfundimit të revolucionit në Amerikë.	Gjeografinë, edukatën qytetare, etj
	3. Evropa gjatë kohës së re	Revolucioni në Francë. Revolucioni Borgjez Francez. Diktatura Jakobine. Perandoria e Napoleon Bonopartit. Luftërat e tij dhe rënia e Perandorisë. (4 orë)	-Dinë kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të revolucionit në Francë. - Kanë kuptuar raportet shoqërore që lindën pas përfundimit të revolucionit në Francë. -Dinë për Perandorinë e Napoleon Bonapartit, për fuqizimin dhe zgjerimin e shtetit të tij dhe për shkaqet e rënies së kësaj Perandorie, pasojat dhe anët pozitive të saj.	Gjeografinë, edukatën qytetare, etj

Vërejtje: 4 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve, të kenë mundësi të zgjedhin ndojnë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodologjia e mësimdhënies përcakton suksesin e realizimit të qëllimeve dhe të objektivave që mësimdhënësi ia paracakton vetes në bazë të përmbajtjeve programore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së vetë nxënësve. Prandaj, gjatë një ore mësimore, mësimdhënësi mund të përdorë disa forma, teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra – tjetrën, në mënyrë që të arrijë rezultate optimale gjatë procesit mësimor. Duke synuar përmbuhjen e kërkesave për nxënie cilësore, me nxënësin në qendër, sugjerohen metoda, forma dhe teknika të tilla si:

Format kryesore të organizimit të procesit mësimor janë:

Puna me tërë klasën,
Puna me grupe (të mëdha ose të vogla)
Puna me çifte
Puna individuale

Metodat:

E mësimdhënies - (kallëzimi, shpjegimi, ligjërata, biseda, demonstrimi etj.)
E të mësuarit - është metodë e punës së përbashkët e mësimdhënësit dhe e nxënësve dhe përdoret për arritjen e qëllimeve, synimeve, qëllimeve, objektivave etj.
E të nxënit - (vrojtimi i pavarur, ushtrimet, diskutimet, debatet, shfrytëzimi i literaturës, shkëmbimi i mendimeve etj.).
Kërkimore - është metodë që mundëson të bëhen kërkime historike nëpërmjet burimeve dhe analizave lidhur me saktësinë dhe interpretimin e fakteve të gjetura.

Teknikat:

Ekziston numër i madh teknikash të mësimdhënies dhe të nxënies. Këtu sugjerohen vetëm disa prej tyre.

- **Brainstormingu** (“stuhi, mendimesh“, **gjenerim idesh**)- është teknikë efektive, që më tepër përdoret në fillim të orës mësimore.

- **Klasteri (grumbulli apo pema e mendimeve)** - nxit nxënësit të mendojnë rreth një teme të caktuar. Zakonisht, shërben për të krijuar lidhje midis fakteve.
- **INSERT-i** - (është sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm). Kjo teknikë përdoret në pjesën kryesore dhe është efektive, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që e lexon.
- **Pesëvargëshi** – është teknikë e veçantë e cila ka pesë vargje dhe kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet të cilat përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës.
- **Xhigsou (ndërthurja)** – është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga të gjithë nxënësit, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Teknikat e tjera janë: **ditari dypjesësh, di, dua të dijë, mësova, ese 5 dhe 10, rrjeti i diskutit, diagrami i Venit shkrimi i lirë etj.**

Historia gojore është gjithashtu një nga mënyrat bashkëkohore të të mësuarit të lëndës së historisë.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate të dëshirueshme. Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses muzetë, galeritë, bibliotekat, arkivat, ekskursionet në vendet dhe monumentet kulturoro-historike etj.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, i analizës dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se në ç'shikallë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëheqëse.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe u shërben disa qëllimeve të ndryshme.

Ndër qëllimet kryesore të vlerësimit janë:

1. Të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve;
2. Të sigurojë nxënësve informacion mësimor;
3. Të motivojë nxënësi;
4. Të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuara;
5. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhshmen.

Tipat e vlerësimit

Ekzistojnë tipa të larmishëm të vlerësimit :

- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.
- **Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe te nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës), me qëllim t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.
- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotuar para parake dhe objektivat e para-shikuar.
- **Vetvlerësimi** është proces i mbledhjes, i analizës, i interpretimit të informatave dhe të veprimtarisë që nxënësi e bën vetë me anë të ndonjë mjeti vlerësues.
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies, p.sh. pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.
- **Vlerësimi në bazë të kritereve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara, p.sh. krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë në përmirësimin e tyre.

Vlerësimi **formues** dhe **diagnostikues** nuk vlerësohet me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikon punën e tij.

- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi në proces** bazohet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- **Kontrolli i zakonshëm i veprimtarive në klasë**
- **Detyrat e shtëpisë**
- **Testet**

- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.
- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojmë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherit mund të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

Format e testeve janë:

- Me gojë
- Me shkrim
- Përmes paraqitjes grafike etj.

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anët negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj. Gjatë zbatimit të testimit, sistemi i poentimit zgjidhet nga vetë mësimdhënësi.

Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari të tjera, p.sh.

- Vlerësimi i eseve
- Vlerësimi me dosje
- Vetëvlerësimi etj.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Prishtinë, 1997
2. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Tiranë, 1995

3. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Shtëpia botuese Pegi, Tiranë, 1999
4. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003
5. Grup autorësh, Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët për të ndër-tuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000, botues: EURO-CLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë, 2003
6. MASHT, Plani dhe programi mësimor 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003
7. Historia e Popullit Shqiptar I, Tiranë, 2001
8. Vilson Kuri, Hysen Latifi, Hysni Myzyri, Historia 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
9. Mikel Pjetrush, Atlas historik i botës, Shtëpia botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001

Burimet në internet

10. www.dadalos.org
11. www.historyplace.com
12. www.see-educoop.net
13. www.eurocliohistory.org
14. www.euroclio.net

HYRJE

Gjeografia e Evropës ka për objekt studimi hapësirën e Evropës në tërësi, regjionet e saj në veçanti dhe shtetet veç e veç, për të nxjerrë nga këto njohuri mësim për rolin e pozitës gjeografike të regjionit dhe të vendeve, funksionin e kushteve natyrore dhe të resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik dhe jetën e njerëzve, për t'i dalluar specifikat popullore, kulturore e politike në lidhje me karakteristikat gjeografike të hapësirës ku ata jetojnë dhe për t'i paraqitur rezultatet e punës së tyre në kushtet e ndryshme gjeografike. Gjeografia e Evropës ndihmon të kuptuarit e ndërlidhjeve në mes të shoqërisë e natyrës, si shfrytëzohet dhe si mbrohet ajo, si bashkëpunojnë komunitetet pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, politike, kulturore e gjinore. Në Evropë ka shumë shembuj pozitivë prej të cilëve mund të mësohet, ato eksperiencat si të zbatohen në vendin tonë.

QËLLIMET

1. Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të **njohur** pozitën gjeografike, veçoritë natyrore dhe humane të Evropës dhe ndikimin e kushteve natyrore e faktorëve shoqërorë në mjedisin e tyre.
2. Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të **kuptuar** pozitën gjeografike, veçoritë natyrore e humane, ndikimin e kushteve natyrore për aktivitetin njerëzor, sfidat dhe perspektivat e ndërvarësisë regjionale.
3. Zhvillimin e **shkathtësive** dhe të **shprehive** të nevojshme për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave të ndryshme në situata konkrete.

4. Zhvillimin e gatishmërisë për të **përdorur drejt** dhe me **përgjegjësi** njohuritë, shkathësitë dhe shprehitë e fituara nga mësimi i gjeografisë.
5. Zhvillimi i **qëndrimeve** dhe i **vlerave** për laramaninë e veçorive natyrore, kushteve të ndryshme të jetës dhe të veprimtarive njerëzore.
6. Zhvillimin e aftësive për **respektimin** e të drejtave njerëzore për të gjithë popujt që jetojnë në Evropë, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, fetare, gjuhësore dhe angazhimin për të kërkuar zgjidhje të problemeve lokale, rajonale, kombëtare etj.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Të njohë:**
 - Faktet dhe konceptet për veçoritë natyrore dhe humane të Evropës;
 - Karakteristikat themelore natyrore dhe humane të Evropës, regjioneve të saj dhe shteteve.
- **Të kuptojë:**
 - Specifikat gjeografike të Evropës: specifikat natyrore, sociale, ekonomike dhe politike;
 - Ngjashmëritë dhe dallimet e veçorive natyrore e humane mes regjioneve të Evropës.
- **Të zbatojë:**
 - Grafikone, diagrame, modele, harta etj. për elemente klimatike, hidrografike, shpërndarjen, numrin, shtimin natyror, strukturat e popullsisë dhe veprimtaritë ekonomike;
 - Të përdorë të dhënat verbale sasiore dhe simbolike të tekstit, fotografive, grafikëve, tabelave, diagrameve, hartave etj.
- **Të analizojë:**
 - Rëndësinë e veçorive natyrore dhe humane të Evropës në zhvillimin shoqëroro-ekonomik;
 - Ndikimin e kushteve natyrore dhe të faktorëve shoqërorë në zhvillimin ekonomik të Evropës, të regjioneve dhe të shteteve.
- **Të vlerësojë:**
 - Rolin e veçorive natyrore dhe humane të Evropës, të regjioneve dhe të shteteve;

- Shkaqet e vërteta të dukurive fizike dhe humane të Evropës së sotme si: ngrohja globale, problemi i ujit, i erozionit, i ndotjes, i rritjes së shpejtë e të ngadalshme të popullsisë, problemin e refugjatëve, zhvillimin e pabarabartë ekonomik etj.
- **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:**
 - Për laramaninë e veçorive natyrore, të kushteve të ndryshme të jetesës dhe të veprimtarive njerëzore;
 - Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj.).

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	TËRËSITË MËSIMORE	Nr. i orëve	%
REGJIONI	EVROPA	Nocioni i regjionit	1 + 0	1,3
		Vështrim i përgjithshëm për kontinentin e Evropës	6 + 2	10,8
		Evropa Jugore – Veçoritë natyrore, popullative dhe ekonomike. Shtetet e Evropës Jugore	2 + 1 11 + 4	24,3
		Evropa e Mesme - Tiparet natyrore, popullative dhe ekonomike Shtetet e Evropës së Mesme	2 + 1 8 + 2	17,6
		Evropa Perëndimore – Karakteristikat natyrore, popullative, ekonomike Shtetet e Evropës Perëndimore	2 + 1 5 + 3	14,9
		Evropa Veriore dhe Verilindore – Specifikat e natyrës, të popullsisë dhe të ekonomisë. Shtetet e Evropës Veriore dhe VL	2 + 1 2 + 1	8,1
		Evropa Lindore dhe BSHP Natyra, popullsia dhe ekonomia Shtetet e Evropës Lindore dhe BSHP-së	2 + 1 5 + 2	13,5
		Gjithsej = mësim + përsëritje + ushtrime	48 + 19	64,9+25,7
		Vlerësimi i njohurive	4	5,4
		Orët në dispozicion	3	4,0
	Gjithsej orë	74	100,0	

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtjet programore	Rezultatet e pritshme	Lidhjet ndërlëndore
Regjioni	Evropa	Kuptimi i regjionit	Nxënësi të jetë në situatë t'i njohë dhe t'i zbatojë kriteret për ndarjen e regjioneve gjeografike të Evropës	Ndërlidhja mes disiplinave gjeografike
		Evropa si tërësi regjionale - Pozita, madhësia, përkufizimi – Veçoritë relievore, klimatike, hidrografike dhe biogjeografike. – Karakteristikat demografike, kulturore, ekonomike dhe politike.	T'i përcaktojë kufijtë e Evropës dhe t'i tregojë përparësitë e pozitës së saj ndaj Azisë, Afrikës dhe kontinenteve të tjera. T'i identifikojë gadishujt dhe ishujt dhe t'i gjejë në hartë sistemet malore (vargmalet), malët e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura. T'i dallojë tipat e klimës përmes klimagrameve dhe t'i përshkruajë dallimet themelore. T'i gjejë në hartën gjeografike lumenjtë e njohur dhe liqenet. T'i dallojë nga fotografitë tipat vegjetativë të tajgës, stepës, makjeve. T'i dijë se cilat kafshë të egra jetojnë në cilat regjione të Evropës. Të komentojë grafikoniin e rritjes së popullsisë. T'i dallojë popujt dhe grupet më të mëdha të popujve në Evropë, në regjion dhe në shtete. T'i dallojë shtetet unitare, federale, republikane dhe mbretëritë.	T'i ndërlidhë njohuritë gjeografike dhe historike, gjeologjike, biogjeografike, demografike, ekonomike dhe politike.
		Evropa Jugore – –Pozita gjeografike mesdhe tare, shtrirja territoriale.	- Në hartë të tregohen gadishujt dhe shtetet që e përbëjnë Evropën Jugore. - Të përcaktohet ndikimi i Detit Mesdhe përmes rritjes së bimëve mesdhetare dhe jetës së njerëzve.	Për t'i shpjeguar specifikat e natyrës së vendeve mesdhetare, popullimin, kulturën dhe ekonominë e

		<p>– Veçoritë relievore, seizmike, klimatike, hidrografike dhe biogeografike.</p> <p>– Veçoritë popullore, kul- turore, ekonomike dhe politike</p> <p>–Shtetet e Evropës Jugore: Greqia, Maqedonia, Bullgaria, Serbia e Mali i Zi, Bosna e Hercegovina , Kroacia, Rumania, Italia , Malta, Qipra, Spanja e Portugalia.</p>	<p>- Të gjenden në hartë sistemet malore, fushat, rrafshlartat dhe luginat lumore më të njohura dhe të arsyetojë pse rreth Mesdheut ka termete dhe vullkane (Etna, Vezuvi, etj.).</p> <p>- Të analizojë dhe të komentojë klimagramet për vendet e Evropës Jugore dhe të arsyetohet rrjeti i varfër lumor, sasia e vogël e ujit gjatë verës dhe mungesa e liqeneve.</p> <p>- Të tregohen veçoritë e ujit të detit në Mesdhe dhe roli i tyre në ekonomi e në turizëm.</p> <p>- Në hartat e punës të shënohen popujt që jetojnë në vendet e Evropës Jugore, të analizohet harta e dendësisë së popullsisë dhe të shpjegohen dallimet në dendësi.</p> <p>- Të gjenden në hartë qytetet më të vjetra dhe më të njohura të Evropës Jugore, të identifikohen zonat turistike më të njohura në këtë regjion</p> <p>– Të përkufizohen dhe të dallohen specifikat natyrore, popullore, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Evropës Jugore.</p>	<p>këtij regjioni dhe të vendeve të Mesdheut, nevojitet ndërlidhje e njohurive gjeografike, historike, demografike, kulturore e politike.</p>
		<p>Evropa e Mesme –</p> <p>- Pozita gjeografike mes regjioneve tjera, shtrirja dhe objektet lidhëse (detrat dhe lumenjtë).</p> <p>- Tërësitë relievore, klima kalimtare, hidrografia e pasur, zonat biogeografike.</p>	<p>- Nxënësi duhet të tregojë se Evropa e Mesme është urëlidhëse në mes regjioneve të tjera të Evropës.</p> <p>- Të tregojë dhe të emertojë në hartë shtetet e Evropës së Mesme dhe fqinjët e tyre.</p> <p>- Ti gjejë në hartë vargmalet, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.</p> <p>- Të dallojë dhe të arsyetojë tipat e klimës mes pjesëve perëndimore dhe lindore, viseve të larta</p>	<p>Njohja e hapësirës së Evropës së Mesme me veçoritë karakteristike relievore, klimatike, hidrografike, biogeografike, popullore, ekonomike e politike kërkon gërshëtimin e njohurive fiziko dhe humano gjeografike,</p>

		<ul style="list-style-type: none"> - Pasuritë natyrore dhe lidhjet e mira kushtet e zhvillimit ekonomik. - Evropa e Mesme zonë e kontaktit mes popujve dhe kulturave. - Ekonomia e zhvilluar dhe e llojllojshme. <p>Shtetet e Evropës së Mesme: Gjermania, Austria, Zvicra, Sllovenia, Hungaria, Çekia, Sllovakia, Polonia.</p>	<p>dhe të ulta të Evropës së Mesme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ti gjejë në hartë lumenjtë më të rëndësishëm dhe t'i përshkruajë veçoritë specifike të tyre. - Të shënojë në hartën e punës liqenet më të njohura në Evropën e Mesme. - Të tregojë me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të qymyrit dhe të hekurit në këtë regjion. - Të radhitë popujt e Evropës së Mesme sipas numrit të popullsisë. - Të shënojë në hartën e punës qytetet më të mëdha të Evropës së Mesme. - Të radhitë shtetet e Evropës së Mesme sipas lartësisë së të ardhurave për kokë banori. <p>Të tregojë specifikat natyrore, popullore, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmeritë dhe dallimet mes tyre.</p>	<p>historike, kulturore dhe politike.</p>
		<p>Evropa Perëndimore</p> <p>Pozita e rëndësishme gjeografike.</p> <p>–Veçoritë specifike natyrore të regjionit: relievi kryesisht i ulët, klima e lagët dhe e butë, lumenjtë me mjaft ujë, të lundrueshëm, vegjetacioni i gjallë, pasuri në qymyr, naftë e gaz natyror.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të dijë pse Evropa Perëndimore është “dritarja e Evropës në botë”. - Të vlerësojë se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore. - Të shprehë rëndësinë e detit në jetën dhe në luftën e njerëzve me të. - Të shprehë rolin e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njerëzve. - Të shënojë në hartën e punës malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderet dhe luginat lumore. 	<p>Shpjegimi i veçorive tipike të këtij regjioni si për nga natyra, njashtu edhe nga zhvillimi historik, kërkon njohje solide gjeografike, historike, kulturore e politike.</p>

		<p>- Regjion i banuar dendur, shtimi i ulët natyror i popullsisë, niveli i lartë kulturor, zhvillimi i lartë ekonomik, shumica e shteteve mbretëri.</p> <p>Shtetet e Evropës Perëndimore: Britania e Madhe, Irlanda, Franca, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu.</p>	<p>- Të arsyetojë rolin e grykave të lumejve në formë të hinkës (estuareve) për lundrim.</p> <p>- Të arsyetojë praninë e shumë kanaleve që lidhin lumejtë mes veti.</p> <p>-- Të paraqesë me shenja në hartën e punës vendburimet e qymyrit, naftës, gazit, hekurit dhe metaleve të tjera.</p> <p>- Të radhisë shtetet e Evropës Perëndimore sipas numrit të banorëve.</p> <p>- Të shënojë në hartën e punës 10 qytetet më të njohura të Evropës Perëndimore dhe t'i numërojë 5 limanet më të mëdha.</p> <p>- Të radhisë shtetet e Evropës Perëndimore sipas lartësisë së të ardhurave për kokë banori.</p>	
		<p>Evropa Veriore dhe Verilindore.</p> <p>- Pozita skajore gjeografike me lidhje të mira.</p> <p>- Veçoritë karakteristike të relievit, klimës, hidrografisë, vegjetacionit dhe botës shtazore.</p> <p>- Tiparet etnike, kulturore e demografike të popujve në veriun e Evropës.</p> <p>- Niveli i zhvillimit ekonomik dhe struktura e</p>	<p>- Nxënësi duhet të përkufizojë regjionin dhe t'i identifikojë shtetet që e përbëjnë këtë regjion.</p> <p>- Të dijë se ky regjion është i përcaktuar nga ndikimi i klimës dhe i detit.</p> <p>- Të tregojë se relievi i vjetër ka pësuar ndryshime të mëdha me veprimin e akullnajave.</p> <p>- Të përshkruajë relievin malor, rrafshlartat malore, fjordet, fushat dhe pyjet.</p> <p>- Të dallojë tiparet e klimës dhe dallimet e saja nga Atlantiku e deri te tajgat ruse.</p> <p>- Të tregojë shkaqet e lumenjve të shkurtër, me shumë ujë dhe me fuqi të madhe energjetike.</p> <p>- Të arsyetojë praninë e numrit të madh të liqeneve.</p> <p>- Të dallojë ndërrimin e bimësisë dhe të kafshëve nga veriu e deri në jug dhe nga perëndimi në</p>	<p>Njohja dhe sqarimi i dukurive të veçanta natyrore, jeta dhe kultura specifike e popujve në këtë regjion, kërkon gërrshëtimin e njohurive solide gjeografike, historike, kulturore dhe politike.</p>

		<p>ekonomisë në përputhje me kushtet natyrore.</p> <p>Shtetet e Evropës Veriore dhe Verilindore: Danimarka, Islanda, Norvegjia, Suedia, Finlanda, Estonia, Letonia dhe Lituania.</p>	<p>drejtim të lindjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike. - Të gjejë lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve. - Të nxjerrin përfundime pozitive si kanë arritur njerëzit nivelin e lartë të zhvillimit kulturor e ekonomik në kushte të vështira natyrore. 	
		<p>Evropa Lindore dhe BSHP Evropa Lindore me BSHP</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike, madhësia e territorit dhe lidhjet e dobëta me botën. - Llojllojshmëria e relievit dhe shtrirja në sipërfaqe të madhe. - Klima në varësi prej viseve polare, deteve të ftohta dhe sipërfaqes së madhe. - Hidrografia me shumë dete, liqene, lumenj të gjatë, me shumë ujë. - Tokat në formë zonale në përputhje me klimën 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi të jetë në gjendje t'i tregojë dhe t'i përkufizojë në hartë shtetet e Evropës Lindore dhe BSHP-së. - Të tregojë se deri ku shtrihet Evropa Lindore dhe deri ku BSHP-ja. - Të dallojë tërësitë e mëdha relievore: Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpateve, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka. - Të dallojë tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrirë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug. - Të ndërlidh klimën me tipat e vegjetacionit sipas zonave. - Të tregojë në hartë emrat, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve. - Të identifikojë, emertojë dhe të krahasojë liqenet më të njohura të Evropës Lindore dhe BSHP-së sipas veçorive të tyre. 	<p>Shpjegimi i fenomeneve natyrore, humane, ekonomike e politike tipike për Evropën Lindore dhe hapësirën e BSHP-së në dimensione të mëdha, kërkon njohje të sigurt gjeografike, gjeofizike, historike dhe politike.</p>

	<p>dhe relievin.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zonat vegetative dhe zoogeografike. - Territor i madh dhe i pasur me minerale. - Dikur shtet federal i centralizuar, tani lidhje e lirë në mes shtetesh. - Dendësia e popullsisë e ndryshme dhe numri i madh i popujve me dallime etnike, fetare e kulturore. - Ekonomia në transformim dhe me shumë probleme. <p>Shtetet e Evropës Lindore dhe BSHP-së me grup shtete: Rusia, Ukraina, Bellorusia, Moldavia, Armenia, Gruzia, Azerbejxhani, Turkmenistani, Uzbekistani, Taxhikistani, Kirgistani dhe Kazakistani</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të tregojë në hartë shtrirjen e shkretëtirave, emrat e tyre dhe të arsyeve praninë e tyre. - Të dallojë viset e tundrave, tajgeve, stepeve, shtrirjen gjeografike dhe rolin e tyre në ekonomi. - Të arsyetojë hapjen e kanaleve dhe rëndësinë e tyre ekonomike në pjesën evropiane. - Të tregojë në hartë vendburimet e mineraleve më të njohura në hapësirën e BSHP-së dhe rëndësinë e tyre ekonomike. - Të dallojë popujt më të njohur në Evropën Lindore dhe BSHP sipas përkatësisë etnike e fetare. - Të shënojë në hartat e punës qytetet më të njohura dhe më të mëdha të Evropës Lindore dhe BSHP-së. - Të nxjerrë konkludime të thjeshta, duke krahasuar shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, populative, nivelit të arsimit, urbanizimit dhe strukturës ekonomike të tyre. 	
--	---	---	--

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Lënda e gjeografisë mund të mësohet dhe të interpretohet përmes metodave dhe teknikave të ndryshme. Metodologjia e mësimdhënies dhe e nxënies ka rëndësi, të madhe, meqë e bën nxënësin më të aftë të vështrorë dhe të gjykojë drejt objektet dhe dukuritë gjeografike, pavarësisht nga forma e paraqitjes së tyre. Mësimdhënësi bën zgjedhjen e metodave dhe teknikave të mësimi, varësisht nga aftësitë psiko-motorike të nxënësve. Zgjedhja e metodave dhe teknikave duhet të jetë në përputhje me shkallën e arritshmërisë së objektivave në procesin mësimor.

Zbatimi i metodave dhe i teknikave, i strategjive dhe i formave të ndryshme të organizimit të procesit mësimor është e drejtë dhe obligim profesional i arsimtarëve. Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, si në aspektin teorik, ashtu edhe aplikativ, të tregohet kujdes i veçantë. Metodologjia duhet të zgjedhet paraprakisht në përputhje me përmbajtjen e temës, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia duhet të jetë në shërbim të përvetësimit dhe të përdorimit të shpejtë e të saktë të njohurive, të shprehive dhe të vlerave, në radhë të parë të atyre që ndihmojnë në zgjedhjen e problemeve jetësore të përditshme. Në grupin e metodave verbale rekomandohet të përdoren metodat e shpjegimit, bashkëbisedimit, demonstrimit, diskutimit të lirë etj. Këtu bëjnë pjesë edhe diskutimet me nxënësit, në dyshe, në grupe, ndërsa nxënia në bashkëpunim mund të bëhet përmes teknikave të ndryshme.

Baza materiale e mësimi të gjeografisë

Mësimi bashkëkohor i gjeografisë mund të realizohet në tërësi duke përdorur:

- **objektet mësimore** (klasën, kabinetin dhe natyrën);
- **mjetet mësimore** (vizuele dhe audiovizuele);
- **mjetet teknike ndihmëse** (dërrasa e zezë, aparatet projektuese, TV, radio, arka e rërës, modelet, CD-të) etj;
- **bibliotekën e shkollës;**
- **mjetet e punës së nxënësve** (librin mësimor, libër leximin e gjeografisë, fletoren e punës, materialet ilustrative, treguesit hartografikë, fotografitë, diagramet, grafikonet, tabelat, fjalorin gjeografik, atlasin gjeografik, hartat konture dhe memece, prerjet, bllok-diagramet, skemat, instrumentet matëse etj.).

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë kanë rëndësi të madhe, ngase lënda e gjeografisë ka karakter vizuel. Paraqitja indikrekte e të vërtetës gjeografike, si qasje didaktike, më së shpeshti përcillet me **fjalën e gjallë**, ndërsa rol të rëndësishëm në procesin e nxënies të diturive të reja kanë **mjetet mësimore**. Kjo do të thotë se **demostrimi** është detyrë e arsimtarit, kurse **vëzhgimi** është obligim i nxënësit.

Aty ku nuk është i mundshëm vëzhgimi i drejtpërdrejtë, nxënësit duhet t'i mundësohet **vëzhgimi indirekt** me përdorimin e:

- ❖ **fotografive, filmit, emisioneve televizive**, kompjuterit, modeleve, maketave, globit, hartave me shkallë të madhe (plane), të mesme, të vogël, gjeografike, fizike, shoqërore, ekonomike, memece, imazheve satelitore etj.;
- ❖ **vizatimeve gjeografike** (vizatime lëndore, diagrame, grafikone, hartograme);
- ❖ **vlerave numerike** (përmes tabelave etj.);
- ❖ **librave mësimorë, librave të leximit, revistave gjeografike** etj.

Format e punës në mësimin e gjeografisë

Në procesin mësimor përdoren disa forma të punës, të cilat kanë për qëllim t'i aktivizojnë subjektet e procesit mësimor dhe ta bëjnë mësimin sa më të efektshëm, e këto janë:

- forma **individuale** e punës;
- forma e punës në **çifte**;
- forma e punës në **grupe**;
- forma me tërë **klasën**;
- **format e veçanta** të mësimin të gjeografisë: mësimi i programuar, mësimi i shtuar apo suplementar, mësimi plotësues, mësimi vazhdues, aktivitetet e lira, mësimi ekipor etj.;
- **vështrimet në rrethinë, ekskursionet** mësimore gjeografike.

Metodat dhe teknikat e punës në mësimin e gjeografisë

Metodat dhe teknikat e punës mësimore janë mënyra dhe qasje me ndihmën e të cilave realizohen disa detyra në procesin mësimor, ndërsa cilësia e mësimin varet nga ato dhe nga zgjedhja e drejtë e tyre me rastin e organizimit të procesit mësimor.

Varësisht nga natyra e lëndës së gjeografisë, metodat mësimore ndahen:

- **metodat verbale** - metoda parafolëse (frontale), bashkëbiseduese, dialogu dhe diskutimi;
- **metoda tekstuale**;
- **metoda demonstrative ilustrative** (demonstrimi i ilustrimeve, modeleve, simulimeve, lëndëve, objekteve);
 - a) demonstrimi në mjedisin jetësor;
 - b) demonstrimi në klasë apo në kabinetin gjeografik;
 - c) vëzhgimi i drejtpërdrejtë gjeografik;
 - d) vështrimi i objekteve, dukurive e proceseve gjeografike në hapësirë;
- **metoda laboratorike-eksperimentale** (eksperimentet gjeografike, demonstrimi i eksperimenteve, për ato raste që ka mundësi).

Përveç metodave mësimore të lartpërmendura, gjatë procesit mësimor duhet të përdoren edhe **teknika të ndryshme të mësimdhënies, si:**

- ❖ **brainstorming (stuhi mendimesh);**
- ❖ **diskutimi që zgjedh problemin;**
- ❖ **mësimi zbulues;**
- ❖ **teknika e hartimit dhe e drejtimit të pyetjeve;**
- ❖ **pema e mendjes (harta e mendimit, teknika klaster);**
- ❖ **gjuha grafike e komunikimit;**
- ❖ **inserti;**
- ❖ **tabela e insertit;**
- ❖ **tabela (harta) e koncepteve;**
- ❖ **grupet e ekspertëve (xhikso me ndërthurje);**
- ❖ **rrjeti i diskutimit;**
- ❖ **di-dua të dij – mësoj;**
- ❖ **ditari dypjesësh;**
- ❖ **termat paraprakë;**
- ❖ **eseu (studimi i vogël);**
- ❖ **diagrami i Venit;**
- ❖ **programi televiziv;**
- ❖ **kubimi;**
- ❖ **DRTA;**
- ❖ **turi i galerisë;**
- ❖ **pesëvargëshi;**
- ❖ **fjalën e fundit ruaje për mua etj.**

Verifikimi i diturive të nxënësve

Verifikimi dhe vlerësimi i **shkallës së përvetësimit** të dijes gjeografike nga nxënësit është proces tepër i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të këtij programi. Për këtë arsye rekomandohet që vlerësimet të përqendrohen më tepër në **aspektin sasior e cilësor** të nivelit të arritjes nga nxënësit të objektivave të përgjithshëm dhe specifikë. Më të frytshëm konsiderohen verifikimi, notimi dhe vlerësimet sistematike, mundësisht për të gjithë nxënësit. Duhet të verifikohen dhe të vlerësohen **sasia dhe cilësia e diturive** të nxënësve si **faktet dhe objektet gjeografike**, konceptet dhe shkathtësitë.

Funksionet e verifikimit dhe të vlerësimit janë:

Verifikimi (konfirmimi) është zbulimi i zbrazësive në dijen e nxënësve dhe informata kthyesë për arsimtarin. Dituritë e nxënësve **duhet verifikuar në mënyrë sistematike**. Në fazën e verifikimit **kontrollimi** mund të bëhet **frontalisht**, duke nxitur nxënësit më pyetje të shkurta, të shpejta, që kërkojnë dije faktike, gjeturi topografike, njohje të disa shënimeve.

Format e verifikimit

Gjatë vitit shkollor duhet zbatuar disa forma të kontrollit:

- **verifikimi me gojë** mund të jetë **individual dhe grupor** në çdo orë mësimore;
- **verifikimi me shkrim**, po ashtu mund të jetë **frontal dhe individual**. Kjo formë e verifikimit disa nxënësve u përgjigjet më shumë. Detyrën, problemin e dhënë nxënësit duhet ta zgjidhin brenda kohës së caktuar;
- **verifikimi përmes detyrave tekstuale-grafike**. Në praktikën mësimore detyrat e këtilla paraqiten në listat kontrolluese dhe në testet e diturive;
- **verifikimi përmes zgjedhjes së punëve praktike** arrihet përmes verifikimit të diturive, fakteve, mënyrën e të menduarit gjeografik, shkallën e përvetësimit të shkathtësive e shprehive;
- **verifikimi i detyrave shtëpiake**. Për notim veçanërisht janë të përshtatshme punimet e pavarura, referatet, zgjidhja e ndonjë problemi praktik në mënyrë të pavarur.

VLERËSIMI DHE NOTIMI

Vlerësimi i rregullt dhe notimi i drejtë është ndër mjetet më të rëndësishme në duart e arsimtarit për kualifikimin dhe orientimin e punës së nxënësve, prandaj *çdo shprehje e nxënësit me gojë, me shkrim apo praktik*, e që ka të bëjë me mësimin e gjeografisë, do të duhej vlerësuar. *Vlerësimi përfshin notimin për punën dhe dijen e shfaqur*. Pas vlerësimit pason notimi.

Vlerësimi kërkon: Objektiva të qartë mësimorë, motivim të nxënësve, njohjen e përvojës dhe të aftësive të nxënësve, kërkesa të qarta të nxënësve dhe metoda e teknika mësimore efikase.

Vlerësimi bazohet: Ç’thon nxënësit, ç’shkruajnë nxënësit, ç’bëjnë nxënësit.

Etapat e vlerësimit: kontrolli, p.sh. ç’dinë (ç’u arrit) dhe ç’nuk dinë nxënësit (çka nuk u arrit), **matja dhe vlerësimi** (i cili nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi sasior ose cilësor i bazuar në matje).

Notimi duhet të jetë **publik dhe me nota të plota**. Puna mësimore duhet të vlerësohet në mënyrë sistematike. Thelbi i vlerësimit është zbatim i efikas i evidencës, i verifikimit dhe i notimit. Në mësimin bashkohor sistemi i vlerësimit ka pasur ndryshime të rëndësishme, ku, krahas metodave subjektive zbatohen, edhe ato objektive.

Tipat e vlerësimit

- **Vlerësimi formues** ka për qëllim të kontrollojë përparimin e nxënësve gjatë procesit mësimor, pra kontrollon shkallën e zotërimit të objektivave;
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim notimin dhe çertifikimin e nxënësve, zbulimin e shkallës së arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies p.sh., pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti etj.;
- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotëruara paraprake dhe në raport me objektivat e parashikuara;
- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta;
- **Vlerësimi i brendshëm** formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi;

- **Vlerësimi i jashtëm** hartohet jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë në Ministri, zyrtarët rajonalë dhe komunalë);
- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në bazë të kontrollit të punës së nxënësve në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues;
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të lëndës së gjeografisë;
- **Vlerësimi si proces** bazohet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune apo detyre në zhvillim.
- **Vlerësimi orientues** është i nevojshëm për orientim në profesion dhe në zhvillimin vetjak;
- **Vlerësimi** është proces gjatë të cilit mësuesi, shkolla, nxënësi mbledhin informata për veten dhe bëjnë gjykimin e vlerave të tyre.

Instrumentet e vlerësimit janë:

Mësimdhënësi i lëndës duhet të zgjedhë dhe të zbatojë një numër instrumentesh për matjen dhe vlerësimin, siç janë:

- **vrojtimi,**
- **pyetësi (vetëvlerësimi),**
- **raporti me shkrim i një pune praktike apo hulumtimi,**
- **të shprehurit me gojë,**
- **të shprehurit me shkrim,**
- **fleta kontrolluese** (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit),
- **dosja ose portofoli (vetëvlerësimi),**
- **testi.**

Testi duhet të jetë i bazuar në kritere dhe në objektiva.

Testi i arritshmërisë duhet të ndërtohet nga kërkesat ose pyetjet:

- me përgjigje alternative të shumta,
- me përgjigje të hapura të shkurta,
- me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.
- dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Teksti shkollor dhe fletorja e punës për klasën përkatëse.
2. Atlasi gjeografik shkollor.
3. Metodologjia e mësimdhënies.
4. Hartat e ndryshme të Evropës.
5. Globi, instrumente meteorologjike, hidrometrike etj.
6. Revista profesionale dhe shkollore.
7. Fotografi, postere, gazeta.
8. Programe kompjuterike, internet, CD, fotoslajde, filma, videokasete etj.

HYRJE

Programi i edukatës qytetare për klasën VII është hartuar duke pasur parasysh moshën e nxënësve, njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga mësimi i kësaj lënde në klasat e mëparshme, por edhe në lëndet e tjera me të cilat edukata qytetare është në korelacion.

Përvojat nga temat e klasës VI rreth zhvillimit të identitetit personal dhe identitetit grupor, pastaj nga shëndeti dhe mbrojtja shëndetsore, ligji dhe të drejtat e njeriut, kultura dhe mbrojtja e ambientit mund të lidhen në mënyrë praktike me temat e planit dhe programit të klasës VII. Kjo është moshë kur nxënësit ndjehen të pjekur dhe kureshtarë për të formuar klube ose shoqata të ndryshme dhe brenda këtyre klubeve ata e zhvillojnë identitetin e vet personal dhe atë grupor. Klubet e kësaj moshe rëndom janë klube muzikore, recitatuese, klube aktrimi, klube kuizi, sportive etj., ose edhe shoqata ekologjike, vullnetare etj.. Në kuadër të kësaj lënde nxënësit do të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë për aktivitete në këto forma të organizimeve shoqërore.

Përveç kësaj, në kuadër të Edukatës qytetare të klasës VII nxënësit do të mësojnë për qeverisjen, pushtetin dhe autoritetin. Nxënësit do të informohen për format e ndryshme të qeverisjes, të pjesëmarrjes dhe ndikimit në qeverisje. Organizimi i klubeve, i shoqatave ose i organizatave joqeveritare, jo vetëm që u ndihmon nxënësve në ngritjen e tyre në pikëpamje edukative dhe kulturore, por kjo u mundëson atyre të përgatiten më mirë edhe për rolet e ardhshme që do t'i marrin në shoqëri.

QËLLIMET

Të ndihmohet nxënësi të bëhet aktiv dhe kureshtar për themelimin, funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të klubeve dhe shoqatave në shkollë dhe në komunitet.

Të vetëdijësohet nxënësi për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në krijimin e organeve drejtuese të institucioneve shoqërore.

Të vetëdijësohet nxënësi për rëndësinë e respektimit të të drejtave dhe përgjegjësisë të anëtarëve të grupit dhe në pengimin e çdo lloj diskriminimi (etnik, fetar, racor, gjinor etj.).

Të ndihmohet nxënësi të njohë llojet e ndryshme të institucioneve shoqërore, mënyrën e formimit dhe funksionimit të tyre.

Të aftësohet nxënësi të reagojë ndaj shkeljeve eventuale të rregullave dhe procedurave të punës së grupeve dhe të institucioneve.

Të aftësohen të kuptojnë format e ndryshme të pjesëmarrjes, por edhe të ushtrimit të ndikimit të qytetarëve dhe shoqërisë civile tek autoritetet e pushtetit.

OBJEKTIVAT

Në bazë të qëllimeve të programit mësimor të klasës së shtatë nxënësi duhet të arrijë këto objektiva:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:

- të shfaqë qëndrim kritik lidhur me punën e klubeve, shoqatave dhe institucioneve,
- të jetë i hapur e tolerant dhe të kundërshtojë çdo formë diskriminimi gjinor, etnik, fetar, racor,
- të jetë kureshtar dhe i vullnetshëm për aktivitetet e klubeve, shoqatave, OJQ-ve.

Të njohë:

- konceptet si: klub, shoqatë, institucion, OJQ, shoqëri civile, qeverisje qendrore, qeverisje lokale,
- format e ndryshme të qeverisjes (qeverisja demokratike, autoritare);
- llojet e aktivitetit të shoqërisë civile në Kosovë;
- mënyrat e ndikimit të qytetarëve tek autoritetet dhe anasjelltas.

Të kuptojë:

- rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në punën e klubeve, shoqatave dhe institucioneve;
- përgjegjësitë dhe kompetencat që dalin nga puna në klub, në shoqatë dhe në institucione;

- rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në qeverisje dhe mënyrat e ndikimit në qeverisje.

Të vlerësojë:

- rëndësinë e qeverisjes demokratike për zhvillimin e klubit, shoqatës, institucionit, por edhe të shoqërisë në përgjithësi;
- nevojat dhe mundësitë për themelimin e klubeve dhe shoqatave në shkollë dhe komunitet;
- nevojat e bashkëpunimit me klube, shoqata dhe institucione të tjera në shkollë dhe komunitet;
- rolin e autoriteteve në ushtrimin e përgjegjësive në qeverisje.

Të zbatojë:

- rregullat dhe procedurat e klubeve, shoqatave dhe institucioneve.

Të analizojë:

- rolin e pushtetit dhe autoriteteve dhe rëndësinë e funksionimit të tyre sipas ligjeve demokratike,
- efektet dhe rezultatet e aktiviteteve të klubeve dhe shoqatave në shkollë dhe komunitet.

Të sintetizojë:

- të arriturat e shoqërisë civile në zhvillimin dhe në afirmimin e vlerave demokratike në shoqërinë kosovare.

STRUKTURA E LËNDËS

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	NUMRI I ORËVE
Grupet dhe institucionet	Klubet, shoqatat dhe institucionet	20 orë
Qeverisja dhe qytetaria	Qeverisja, pushteti dhe autoriteti	17 orë

KLUBET, SHOQATAT DHE INSTITUCIONET

Përmbajtja programore

Nxënësit të mësojnë për:

Klubet dhe llojet e tyre. Formimi dhe procedurat për themelimin e klubeve.

Parimet e udhëheqjes dhe funksionimit të klubeve, për punën në grup dhe rëndësinë e përmbushjes së obligimeve të marra në grup.

Krijimin e identitetit të klubit dhe mënyrat e shprehjes së identitetit (logot, simbolet, emblemat ...).

Shoqatat dhe llojet e tyre (kulturore, artistike, ekologjike, humanitare, profesionale).

Ndikimin e aktiviteteve të shoqatave në komunitet dhe shoqëri (bashkëpunimi ndërmjet shoqatave dhe zgjerimi i aktiviteteve).

Organizatat Jo-qeveritare (OJQ-të) dhe koncepti i shoqërisë civile. Pjesëmarrja në shoqërinë civile. Rrjetat e OJQ-ve dhe ndikimi i tyre në qeverisjen lokale/ qendrore.

Institucionin e familjes. Ndryshimet në familje. Roli dhe struktura e familjes dhe e farefisnisë.

Llojet e tjera të institucioneve shoqërore si: institucionet arsimore (Shkolla dhe nivelet e shkollimit, shkollimi tërëjetësor etj); pastaj, institucionet kulturore (mediat, teatri, kinemaja, galeritë artistike). Ndryshimet kulturore në Kosovë dhe në botë dhe trendet e këtyre ndryshimeve.

Institucionet fetare. Llojet e besimeve dhe e drejta për ushtrimin e lirë të fesë.

Institucionet shëndetësore (spitali, ambulancat, shëndeti publik dhe faktorët që rrezikojnë shëndetin); institucionet e shërbimeve publike (posta, telekomunikacioni) dhe për institucionet e pushtetit (gjykata, policia, prokuroria, mbrojtja civile, mbrojtja sociale).

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- identifikon llojet e ndryshme të klubeve, shoqatave dhe institucioneve që veprojnë në komunitetin ku jeton dhe në Kosovë në përgjithësi,
- përshkruan punën në grup dhe përgjegjësitë që dalin nga puna në grup,

- identifikon nevojat për aktivitete të reja në mënyrë që klubi, shoqata ose institucioni të jenë vazhdimisht në rrjedhë të kohës,
- analizon rëndësinë e bashkëpunimit me klubet dhe shoqatat e tjera,
- vlerëson rëndësinë e klubeve, shoqatave dhe institucioneve për zhvillimin e komunitetit dhe të shoqërisë.

QEVERISJA, PUSHTETI DHE AUTORITETI

Përmbajtjet programore

Nxënësit mësojnë:

Format e qeverisjes dhe roli i qeverisjes demokratike.

Format e pjesëmarrjes në qeverisje. Sistemet zgjedhore dhe rëndësia e votës së lirë.

Format e ndikimit të qytetarëve në institucionet vendimmarrëse (ankesat, peticionet, fushatat, protestat ...).

Pushteti lokal dhe pushteti qendror. Funkcionet e qeverisjes lokale dhe format e pjesëmarrjes dhe të ndikimit në të.

Funksionet e qeverisjes qendrore dhe format e pjesëmarrjes dhe të ndikimit në të.

Format e pushtetit dhe organet e tij (pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor).

Pushteti dhe autoriteti. Respektimi, kundërshtimi dhe keqpërdorimi i autoritetit.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi:

- përshkruan format e qeverisjes,
- shpjegon rëndësinë e pjesëmarrjes në qeverisje,
- shpjegon llojet e pushtetit dhe mënyrat e funksionimit të organeve të pushtetit,
- dallon kompetencat e pushtetit lokal prej atij qendror,
- shpjegon rolin e pushtetit në përmbushjen e interesave të ndryshme të qytetarëve.
- kupton format e mundshme të diskriminimit, kundërshton dhe shpreh mendimin kritik ndaj ligjeve diskriminuese,

- identifikon interesat kundërshtuese dhe rrugët e ndryshme për harmonizimin e atyre interesave.

QASJA NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Edukata qytetare është lëndë shumëdisiplinare. Ajo ka lidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera, si: histori, gjeografi, gjuhë shqipe, muzikë, art figurativ, arsim teknik, edukatë fizike e lëndë të tjera.

Me **historinë**, edukata qytetare krijon lidhje me temat, format e ndryshme të qeverisjes dhe rregullimeve shtetërore. Ajo ka lidhshmëri edhe me përmbajtjet e krijimit të institucioneve të ndryshme, të ngjarjeve dhe të proceseve që kanë ndikuar në ndryshimin e institucioneve, ligjeve dhe qeverive ose edhe formave të qeverisjes.

Me **gjeografinë**, edukatën qytetare e lidhin përmbajtjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e territoreve, planifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të klubeve, shoqatave dhe institucioneve nëpër rajone të caktuara. Po ashtu, ndihmojnë edhe përmbajtjet për ndarjen territoriale të komunave dhe të funksionimit të pushtetit lokal brenda territoreve të caktuara.

Me **gjuhën shqipe**, nxënësit në klasën e shtatë janë në gjendje të krijojnë klube të ndryshme letrare, dramatike. Këto aktivitete i ndihmojnë njohuritë e fituara nga gjuha dhe letërsia, por edhe nga edukata qytetare.

Me **artin figurativ, muzikën dhe me edukatën fizike**, në shkollë dhe në komunitet, përveç klubeve letrare mund të funksionojnë edhe klube të tjera si klubet muzikore, klubet e artistëve figurativë, klubet sportive e lloje të tjera të klubeve dhe me aktivitetet e tyre e begatojnë jetën kulturore dhe artistike në shkollë dhe në komunitet. Pjesa e projekteve të parapara në edukatë qytetare mund të realizohet pikërisht përmes këtyre aktiviteteve. P.sh. përgatitja e një posteri për një fushatë për mbrojtjen e mjedisit mund t'i lidhë së bashku edhe lëndën e edukatës qytetare e edhe atë të artit figurativ.

Me **arsimin teknik**, shfrytëzimi ose përdorimit i mjeteve ose pajisjeve teknologjike si kasetofon, diktafon, kamerë, aparat fotografik, dhe mjetet e tjera audio-vizuele.

METODOLOGJIA

Për t'u realizuar plani dhe programi i edukatës qytetare për klasën VII do të duhej që arsimtari t'i përdorë një sërë formash, metodash dhe teknikash të mësimdhënies - vartësisht nga përmbajtjet, por edhe nga

detyrat që duhet t'i realizojnë nxënësit në kuadër të kësaj lënde. Shpjegimi në klasë, leximi i literaturës, diskutimet, puna në grupe, puna individuale, projektet dhe aktivitetet praktike, shfrytëzimi i internetit, i aktiviteteve skenike, shfrytëzimi i multimedive, vëzhgimet në komunitet, vizita klubeve, shoqatave dhe institucioneve, mbledhja, përpunimi dhe paraqitja e të dhënave bëjnë të mundshme mësimdhënie dhe të nxënë të suksesshëm.

Në temat që kanë të bëjnë me **klubet, shoqatat dhe institucionet**, përveç shpjegimeve për procedurat e formimit, mënyrat e funksionimit dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e aktiviteteve, arsimtari të aktivizojë nxënësit në pjesëmarrje në aktivitetet e klubeve, shoqatave të shkollës ose komunitetit. Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme i mundësojnë nxënësit të njihet me punën dhe me funksionimin e klubeve, të shoqatave por edhe i kontribuojnë zhvillimit të jetës kulturore dhe artistike shkollës dhe komunitetit.

Në temat që kanë të bëjnë me **qeverisjen, pushtetin dhe autoritetin**, arsimtari shpjegon kuptimin dhe rëndësinë e qeverisjes, pushtetit dhe autoritetit për shoqërinë. Pastaj duhet të zhvillohen diskutime, bashkëbisedime dhe punë në grupe lidhur me format e qeverisjes, rëndësinë e qeverisjes demokratike, nivelet e qeverisjes, funksionin e pushtetit, mënyrat e ardhjes në pushtet dhe bazat e krijimit dhe të funksionimit të autoritetit.

Në realizimin e temave të kësaj kategorie nxënësit duhet të punojnë në projekte **individuale dhe grupore**.

Në projekte individuale, nxënësi do të përshkruaj një varg ndryshimesh që janë bërë në komunitetin e vet si rezultat i qeverisjes qendrore dhe asaj lokale.

Ndërkaq, në projektet grupore nxënësit do të mbledhin fakte nga mediat dhe jeta e përditshme për pjesëmarrjen, format e pjesëmarrjes dhe ndikimit të qytetarëve në qeverisje. Këto projekte do të paraqiten në klasë dhe pastaj do të zhvillohet diskutim lidhur me to.

VLERËSIMI

Përmes vlerësimit konfirmohet shkalla e arritjes së kërkesave të rezultateve të pritshme të parapara në planin dhe programin e klasës VII, duke filluar nga shkalla më e ulët e kërkesave si identifikimi, përshkrimi e deri te shkalla më e lartë si analiza, sinteza, konstruktmi, vlerësim i dukurive.

Ai sjell informata për përparim apo për vështirësitë në përparim të nxënësit si rezultat i përshtatshmërisë së planeve dhe programeve dhe metodologjisë efektive apo jo efektive të mësimdhënies.

Vlerësimi duhet të jetë i shumanshëm dhe i vazhdueshëm. Kjo bëhet përmes:

- **vëzhgimit**
 - shkathtësitë e nxënësit për punë individuale,
 - shkathtësitë e nxënësit për punë në grupe,
 - shprehjes së interesimit për aktivitete të veçanta.
- **detyrave**
 - zgjidhja e drejtë,
 - kryerja me kohë,
 - formimi i shprehive për punë në klasë dhe në shtëpi.
- **projekteve**
 - individuale,
 - grupore.
- **testeve**
 - testi provues,
 - testet periodike,
 - testi final.
- **dosjeve (portofolave)**
 - me shkrim,
 - me ilustrime,
 - me incizime
- **vetëvlerësimit**
 - vlerësimi i nxënësit për nxënësin,
 - vlerësimi i grupit për grupin,
 - vlerësimi i klasës për nxënësin.

Përparimi i nxënësve në edukatën qytetare nuk mund të matet vetëm me momentin e pyetjes, por në gjithë procesin e angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive në klasë, në shkollë, në komunitet. Vlerësimi nuk duhet të mbështetet vetëm në informatat njohëse të nxënësve, por edhe në shkathtësitë e treguara në aktivitetet e ndryshme praktike si sjelljet me rrethin, vëzhgimet në komunitet, mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të rëndësishme për shpjegimin e temave të parapara me plan dhe me program të kësaj lënde.

Vlerësimi nuk duhet të jetë vetëm proces i njëanshëm (arsimtar – nxënës), por ai duhet të jetë proces i shumanshëm. Te nxënësit duhet të kultivohen shprehitë e vlerësimit kritik për përmbajtjet dhe për metodologjinë e mësimdhënies e të vlerësimit. Për të mirën e shkollës, komunitetit e sidomos të vet nxënësve do të duhej që shkolla të krijojë kushte që nxënësit, jo vetëm të vlerësohen, por edhe vet të vlerësojnë.

BURIMET DHE LITERATURA

Për metodologji të mësimdhënies

1. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003
2. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Tiranë, 2003
3. Erlehta Mato & Pranvera Kamani, Në kërkim të njohjes, Tiranë, 2000
4. Fondacioni: Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, KONFLIKTI DHE KOMUNIKIMI, Tiranë, 1997
5. Grup autorësh, Edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut në shkollë, Tiranë, 2003
6. Grup autorësh, Mesazhe nga klasa – Ide dhe Modele për Mësimdhënie me Nxënësin në Qendër, (KEDP) Prishtinë, 2003
7. Grup autorësh, Qeverisja dhe udhëheqja në arsim, KEC, Prishtinë, 2003
8. Grup autorësh, Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, Tiranë 1998
9. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Standardet për nxënësit dhe mësuesit në lëndën e Edukimit qytetar**, (DRAFT), Tiranë 1997
10. Osman Buleshkaj – Robert C. Mizzi, **Mesazhe nga klasa**, KEDP. Prishtinë, 2003

Për përmbajtje

1. David Keri, Fondacioni Kombëtar për Kërkime Arsimore NEER, **Edukimi i të Drejtës për QYTETARI në Kurrikul**, Vështrim Ndërkombëtar, Londër 1999
2. Dr. Fatmira Myteberi & Astrit Dautaj & Majlinda Keta, **Qytetaria 1**, Tiranë, 2000
3. Erlehta Mato & Robert Gjedia & Marjana Sinani & Astrit Dautaj, **Standardet e arritjes së lëndës së edukimit qytetar**, Tiranë, prill 2003

4. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KCSF), **Lista e OJQ-ve të Kosovës**, Prishtinë, 2001
5. Graham Haydon, Instituti i Arsimit, **Agjenda e Edukimit Moral**, Londër, 2001
6. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 6**, Prishtinë, 1999
7. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 7**, Prishtinë, 1999
8. Grup autorësh, **Të gjitha qeniet njerëzore ...**, doracak për mësimin e të drejtave të njeriut, UNESCO, Belgjikë, 1998
9. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Kurrikula dhe shkolla** (Lëndët shoqërore 2), Tiranë, 2002
10. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë
11. Prof. François Andiger, **Edukimi për të Drejtën Demokratike të Qytetarisë**, Strasburg, 2000,
12. www.dadalos.com
13. Xhemajli Beluli, **Kultura qytetare**, Shkup, 2002

HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut.

Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij, duke ia formuar ambientin tingëllor. Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, del dhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor.

Edukata muzikore në shkollimin e përgjithshëm ka për detyrë t'u ofrojë mundësinë nxënësve të aftësohen para së gjithash për:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale dhe veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtjshëm, që nënkupton interesim më të gjerë me përgatitje për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse.

QËLLIMET

Lënda ka për qëllim:

- Të sjellë gëzim, emocione dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;
- Të zhvillojë dhe të ngritë muzikalitetin në vazhdimësi;
- të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;
- të edukojë për përzgjedhje selektive të programeve muzikore dhe për ambient të shëndoshë tingëllor ;
- të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik ;

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit do të :

- **njohin vepra të përzgjedhura muzikore nga kompozitorët botërorë dhe kombëtarë të epokave dhe të stileve të ndryshme:**
 - vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës, mjetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjua;
 - dallojnë, njohin dhe sistemojnë instrumentet e ndryshme muzikore përmes dëgjimit muzikor;
 - dallojnë llojet (gjinitë) dhe zhanret e ndryshme muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
 - dallojnë format e caktuara muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
- **muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale me vetëdije dhe përgjegjësi nën udhëheqjen e mësimit:**
 - interpretojnë këngë (popullore, artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë) sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar me dhe pa shoqërim instrumental;
 - interpretojnë në instrumente të Orf-it dhe të tjera, shoqërime të këngëve dhe përmbajtje të veçanta instrumentale sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar;
 - zhvillojnë aftësitë për këndim të drejtë dhe të bukur në nivel më të lartë (qëndrimi i trupit, frymëmarrja, artikulimi, këndimi shprehjeplotë, gradacionet në temp dhe dinamike);
 - zhvillojnë në nivel më të lartë ndjenjën ritmike, melodike e harmonike përmes interpretimit dhe dëgjimit;
 - njohin dukuritë e ndryshme ritmike (masat e reja) dhe melodike (shkallët e reja) si dhe përdorin shkrimin notal;
- **përjetojnë dhe njohin cilësitë themelore të muzikës popullore shqiptare përmes dëgjimit dhe këndimit (masat e përziera, shkallët modale dhe polifonia popullore) ;**
- **zhvillojnë shkathësitë kreative :**
 - riinterpretojnë në mënyrë krijuese veprat e interpretuara ;
 - plotësojnë, ndryshojnë dhe krijojnë tërësi melodike dhe ritmike;
 - shprehen në mënyrë kreative me lëvizje, shprehje figurative e letrare në bazë të përjetimit të veprës së dëgjuar muzikore;
- **zhvillojnë të menduarit kritik:**
 - vlerësojnë ngjarjet muzikore në mjedisin e tyre

	VEPRIMTARITË MUZIKORE (Objektivat specifikë)	PËRMBAJTJET TEMATIKO-INFORMATIVE	REZULTATET E PRITSHME	BURIMET ARTISTIKE MUZIKORE-SHEMBUJT E PROPOZUAR PËR DËGJIM*
D Ë GJ I M	<ul style="list-style-type: none"> • dëgjojnë në mënyrë përjetuese dhe analitike vepra muzikore; • dëgjojnë, njohin dhe sistemojnë instrumentet orkestrale, njohin orkestrën simfonike dhe përbërjet e tjera ; • fitojnë njohuri elementare për disa forma muzikore ; • njohin cilësitë themelore të 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ njohin dhe dallojnë vepra e kompozitorë të epokave, të stileve, të llojeve dhe të zhanreve të ndryshme ; ➤ ngjyrat tingëllore të instrumenteve si dhe sistemimin e tyre në grupe; ➤ llojet e orkestrave - orkestra simfonike ; ➤ ansamblet kamertale dhe formacionet solistike instrumentale; ➤ forma të caktuara muzikore (rondo, tema me varicione, sonata, simfonia, koncerti) 	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ rinjohin veprat e dëgjuara të kompozitorëve nga epokat dhe stilet e ndryshme dhe dallojnë format muzikore; ➤ njohin dhe sistemojnë instrumentet dhe formacionet e ndryshme interpretuese; ➤ njohin dhe dallojnë cilësitë themelore të muzikës 	<p>F.Mendelson : Koncert për violinë dhe orkestër në E-mol (violina, koncerti) ;-</p> <p>L.V.Betoven : Koncert për violinë dhe orkestër në D-dur (koncerti,rondo)-</p> <p>Kami Sen Sans : Mjellma nga Karnevali i shtazëve (violonçeli,piano, suita)- Shpëtim Kushhta : Fantazi për violonçel dhe orkestër (muzikë kombëtare)</p> <p>J.S.Bah : Badinerie për flaut dhe orkestër (flauti)-- F.Ibrahimi : Variacione mbi një temë popullore për flaut dhe orkestër (variacionet, muzikë kombëtare)- K.S.Sans : Zogjtë – Suitë orkestrale për flaut dhe orkestër nga Karnevali i shtazëve (flauti, suita)</p> <p>-K.M.Von Weber : Koncertino për klarinetë dhe orkestër në G-dur Op.26 (klarinetë)--V.Gjini: 6 variacione për klarinetë e piano (klarinetë, muzikë kombëtare)-T.Albinoni : Koncert për obo dhe orkestër in C Op.9 Nr.5 (oboa, koncerti)- Alfred Paparisto : Romansë</p>

* Në program është dhënë numër më i madh këngësh për interpretim dhe veprash për dëgjim me qëllim që mësuesdhënësi të ketë mundësi të zgjedhë (në mesin e tyre) ata shembuj që përshtaten më shumë kushteve dhe përparimit konkret të nxënësve.

	<p><i>muzikës popullore shqiptare ;</i></p>	<p>➤ <i>njohin disa nga llojet e këngëve dhe mënyrat e këndimit, ndërtimin melodik dhe ritmik të tyre;</i></p> <p>➤ <i>njohin dhe dallojnë instrumentet popullore më të njohura ;</i></p>	<p><i>popullore shqiptare;</i></p>	<p><i>për obo dhe orkestër (oboa, muzikë kombëtare)-</i> J.S.Bah : <i>Alte Corale për trombë, kor dhe orkestër (tromba)--</i> J.Hajdn : <i>Koncert për trombë dhe orkestër në Es – dur (tromba, koncerti)-</i> V.A.Mocart : <i>Koncert për korë dhe orkestër në Es –dur/Koha I (korna – briri)-</i>F. Beqiri : <i>Kuinteti frymor (korna, kuinteti)</i> L.V. Betoven : <i>Sonata për piano në G-dur (piano, sonata)-</i> V. A. Mocart : <i>Sonatina në C-dur /vieneze (piano, forma e sonatës)</i> J. S. Bah : <i>Tokata dhe Fuga në D-mol (organoja)--</i> A. Dvorzhak : <i>Prelude dhe fuga për organo (organo)--</i> Jean Michael Jarre : <i>Oxygen për sintesajzer (instrument elektronik,interpreti)</i> - J. Hajdën : <i>Kuarteti harkor C-dur /Finale (kuarteti)--</i> B. Bartok <i>Kuarteti harkor Nr.1, Op.7 (kuarteti)</i> J. Hajdn: <i>Divertimento për kuintet frymorB-dur Nr. 46 (Viena quinet)</i> - V. A. Mocart : <i>Serenatë për 13 vegla frymore (orquestra frymore) -</i> A. Bazzini : <i>Rondo Lutins për orkestër harkore (orquestra harkore, piano,interpreti)—</i> E. Rîzvanolli : <i>Suita për piano – Suita</i></p>
--	---	---	------------------------------------	--

				<p>dasmore (suited, muzikë kombëtare) ose - <i>M. Kaçinari</i> : <i>Suita ilire</i> (suited, muzikë kombëtare)- B. Briten : <i>Shëti nëpër orkestër</i> (orkestra simfonike) R. Mulliqi : <i>Simfonia Nr.2 Kosovare</i> (simfonia, kompozitori)- V. Gjini : <i>Simfonia in D</i> (simfonia, muzikë kombëtare) L. V. Betoven : <i>6 Variacione mbi një temë zvicerane</i>; V. A. Mocar : <i>Simfonia Nr. 40 G-mol</i> (simfonia, (variacionet)- V. A. Mocart : <i>Rondo për flaut dhe piano</i> (rondo, flauti) L. V. Betoven: <i>Rondo nga sonata për piano në Es-dur, Op.4, Nr.7</i> (rondo)</p>
I N T E R P R E T	<ul style="list-style-type: none"> • interpretojnë këngë popullore dhe artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë; • interpretojnë pjesë nga veprat artistike - 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ këngë popullore dhe artistike një, dy dhe shumëzërëshe ; ➤ përmes këngëve njohin dukuri të ndryshme ritmike - melodike (triola, sinkopa, shkalla G-dur, e-mol, shkalla 	<p>nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ kanë përvetësuar së paku gjysmën e numrit të këngëve dhe të temave të interpretuara, duke përfshirë 	<p>Franc Abt : <i>Lulja e fshehur</i> (dyzërëshe me shoqërim, G-dur, triola) Ramadan Sokoli : <i>Delja rudë</i> Popullore : <i>O pëllumb, pëllumb i bardhë</i> (e-mol natyrore) Çesk Zadeja : <i>Asaman o trandofili çelës</i> (e-mol harmonike) Xh.B.Pergolezi : <i>Lulja e bukur</i> (e-mol harmonike)</p>

<p>T I M</p>	<p>muzikore të epokave dhe të stileve të ndryshme ;</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërlidhin me vallëzim interpretimin vokal, instrumental dhe vokal-instrumental ; • interpretojnë pjesë vokale dhe instrumentale në bazë të përjetimit individual ; • cilësojnë dhe vlerësojnë interpretimet e veta dhe të tjerëve ; 	<p>modale) ;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ këngët, temat, meloditë, kanonet janë në tonalitete të njohura dhe të reja; ➤ këndimi bëhet ➤ sipas veshit (imitimit), i kombinuar dhe sipas tekstit notal brenda mundësive të nxënësve; ➤ këndimi shoqërohet me instrumente të orffit, popullore si dhe instrumente të tjera ; ➤ nxënësit luajnë tërësi të ndryshme instrumentale ; 	<p>dhe luajtjen në instrumente;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ aplikojnë dukuritë ritmike dhe melodike të përvetësuara ; 	<p>- Xh. Verdi : Marshi triumfal nga opera ” Aida” (triola) Këngë popullore Popullore : Nëpër bahçe (sinkopa) Popullore : Mun ke guri që ban xixa (sinkopa) Popullore : Lul’e kuqe, lul’ boj pembe (5/8) Popullore : O sa bukur paske çilë (5/8, dyzërëshe) Popullore : O po gjeta një bilbil në vesë(7/8) Popullore : Po shkon goca me korr’ n’arë (7/8) Popullore : Rrush i kuq (9/8) Popullore : Cuca e Radomirës (9/8) Popullore : O bilbil (këngë polifonike dyzërëshe) Popullore : U bubu krushqit tanë (këngë polifonike trizërëshe) L. V. Betoven : Tema nga Koncerti për violinë dhe orkestër në D-dur (koha I) F. Mendelson : Tema nga Koncerti për violinë dhe orkestër në e-mol (koha I) M. Kaçinari : Tema nga Suita ilire R. Sokoli : Kanon (temë popullore) M. Mengjiqi : Nënë Terezë lulkurorë (kanon) P. I. Çajkovski : Barkarola nga Kapriçoja italiane (melodi) P. Dungu : Dy gisht përmbi vetull (melodi)</p>
---	--	---	---	---

<p>K R I J I M</p>	<ul style="list-style-type: none"> • nxënësit shprehin përjetimin e tyre përmes lëvizjes, shprehjes figurative dhe shprehjes letrare • nxënësit shprehin në mënyrë kreative me mjetet shprehëse muzikore 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ në bazë të përjetimit të veprës së dëgjuar, shprehin në mënyrë kreative përmes lëvizjes, shprehjes figurative dhe letrare ; ➤ riinterpretojnë në mënyrë përjetuese dhe me mjete të shprehjes estetike përmbajtjet e përvetësuara muzikore; ➤ nxiten në plotësimin, ndryshimin dhe krijimin e melodisë – këngës ; ➤ krijojnë shoqërime të ndryshme instrumentale dhe vokale ; ➤ përcjellin ngjarjet muzikore duke dalluar dhe vlerësuar cilësinë e interpretimit ; 	<p>Nxënësit :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ realizojnë disa nga format e propozuara të punës krijuese sipas prirjeve të tyre individuale; 	
---	--	---	--	--

UDHËZIMET DIDAKTIKO-METODIKE

Edukimi muzikor në klasën VII paraqet një ngritje të kërkesave programore, si për kah zgjerimi i veprimtarive, ashtu edhe thellimi i disa komponenteve mësimore të cilat janë punuar edhe në klasët e mëparshme.

Realizimi i përmbajtjeve tematike kërkon punë të planifikuar mirë, racionalizim të kohës dhe të energjisë së nxënësit.

Veprimtaritë mësimore –muzikore (dëgjimi, interpretimi dhe krijimi) paraqiten të ndërlidhura dhe janë gati të pandashme prandaj formulimi i njëjësive mësimore duhet të kombinohet me së paku dy veprimtari të ndryshme. Kjo duhet bërë, jo vetëm për shkak të natyrës së lëndës, por edhe për t'u mundësuar nxënësve veprimtari aktive vatërsisht nga aftësitë individuale të tyre.

Përmbajtjet programore bazohen në :

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për dëgjim dhe interpretim;
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimit muzikor;
3. Informacionet për kulturën muzikore të ambientit të nxënësit si dhe formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë kombëtare dhe botërore.

DËGJIMI

Procedura metodike e dëgjimit të veprave të përzgjedhura duhet të mundësojë dëgjim aktiv. Dëgjimi duhet të jetë i shkurtër dhe i përsëritur, gjë që do të mundësojë rritjen e përqendrimit të vëmendjes së nxënësit. Posaçërisht dëgjimi i përsëritur mundëson njohjen më të gjithanshme të veprave, kompozitorëve, epokave dhe stileve, si dhe formës muzikore e formacioneve interpretuese. Me përgatitje motivuese para dëgjimit dhe komentimet përkatëse pas dëgjimit, procedura mësimore pasurohet dhe bëhet më atraktive për nxënësin.

INTERPRETIMI

Interpretimi realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në instrumente. Procedura metodike e këndimit bëhet: sipas veshit(imitimit), tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar(kur metoda sipas veshit dhe ajo sipas tekstit notal kombinohen) duke marrë parasysh mundësitë individuale të nxënësve. Luajtja në instrumente aplikohet në shoqërimin e këngëve dhe interpretimin e përmbajtjeve të veçanta instrumentale.

KRIJIMI

Puna krijuese e nxënësit duhet të përshkohet nga spontaniteti dhe liria e të shprehurit përmes: krijimit të tërësive ritmike dhe melodike, lëvizjes, shprehjes figurative dhe letrare.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor në bazë të kërkesave profesionale, didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit, duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore shkathtësitë interpretuese, dituritë informative, ndieshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet në bazë të përvetësimin të numrit të caktuar të këngëve dhe përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar gjithnjë duke pasur parasysh mundësitë individuale të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe inkurajojë interesimin e nxënësit për shprehje kreative, në veçanti vlerësohet:

- rinjohja e veprave të dëgjuara,
- këndimi dhe luajtja instrumentale,
- diktimet melodike dhe ritmike,
- përgjigjet me gojë dhe me shkrim,
- prezantimi,

instrumente të tjera të vlerësimit janë:

- testi,
- vetëvlerësimi.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultatet e arritshmërisë në vartësi nga objektivat e parashtruar.

HYRJE

Shkenca dhe arti e pasurojnë jetën e njeriut. Si pjesë e natyrës, njeriu përpiqet t'i njohë dhe t'i shpjegojë dukuritë dhe fenomenet natyrore dhe shoqërore, duke i përshtatur e ndryshuar sipas nevojave të tij.

Lënda e artit figurativ zë vend të rëndësishëm në sistemin ndërlëndor shkollor, duke kërkuar përmbajtjen e njohurive përmes konkretizimit vizuel. Për një ndjenjë ose vlerë estetike të nxënësit, krijohet mundësia të shprehet një mendim.

Arti figurativ përmban vlerën universale, si kontribut në zhvillimin e personalitetit të njeriut, pa dallim race, komuniteti apo gjinie.

Në nivelin e dytë (kl.VII) të shkollimit, nxënësit duhet të zhvillojnë njohuritë e të kuptuarit të hapësirës dhe të botës që na rrethon.

Nxënësve duhet t'u sigurohet mundësia që njohuritë e fituara, përkatësisht të kuptuara t'i realizojnë përmes shkathtësive individuale për shprehje figurative në lëmenj, teknika e mjete të llojllojshme.

Artit figurativ zhvillon të vërejturit dhe konceptimin gradual të pavarur, duke formuar personalitetin me mendim kritik për të gjykuar e vlerësuar vlerat e krijimeve figurative, artistike të tashme dhe të periudhave historike, si të popullit e rrethit ku jeton, ashtu edhe vendit dhe hapësirës më të gjerë.

QËLLIMET

- Për këtë nivel, parashihet zgjerimi i njohurive mbi trajtat pamore të hapësirës natyrore si: perspektiva – shprehja e thellësisë sipas planeve të largësisë përkatësisht relacionit të përpjesëtimeve dhe dimensioneve në hapësirë.
- Mbi bazën e thellësisë hapësinore bazohet zhvillimi i njohurive mbi: dritën, hijen, nyancat, kontrastin, shkallëzimin, lëvizjen, ritmin, konstruktivitetin, harmoninë etj.

- Përmes trajtimit figurativ, përkatësisht zbatimit të kuptimit të njohurive zhvillohen shkathtësitë kreative shprehëse si: inteligjenca dhe imagjinata.

OBJEKTIVAT

E përgjithshme	Specifike
Nga përmbajtja programore për kl. VII nxënësi duhet të jetë në gjendje:	
Të përceptojë	<ul style="list-style-type: none"> • Hapësirën dhe thellësinë e saj. • Saktësisht trajtat natyrore dhe artistike.
Të përjetojë e veçojë	<ul style="list-style-type: none"> • Momentet impresive nga pamjet dhe dukuritë. • Plasticitetin e kompozicionin figurativ.
Të dallojë	<ul style="list-style-type: none"> • Planet, madhësitë dhe përbërjet e objekteve. • Prioritetet në punë estetike, intelektuale dhe morale.
Të krijojë	<ul style="list-style-type: none"> • Intuitë kreative e motivim pune. • Raporte shoqërore bashkëpunimi me komunitete të klasës dhe me arsimtarin.
Të vlerësojë	<ul style="list-style-type: none"> • Për krijimet, termat, pyetjet dhe shprehjet figurative. • Imagjinatën kreative krijuese nga detyrat programore.

Organizimi i përmbajtjes

Kategoria	Nënkategoria
I. Të vërejturit dhe perceptimi	1. Hapësira 5 orë 2. Forma 5 orë 3. Sipërfaqja 3 orë
II. Të shprehurit dhe kreativiteti	1. Vija 5 orë 2. Ngjyra 7 orë 3. Harmonia dhe kontrasti 5 orë
III. Analiza dhe vlerësimi	1. Komunikimi 7 orë 2. Eseja orë të lira

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

KATEGORIA: I – TË VËREJTURIT DHE PERCEPTIMI			
Nënkategoritë e pritshme	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet
1.- hapësira	1. Perspektiva - dukuritë pamore të saj ne natyrë: - rrethi i shikimit, - vija e horizontit, dhe horizontalja - planet e thellësisë, - llojet e perspektivës	- trajtim figurativ - i eksterierit dhe enterierit, - përmes lëmenjve fig. Teknikave e mjeteve shprehëse - përzgjedhja e punës figurative. Bëhet nga mësimdhënësi, njohës i zhvillimit të të nxënit, atij psikofizik dhe atij psikofizik të nxënësve	-të njohë e të kuptojë hapësirën. -të zhvillojë perceptimin, përjetimin e thellësisë. -të saktësojë pamjen figurative sipas hapësirës.
2.-forma	1. Figura - natyrore dhe artificiale - të gjalla dhe jo të gjalla - të rrafshta (dydimensionale) - tridimensionale, - të parregullta, - gjeometrike, - simetrike, - asimetrike.	- trajtim figurativ - i eksterierit dhe interierit - përmes lëmenjve fig. Teknikave e mjeteve shprehëse. - përzgjedhja e punës figurative. Të bëhet nga mësimdhënësi, njohës i zhvillimit të të nxënit dhe atij psikofizik të nxënësve.	-nxënësi do të: - njohë e kuptojë hapësirën, - zhvillojë perceptimin, përjetimin e thellësisë., - saktësojë pamjen figurative sipas hapësirës.

3.- sipërfaqja	1. sipërfaqja - natyrore dhe artificiale, - e rregullt dhe e çrregullt, - e lëmueshme, e vrazhdë, - strukturore, - e vogël e madhe, - e rrafshët, vëllimore, - e ndriçuar, e errët.	- trajtim figurativ Përmes lëmenjve figurativë, teknikave, mjeteve e llojeve të punës: sipas natyrës e imagjinatës, në sipërfaqe të ndryshme.	Nxënësi do të: - dallojë sipërfaqet si nxitje psikike imagjinative apo motivim frymëzues, - bazojë shprehjen përjetuese me kënaqësi, - kuptojë sipërfaqen si element estetik të shprehjes figurative.
KATEGORIA II: TË SHPREHURIT DHE KREATIVITETI			
Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultate të pritura
1.- vija	1. Vija element figurativ - vijat natyrore, artificiale, imagjitive, ritmike, gjeometrike. Vija në ritëm (lëvizje), Vija në stukturë.	- trajtim figurativ në lëmenjtë e shprehjes figurative Përmes punës sipas natyrës, imagjinatës, temës apo tekstit letrar.	-nxënësi do të: - dallojë vijën në fushën e të pamurit hapësinor, - indentifikojë vijën e formës dhe veçoritë e saj: në sipërfaqe, në vëllim, në lëvizje, në ritëm etj.

<p>2.- ngjyra dhe vëllimi</p>	<p>1. Ngjyrat si veti fizike E rrezeve elektromagnetike të dritës. Ngjyrat themelore e komplimentare, spektri i ylberit, ngjyrat e ngrohta e të ftohta. Ngjyrat dekorative, valer 2. Konceptet e vëllimit Nuanca dritë hije në paraqitjen e vëllimit dy dimensional në rrafsh si dhe plasticitet.</p>	<p>-trajtim piktoral në teknika e ngjyra të ndryshme -motivim natyror, objektiv sipas temës e imagjinatës, -pikturim i sintetizuar dekorativ dhe pikturim vëllimor, - trajtim skulptural i vëllimit përmes fomësimit konkav e konveks.</p>	<p>-nxënësi do të: Njohë, kuptojë e përjetojë ngjyrën e spektrin e saj, -zbatojë kompleksivitetin e ngjyrës si gjuhë elementare figurative dhe estetike, -krijojë gamën e ngjyrave individuale apo tipin koloristik, -zhvillojë ndjeshmërinë për të krijuar vëllime estetike skulpturale.</p>
<p>3.- harmonia dhe kontrasti</p>	<p>1. Uniteti i elementeve Estetikë figurative vija, ngjyra, sipërfaqja, forma. 2. Kontrasti në kompozicionin figurativ Simetria si harmoni, Asimetria si kontrast.</p>	<p>-trajtim figurativ në lëmenj figurativë Tema, objekte natyrore e imagjinate: -kolazh, -kaligrafi- pllakat, -dekoracion, -kostumografi e -skenografi.</p>	<p>-nxënësi do të: -dallojë harmoninë e elementeve estetike figurative, -përjetojë kontrastin si veçanti estetike.</p>

KATEGORIA III: ANALIZA DHE VLERËSIMI			
Nënkategoria	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rrezultate të pritshme
1.- komunikimi	-punimet figurative të nxënësve: -galeria, -muzeu, -lokacione kulturore, -opinione multimediale, -manifestime kulturore, -historia e artit, -terminologjia figurative.	Në fund të çdo ore veçohen punimet me të mira të cilat mësimdhënësi i seleksionon sipas rasteve dhe nevojave për ekspozitë dhe konkretizim në ndonjë orë apo ndonjë lëndë tjetër mësimore. Gjithsesi të zhvillohet debat si një komunikim verbal analitiko – vlerësues i suksesit të veçantë apo të përgjithshëm të nxënësit në klasë, -të zhvillohen edhe orët për njohjen e kulturës figurative nga e kaluara deri më sot, nga institucionet që reflektojnë dhe manifestojnë vlera artistike figurative.	-nxënësi do të: -përjetojë dhe mësojë rreth vlerës së punës së veçantë dhe të përgjithshme në konkurrencën kolektive, -zhvillon mendim kritik për të gjykuar dhe vlerësuar artin nga jovlerat, -shënon historinë e kulturës figurative -punon album me reprodukime nga kultura figurative dhe fjalor të termave të artit figurativ.
2.-eseja (aktivitet i lirë jashtë- shkollor)	-analizë e sintezë Arti si qëndrim i veçantë ndaj të veçantës tjetër estetike	- të zhvillohet përpjekja e guximshme e nxënësit të shprehë njohjen dhe aftësinë inteligjente në të shkruarit eseistik.	-nxënësi do të: -pasurojë vetëdijen e personalitetit të vet, -krijojë opinon personal për artin, -kontribon në krijimin e një shoqërie me vlera kulturore.

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Arti figurativ është pjesë përbërëse e tërësisë jetësore. Andaj jetësisht lidhet edhe me të gjithë lëmenjtë shkencorë dhe shoqërorë. Në këtë aspekt krijohet korelacioni i lëndës figurative me lëndët e tjera mësimore dhe anasjelltas. P.sh. gjuha e letërsia amtare, gjeometria, aksonometria, gjeografia, fizika, biologjia etj.

VLERËSIMI

Për këtë lëndë dhe këtë nivel, përmes vlerësimit konstatimi i përmbushjes së këtyre standardeve të arritshmërisë,

- njohja, kuptimi, zbatimi i kategorive dhe, nënkategorive, përkatësisht programit mësimor i trajtuar përmes lëmenjve, teknikave e mjeteve mësimore si dhe kreativiteti individual dhe shprehja e lirë imagjinative, njohja e fjalorit figurativ dhe punimi i albumit artistik.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Në ndërtimin e procesit mësimor të artit figurativ, përveç materialit lëndor të nevojshëm, përdoren edhe:

- modele e objekte të tjera si koleksion për punë sipas natyrës, p.sh. trupa gjeometrikë, nga biologjia-botanika;
- reprodukime nga historia, objekte arkeologjike etj. Po ashtu nevojiten diafilma, diapozitiva, videofilma, CD.etj.
- çdo burim material e mjete teknike të mundshme ekzistuese për realizim të shprehjes figurative.

PUNA PRAKTIKE (PËRVOJA E TË NXËNIT)

- Përmbajtja programore u përshtatet aftësive psiko-fizike të nxënësve, duke e adaptuar mësimdhënien përmes njohjes, kuptimit dhe zbatimit apo reflektimit për të shprehur lirëshëm kreativitetin individual.
- Bashkëpunimi i ndërsjellë nxënës-arsimtar si dhe metodat didaktiko-metodike të kombinuara me këtë lëndë specifike të shkathëtësive figurative e bëjnë lëndën të dëshiruar.

- Motivimi për punë figurative, bëhet përmes përshtatjes dhe temës në momentin e duhur dhe nga përkrahja aktive e mësimit në mësimdhënësit ndaj nxënësve me ngecje si dhe me format e punës në grupe apo frontale.
- Mësimit dhe shkolla duhet të angazhohen për pajisjen e kabinetit – klasës me material, vegla e mjete konkretizimi (koleksion modelesh) që rezultati të jetë më i suksesshëm.
- Shkolla duhet të sigurojë hapësirën ekspozuese të punimeve figurative në mënyrë që inspirimi, motivimi e stimulimi të jenë nxitje garimi, afirmimi e ambient estetik.
- Ekskursioni si metodë e veçantë është i preferueshëm për njohje të ndërsjellë të komuniteteve, historive e vlerave të llojllojshme natyrore-shkencore, etnografike-arkeologjike dhe kulturave artistike.

Prishtinë, 27.04.2004

HYRJE

Teknologjia për klasën e shtatë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë. Në këtë klasë bëhet përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të nevojshme si: paraqitja grafike e objekteve, materialet artificiale dhe përpunimi i tyre, mekanizmat, hidraulika dhe pneumatika, pajisjet elektrike si dhe njohuri të përgjithshme mbi komunikimet.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së teknologjisë për klasën e shtatë ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të njohur dhe kuptuar paraqitjen grafike të objekteve, materialet artificiale, pajisjet elektrike, mekanizmat, sistemet e fluideve dhe teknologjinë e komunikimeve.
- Zhvillimin e shkathtësive të përhershme për mbledhjen e të dhënave relevante shkencore dhe zbatimin e shkathtësive të fituara në situatat konkrete për të mirën e njeriut dhe mjedisit.
- Zhvillimin e shkathtësive për përpunimin e modeleve me materiale artificiale, si dhe konstruktimin e modeleve përmes burimit, shpenzuesit dhe çelësit.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e klasës së shtatë nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kuptimin e përparësive dhe kufizimeve që i ofron lënda.
- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, me nisëtiavë, etj.)

Të kuptojë

- Domethënien e termave në lëmin e teknologjisë.
- Konceptet dhe parimet në projektionin kënddrejtë të trupave, paraqitjen grafike të objekteve, materialeve artificiale, pajisjeve elektrike, burimeve të energjisë elektrike, mekanizmave, sistemeve të fluideve, komunikimeve.

Të zbatojë

- Paraqitjen grafike të objekteve.
- Modele me materiale artificiale.
- Qarkun elektrik.

Të demonstrojë shkathtësi mendore

- Në zgjidhjen e problemeve nga lëmenjtë e teknologjisë.
- Në marrjen e vendimeve të logjikshme (duke i zgjedhur informacionet, njohuritë dhe përfundimet relevante).
- Në zbatimin e të menduarit kreativ dhe kritik (duke shfrytëzuar informacione nga lëmi i teknologjisë, argumentet dhe parimet shkencore, njohjen e përfundimeve të gabueshme, propozimin e zgjedhjeve alternative, mendimin kritik ndaj informacioneve dhe demonstrimi i krijimeve origjinale).

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja
1. Teknologjia dhe ambienti	1. 1. Teknika dhe teknologjia në ndotjen e ambientit	1	2,8 %
2. Paraqitja grafike e objekteve	2. 1. Fazat e paraqitjes grafike të objekteve 2. 2. Vizatimi me kompjuter	8	21,6 %
3. Materialet artificiale dhe përpunimi i tyre	3. 1. Materialet artificiale 3. 2. Përpunimi i materialeve artificiale	10	27,0%
4. Mekanizmat, hidraulika dhe pneumatika	4. 1. Mekanizmat dhe makinat e thjeshta 4. 2. Hidraulika dhe pneumatika	4	10,8%
5. Pajisjet elektrike	5. 1. Lëmenjtë e përdorimit të energjisë elektrike 5. 2. Qarku elektrik 5. 3. Burimet e energjisë elektrike 5. 4. Motori elektrik 5. 5. Lidhjet e çelësave	10	27,0%
6. Njohuri të përgjithshme për teknologjinë e komunikimeve	6. 1. Teknologjitë e komunikimeve	4	10,8%

KATEGORITË	NËN-KATEGORITË	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËR-LËNDORE
1. Teknologjia dhe ambienti	1. Teknika dhe teknologjia në ndotjen e ambientit	1.1.1. Ndikimi i teknikës dhe i teknologjisë në ndotjen e ambientit	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: Të njohë rëndësinë e ndikimit të teknikës dhe të teknologjisë në ndotjen e ambientit.	Gjuhë amtare biologji
2. Paraqitja grafike e objekteve	2.1. Fazat e paraqitjes grafike të objekteve 2. 2. Vizatimi me kompjuter	2.1.1. Inicimi dhe skicimi i idesë 2.1.2. Projektioni kënddrejtë 2.1.3. Projektioni kënddrejtë i trupit në tri rrafshë 2.2.1. Vizatimi me CAD	Në shembujt e zgjedhur të zbatojë incizimin dhe skicimin e idesë. Të kuptojë projektionin kënddrejtë të objekteve. Në shembujt e zgjedhur të zbatojë projektionin kënddrejtë të trupit në tri rrafshë. Të kuptojë vizatimin me CAD.	Gjuhë amtare art figurativ
3. Materialet artificiale dhe përpunimi i tyre	3. 1. Materialet artificiale 3. 2. Përpunimi i materialeve artificiale	3.1.1. Llojet e materialeve artificiale (masat plastike etj.) 3.1.2. Fushat e përdorimit të materialeve artificiale 3.2.1. Mënyrat e përpunimit të materialeve artificiale (mekanike dhe me nxehje) 3.2.2. Përpunimi i objekteve me materiale artificiale të ndryshme	Të njohë dhe të përshkruajë llojet e materialeve artificiale. Të njohë fushat e përdorimit të materialeve artificiale. Të njohë mënyrat e përpunimit të materialeve artificiale. Zbatimi i mënyrave të përpunimit të objekteve me materiale artificiale të ndryshme.	Gjuhë amtare kimi

4. Mekanizmat, hidraulika dhe pneumatika	4.1. Mekanizmat dhe makinat e thjeshta	4.1.1. Makinat e thjeshta 4.1.2. Transmetuesit me rrota të dhëmbëzuara, me çift kërmillor dhe me kremalier	Të përshkruajë makinat e thjeshta. Të kuptojë rëndësinë e rritjes së vlerës së punës së makinave të thjeshta. Të njohë dhe të dallojë llojet e mekanizmave transmetues me dhëmbëzorë. Të kuptojë transmetimin sipas llojit, përmasave dhe pozicionit të rrotave, nga rrota hyrëse tek ajo dalëse.	Gjuha amtare Matematika fizika
	4.2. Hidraulika dhe pneumatika	4.2.1. Sistemet e thjeshta hidraulike dhe pneumatike	Të njohë qëllimin e përdorimit të sistemeve të thjeshta hidraulike. Të njohë pjesët përbërëse dhe mënyrën e funksionimit të sistemit të thjeshtë hidraulik dhe pneumatik.	
5. Pajisjet elektrike	5.1. Lëmenjtë e përdorimit të energjisë elektrike	5.1.1. Pajisjet elektrike. 5.1.2. Lëmenjtë e përdorimit të energjisë elektrike.	Të njohë pajisjet elektrike të cilat kryesisht përdoren në jetën e përditshme. Të kuptojë rëndësinë e përdorimit të energjisë elektrike. Të njohë lëmenjtë e përdorimit të energjisë elektrike.	Gjuha amtare gjuha angleze fizika kimia
	5.2. Qarku elektrik	5.2.1. Qarku elektrik. Përçuesit dhe izolatorët.	Të përshkruajë qarkun elektrik me burim tensioni, me çelës dhe me shpenzues. Të konstatojë kushtet e nevojshme që në qarkun elektrik	

	<p>5.3. Burimet e energjisë elektrike</p>	<p>5.2.2. Tensioni i burimit dhe shpenzuesit. Simbolet në elektroteknikë, skemat elektrike.</p> <p>5.2.3. Çelësat. Shpenzuesit elektrikë.</p> <p>5.3.1. Tensioni elektrik. Burimet e tensioneve të mëdha dhe të vogla. Njësia e tensionit.</p> <p>5.3.2. Rreziku nga rryma elektrike. Burimet alternative të energjisë elektrike (centrali solar me erë etj). Përdorimi i energjisë elektrike. Ndikimi i prodhimit të</p>	<p>të rrjedhë rryma; të tregojë ndryshimin mes përcësve dhe izolatorëve.</p> <p>Të njohë dhe të dallojë simbolet elementare elektrike si dhe përdorimin e tyre në qarkun elektrik.</p> <p>Të njohë dhe të përshkruajë veprimin e çelësve në qarkun elektrik.</p> <p>Të numërojë dhe të përshkruajë shpenzuesit e energjisë elektrike.</p> <p>Të njohë dhe të dallojë burimet e ndryshme të energjisë elektrike, baterinë, dinamoni, akumulatorin, gjeneratorin, celulën diellore etj.</p> <p>Të njohë burimet elektrike të cilat përdoren lehtë dhe janë më të parrezikshme për njeriun dhe të tregohen arsyet e përdorimit të lehtë dhe të sigurt të tyre.</p> <p>Të përshkruajë disa mënyra të prodhimit alternativ të energjisë elektrike.</p> <p>Të njohë rëndësinë e përdorimit të energjisë elektrike për ekzistencë dhe për zhvillim të civilizimit.</p> <p>Të përshkruajë dhe të tregojë</p>	
--	--	---	--	--

		energjisë elektrike në rrethinë.	ndikimin e prodhimit të energjisë elektrike në rrethinë. Të njohë funksionimin e motorit dhe llojet e tij. Të kuptojë se motori elektrik si shpenzues bën shndërrimin e energjisë elektrike në punë mekanike dhe shërben për ngasje të makinave. Të kuptojë vartësinë e kahut të rrotullimit të motorit me rrymë të vazhdueshme nga tensioni dhe polariteti i burimit.	
	5. 4. Motori elektrik	5.4.1. Motori elektrik dhe llojet e tij. Vartësia e kahut të rrotullimit të motorit me rrymë të vazhdueshme nga kahu i rrjedhjes së rrymës.		
	5. 5. Lidhjet e çelësave	5.5.1. Lidhja në seri (varg) e çelësave. Analiza e veprimit të qarkut elektrik, tabela e gjendjes logjike, skema e lidhjes. 5.5.2. Lidhja paralele e çelësave. Analiza e veprimit të qarkut elektrik, tabela e gjendjes logjike, skema e lidhjes.	Në shembujt e zgjedhur të konstatojë përdorimin e çelësave të lidhur në seri (varg). Të analizojë veprimin e lidhjes së dy çelësave në seri. Në shembujt e zgjedhur të konstatojë përdorimin e çelësave të lidhur në paralel. Të analizojë veprimin e lidhjes së dy çelësave në paralel. Të vizatojë skemat e lidhjeve të ndryshme. Përdorimi i çelësit alternativ për	

		5.5.3. Çelësi alternativ. Rregullimi i kahut të rrotullimit të motorit me çelësa alterantivë. Tabela e gjendjes logjike.	ndërrimin e kahut të rrotullimit të motorit elektrik dhe të analizojë veprimin e tij. Të formojë dhe të analizojë paraqitjen tabelare për gjendjen e motorit në vartësi nga pozita e çelësit.	
6. Njohuri të përgjithshme për teknologjinë e komunikimeve	6.1. Teknologjitë e komunikimeve	6.1.1. Teknologjia e komunikimit telefonik (telefonja fikse dhe mobile) 6.1.2. Teknologjia e komunikimit radiofonik 6.1.3. Teknologjia e komunikimit televiziv 6.1.4. Teknologjia e komunikimit përmes kompjuterit (internetit)	Të kuptojë teknologjinë e sistemit të komunikimit telefonik dhe mundësitë e përdorimit të tij. Të kuptojë teknologjinë e sistemit të komunikimit radiofonik dhe mundësitë e përdorimit të tij. Të kuptojë teknologjinë e sistemit të komunikimit televiziv dhe mundësitë e përdorimit të tij. Të kuptojë teknologjinë e sistemit të komunikimit përmes kompjuterit (internetit).	Gjuha amtare gjuha angleze fizika dhe të gjitha lëndët e tjera

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET DIDAKTIKE

Shpjegimi i përmbajtjes programore për teknologjinë dhe ambientin, paraqitjen grafike të objekteve, materialet artificiale, mekanizmat, hidraulikën, pneumatikën, pajisjet elektrike dhe komunikimet. Të realizohen shembuj konkretë nga inicimi deri te skicimi i idesë. Të bëhen provat nga lëmi përkatës, të njëjtat të realizohen sipas mundësisë edhe me modele të cilat mund të aplikohen me projektim në kompjuter. Konkretisht të njihet me pajisjet elektrike, mekanike dhe të komunikimit të përditshëm. Kujdes të veçantë duhet kushtuar sigurisë së punës së burimeve elektrike dhe shpenzuesve. Të tregohen shembuj të kyçjes së shpenzuesve përmes çelësve, dhe të provohet praktikisht në kabinetin e teknologjisë. Pastaj, të demonstron përpunimi i materialeve artificiale. Të bëhen prova me transmetues me rrota të dhëmbëzuara. Konkretisht, të njihet me komunikimin telefonik, radiofonik dhe televiziv. Të njihet me teknologjinë e komunikimit përmes kompjuterit (internetit).

VLERËSIMI

Vlerësimi i të nxënësve bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësve gjatë realizimit të përmbajtjes programore,
2. Vlerësimi i punës individuale,
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore,
4. Testimi gjatë procesit të mësimin dhe ai përfundimtar,
5. Vlerësimi përmes detyrës projektuese.

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

Literatura e propozuar

1. **Pajtim Bejtja, Alqi Mustafai, Eva Zagori, Renata Qatipi, Robert Tytymçe, Franko Kondakçi:** “Teknologjia 1”, Tiranë, 2002.
2. **Engjëll Tartari, Alqi Mustafai, Eva Zagori, Velesin Peçuli:** “Teknologjia 2”, Tiranë, 2002.
3. **Rexhep Berisha:** “Arsimi teknik” Klasa VI, VII, VIII, Prishtinë, 2001.

4. **Boris Abersek, Franjo Florjancic, Amand Patopnik:** “Teknika 7”, Lubjanë, 2000.
5. **Boris Abersek, Franjo Florjancic, Amand Patopnik:** “Teknika 7 – Delovni Zvesek”, Lubjanë, 2000.

Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme

1. Kabineti me pajisje për punimin e projekteve,
2. Kabineti me kompjuterë dhe pajisje të tjera përcjellëse,
3. Aplikacionet e nevojshme softverike,
4. Lidhja në internet, rrjeti lokal në kabinet,
5. Trajnime për arsimtarë,
6. Mirëmbajtja.

Kushtet minimale

1. Një kompjuter në shkollë për demonstrim të programit mësimor,
2. Trajnime për arsimtarë.

Vërejtje: Në fondin e paraparë të orëve janë përfshirë ligjërimi, përforcimi i lëndës dhe testimi i nxënësve.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

1. Theksi në demonstrim dhe në punë individuale dhe grupore, p.sh., evokimi dhe realizimi 35%, demonstrimi 15%, puna individuale dhe grupore 50%.
2. Inkurajimi i punës individuale dhe e shkëmbimit të dijes dhe të shkathtësive, puna interaktive.
3. Përsëritja e përmbajtjes përmes detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

1. Puna grupore dhe individuale

HYRJE

Nxënësit duhet t'i ofrohet mundësia që përmes aktiviteteve fizike të shprehë aftësitë e tij dhe përmes vlerësimit të tyre ai të vërejë suksesin e tij. Mësimdhënësi duhet të marrë parasysh dallimet ndërmjet nxënësve dhe mund të organizojë mësimin në grupe, sipas aftësive dhe nevojave, duke pasur kujdes që asnjëri nga ata të mos mbetet pa u përfshirë në procesin mësimor.

Përmes procesit të ushtrimit lëvizor, lojës e garës të konkretizuara në programe të ndikohet në mënyrë optimale në :

- Mbrojtjen dhe në përparimin e shëndetit të nxënësve,
- Zhvillimin normal të vetive dhe aftësive motorike, njëherësh mbajtjen e tyre sa më gjatë në nivel të mundshëm më të lartë
- Zvogëlimin dhe mundësisht eliminimin e pengesave lëvizore si dhe
- Zhvillimin maksimal të aftësive mjeshtërore motorike për qëllime garuese në sporte të ndryshme .

QËLLIMET

Përmes përmbajtjeve programore duhet të arrihen këto qëllime :

- Të zhvilluarit e aftësive lëvizore dhe funksionale;
- Zbulimi dhe mënjanimi i mangësive lëvizore të nxënësi;
- Stimulimi i rritjes dhe i zhvillimit të aftësive dhe i dimensioneve biologjike të nxënësit;
- Formimi i shprehive lëvizore sportive në sportet e zgjedhura në nivel të mundshëm të lartë;
- Orientimi i qëlluar i nxënësve në aktivitete lëvizore jashtëmësimore, posaçërisht i nxënësve me aftësi dhe prijë të dalluar sportive.

OBJEKTIVAT

Të zhvilluarit e trupit, të aftësive lëvizore dhe funksionale

- Të zhvilluarit e aftësive lëvizore (koordinimit, forcës, shpejtësisë, lëvizshmërisë, baraspeshës, saktësisë etj.) me ushtrime të ndryshme, si dhe me vegla dhe përmbajtje të ndryshme muzikore.
- Të zhvilluarit e aftësive funksionale përmes aktiviteteve të ndryshme sportive me rëndësi aerobe në natyrë (shëtitje, vrapim, skitari, not, etj)
- Të kultivuarit e mbajtjes trupit drejtë.

Përvetësimi i diturive të ndryshme sportive

- Të përvetësuarit dhe kryerja e elementeve themelore të atletikës, të gjimnastikës dhe të vallëzimit.
- Të përvetësuarit e teknikës së disa elementeve të sporteve kolektive deri në nivelin i cili mundëson të zbatohen në lojëra të thjeshta.
- Kryerja e koordinuar dhe estetike e lëvizjeve të ndryshme të përcjella me instrumente muzikore.
- Të përvetësuarit e notit.
- Të mësuarit e sigurt të skijimit.

Lidhshmëria me njohuritë teorike

- Të kuptuarit e drejtë të ndikimit të sportit në shëndet dhe në mirëqenie
- Njohja dhe të kuptuarit e reagimit të organizmit në ngarkesa.
- Njohja e ushqimit adekuat sipas aktiviteteve përkatëse sportive.
- Respektimi i rregullave të sjelljes dhe i parimeve themelore të sigurisë në sport.
- Njohja e mundësisë së inkuadrimit në aktivitete sportive në shkollë dhe në vendin ku jeton.

Përjetimi i këndshëm i sportit, formimi dhe të zhvilluarit e qëndrimit të drejtë (sjelljes), shprehive dhe mënyrave të sjelljes

- Të krijuarit e raportit të drejtë ndaj shëndetit (marrja e rregullt me sport në shkollë dhe në kohë të lirë, kultivimi i trupit dhe ushqimi i shëndoshë).
- Të zhvilluarit e këmbëngultësisë përmes aktiviteteve me kohëzgjatje të madhe (aerobe).
- Nxitja për pjesëmarrje dhe ndihmë të ndërsjellë, garimi i shëndoshë dhe zhvillimi i shoqërimit.

- Kultivimi i qëndrimit dhe i shprehive higjienike ndaj pasurisë së shkollës dhe pajimeve sportive.
- Respektimi rregullave të sjelljes sportive (fair-play).

PLANIFIKIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	Nr. i orëve	%
ANTROPOMETRIA DHE MOTORIKA	Vlerësimi i veçorive antropometrike dhe aftësive lëvizore	4 orë	5.4
ATLETIKA	Vrapimet Kërcimet Hedhjet	12-14	16.2- 18.9
GJIMNASTIKA SPORTIVE DHE RITMIKE	Ushtrimet në dysheme Kërcimet Hekuri Paralelet Trau gjimnastikor Vallet popullore kombëtare dhe ndërkombëtare	10-12	13.5- 16.2
SPORTET KOLEKTIVE	Futboll Hendboll Volejboll Basketboll	34 orë	45.9
SPORTET INDIVIDUALE	Sportet luftarake- Mundja Karate-vetëmbrojtja Tenis	10-16	13.5- 21.6
Aktivitetet në ujë	Teknikat e notit	7-10 ditë	
Skijimi	Disiplinat alpikë	5-7 ditë	
Garat shkollore	Gara në sportet kolektive dhe individuale Krosi pranveror dhe vjeshtor		
Pikniku-dalja në natyrë	Shëtitje në natyrë dy herë në vit	2 ditë	

VËLLIMI DHE STRUKTURA E LËNDËS

Nga përmbajtja e përgjithshme programore, 70 % përfshihet në kuadër të mësimit të obliguar, kurse 30 % mësim zgjedhor, në bazë të kushteve që i ka shkolla.

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	NDËRLIDHJA ME LËNDËT E TJERA
ANTROPOMETRIA DHE MOTORIKA	Vlerësimi i veçorive antropometrike dhe aftësive lëvizore	Pesha e trupit Lartësia e trupit Kërcim nga vendi në gjatësi. Kërcim nga vendi në lartësi. Vrapim 100 metra. Vrapim 600-800 m:	Shkalla e përparimit (vlerësimi fillestar dhe përfundimtar i veçorive psiko-motorike).	matematikë edukim shëndetësor
ATLETIKA	Vrapimet Kërcimet Hedhjet	Përforcim i teknikës së vrapimit të shpejtë dhe atij të qëndrueshëm. Vrapimi me stafetë. Teknika e kërcimit së largu “trupi në hark.” Teknika e kërcimit së larti barkushë. Hedhja e topthave që peshojnë deri 250 gr.	Të dinë të përballojnë pengesat dhe teknikën e vrapimit. Të dinë teknikën e kërcimit së larti. Të dinë të hedhin nga vendi dhe me vrull. Të dinë të shtytin gjylen.	fizikë biologji

GJIMNASTIKA SPORTIVE DHE RITMIKE	Ushtrimet në dysHEME	Kapërdimi para dhe prapa Kapërdimi fluturimthi Rrotullimi anësor "YLLI" Kërcimi i kaluqit këmbë- hapur dhe këmbëmbledhur	Nxënësit duhet të bëjnë kapërdimin para nga vertikalja mbi duar, atë fluturimthi dhe rrotullimin anësor në të dy anët.	fizikë
	Kërcimet	Kërcim i kaluqit me shpalosje Lëkundje para prapa në kacavarje	Të dinë të kërcëjnë kaluqin me mbështetje mbi qafë - me asistim.	
	Hekuri	Lëkundje dhe dalje në hark	Të dinë lëkundjen në hekur dhe daljen me kërcim.	
	Paralelet	Meshkujt: ecje me duar mbi drushta Dalje me lëkundje prapa Ecje mbi tra, vrapim, kthim për 90 ⁰ , 180 ⁰ , si dhe lidhja e këtyre elementeve në tërësi.	Të dinë të ecin mbi duar, të lëkunden mbi duar dhe të bëjnë daljen anash para-me ndihmë.	
	Trau gjimnastikor	Ekilibri ballor dhe anësor mbi tra. Dalja anash me trup drejt. Vallja kombëtare e "Rugovës", si dhe një valle ndërkombëtare dhe vallëzim modern	Të dinë të ecin dhe të kërcëjnë mbi tra para-prapa dhe të kompozojnë disa elemente lëvizore. Të dinë të vallëzojnë valle me përcjellje muzikore.	
	Vallet popullore kombëtare dhe ndërkombëtare			edukimi muzikor

SPORTET KOLEKTIVE	futboll	Përforcimi i elementeve themelore teknike pa top (zbulimi, mashtrimet, kërcimet) dhe me top: pasimet, udhëheqja, fintet, goditjet, rrëmbimi i topit. Lojë 4:4 në dy porta të vogla. Lojë 7:7 me arbitrim.	Aplikimi i elementeve teknike dhe taktike në situata të ndryshme të lojës.	biologji matematikë
	hendboll	Përforcim i elementeve teknike dhe taktike. Taktika e mbrojtjes 6:0 me kalim në atë 5:1 Sulmi me një pivot-përmes lojës dhe kundërsulmi me 1-2 sulmues.	Aplikimi i elementeve teknike dhe taktike në situata të ndryshme të lojës.	biologji matematikë
	volejball	Përvetësimi i lëvizjeve bazike teknike: dëbimi-pasimi nga lart dhe nga poshtë, shërbimi nga poshtë. Të mësuarit e elementeve tekniko- taktike: pasimi,pranimi, gjuajtja. Loja 2:2, 3:3, 4:4 dhe 6:6 në madhësi të ndryshme të fushës.	Aplikimi i elementeve teknike dhe taktike në situata të ndryshme të lojës.	biologji matematikë

	basketboll	Përforcimi i elementeve teknike dhe taktike (udhëheqja, pasimet rrëmbimi, gjuajtjet, depërtimet, mbulimi i sulmuesit. Lojë 1:1, 2:2, 3:3 në një shportë dhe 4:4 në dy shporta.	Aplikimi i elementeve teknike dhe taktike në situata të ndryshme të lojës.	biologji matematikë
SPORTET INDIVIDUALE	sportet luftarake-mundja	Përforcimi i kapjeve themelore të mundjes –stili i lirë	Të dinë elementet teknike dhe taktike të mundjes.	biologji
	karate-vetëmbrojtja	Elementet themelore bllokuese me kundërshtar . Elementet taktike të vetëmbrojtjes me kundërshtar aktiv.	Të dinë elementet teknike dhe taktike të vetëmbrojtjes.	Matematikë
	tenisi	Kapja dhe mbajtja e raketës. Lëvizjet e këmbëve dhe të duarve Lëvizjet për mjedisin Goditjet themelore të topit. forhend dhe bekhend.	Të dinë goditjet e topit me raketë si: forhendi, bekhendi, shërbimi dhe elementet tekniko-taktike të lojës.	biologji matematikë

Aktivitetet në ujë 7-10 ditë	Teknikat e notit	Lojëra në ujë Teknikat themelore të notit: krol dhe bretkosë -nisja shkollore.	Të jenë në gjendje të kalojnë largësinë 50 metra, duke përdorur secilën teknikë të notit si dhe nisjet dhe kthimet	edukimi shëndetësor biologji fizikë
Skijimi 5-7 ditë	Disiplinat alpike	Elementet e teknikës së lëvizjeve me ski: ecjet, kthimet, ngjitjet, lëshimet.	Nxënësit duhet të dinë ecjet ngjitjet, vrapimet, kthimet, lëshimet pjerrtas dhe sllallom.	biologji edukim shëndetësor
Garat shkollore	Gara në sportet kolektive dhe individuale Krosi pranveror dhe vjeshtor	Së paku në dy degë sportive në kuadër të shkollës dhe ndërmjet shkollave të komunës. Krosi pranveror dhe vjeshtor.	Nxënësit të dinë të zbatojnë rregullat dhe sjelljen sportive fair-play.	sociologji psikologji
Pikniku-dalja në natyrë	Shëtitje në natyrë dy herë në vit	Ecja në natyrë në largësi 5-10 km.	Të jenë në gjendje të përballojnë ecjen në natyrë 5-10 km .	sociologji psikologji edukim shëndetësor

Nga katër sportet kolektive të ofruara, shkolla duhet të zgjedhë së paku dy në vartësi nga kushtet dhe kuadrin që ka.

Përmbajtjet shtesë:

Vozitja me roshulla, me biçikletë, tenis, badminton etj. Zgjedhjen e këtyre përmbajtjeve e bën mësuesi dhe shkolla në bazë të kushteve materiale, kadrovike dhe traditës së rajonit ku ndodhet shkolla.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Klasa e shtatë, si vazhdim i programit të klasës së gjashtë, paraqet një periudhë të ndryshme në zhvillimin e nxënësve. Ndryshimet e adoleshencës nga të cilat janë të përfshirë të gjithë nxënësit, vajzat dhe djemtë, paraqet mundësi të reja, por edhe vështirësi të paparashikuara. Transformimet e rëndësishme morfologjike (lartësia, pesha) manifestohen në momente të ndryshme për nxënësit. Këto dallime në zhvillimin e personalitetit, mësuesi duhet t'i ketë parasysh gjatë realizimit të programit të edukimit fizik.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet intensitetit dhe vëllimit të ngarkesave, gjithnjë duke pasur parasysh ruajtjen e shëndetit të nxënësit, si njërin nga qëllimet kryesore të edukimit fizik dhe sportiv. Sidomos porositet që gjatë aplikimit të ngarkesave aerobe intensiteti i ngarkesës të rregullohet me kontrollimin e frekuencës së punës së zemrës (matjen e pulsit). Kjo ka efekt motivues për nxënësit.

Mësuesi duhet të ketë parasysh edhe dallimet ndërmjet gjinive dhe momentet e ndryshme të paraqitjes së pjekurisë të meshkujt dhe të femrat.

Një ndër detyrat shumë të rëndësishme të edukimit fiziko-sportiv është të gjithë nxënësit t'i bëjë të ndjehen të suksesshëm dhe të motivuar. Mësuesi i zgjedh objektivat, përmbajtjet, metodat dhe format e punës ashtu që nxënësit të ndihen këndshëm gjatë lojës, t'u mundësohet shkarkimi psikik nga ngarkesat, të cilat imponohen nga ritmi i përditshëm shkollor.

Nxënësve duhet t'u ofrohet mundësia që përmes aktiviteteve fizike të shprehin aftësitë e tyre dhe përmes vlerësimit të tyre të vërejnë suksesin e tyre. Mësuesi duhet të marrë parasysh dallimet ndërmjet nxënësve dhe mund të organizojë mësimin në grupe, sipas aftësive dhe nevojave, duke pasur kujdes që asnjëri nga ata të mos mbetet pa u përfshirë në procesin mësimor.

VLERËSIMI

- Vlerësimi i zhvillimit trupor bëhet me instrumente antropometrike- dy herë në vit (lartësia e trupit dhe pesha e trupit);
- Vlerësimi i aftësive lëvizore bëhet me sistemin CGS- dy herë në vit (kërcim nga vendi në gjatësi, kërcim nga vendi në lartësi, vrapim i shpejtësisë 60 m (100 m) dhe vrapim i qëndrueshmërisë 800 m (vajzat), 1000 m (djemtë).
- Niveli i informatave të mësuara vlerësohet individualisht dhe gjatë situatës së lojës;
- Vlerësimi i nivelit të përvetësimit të elementeve teknike dhe taktike.

LITERATURA

1. **Hasangjekaj, B. Puka, J.:** Edukatë fizike për klasën 5-6 të shkollës fillore, Prishtinë, 1985.
2. **Hasangjekaj, B. Nixha, M. Puka, J.:** Edukatë fizike për klasën 7-8 të shkollës fillore, Prishtinë, 1987.

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

PLANI dhe programi mësimor : Për klasën VII të shkollës së mesme të ulët / [Kryeredaktor Isuf Zeneli].- Prishtinë : Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2004 (Prishtinë : "Printing Press").- 230 fq.: ilustr.; 24 cm.

Literatura : fq. 228

ISBN 9951-07-225-9

E përgatiti për shtyp
*SHTËPIA BOTUESE **LIBRI SHKOLLOR*** - Prishtinë
Shtypi: PRINTING PRESS - Prishtinë